



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KONTROLLI I LARTE I SHTETIT



Performanca e KLSH

(*Janar-Qershor 2012*)



INTOSAI



Tiranë, korrik 2012

Në datat 30, 31 korrik dhe 1 gusht Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvilloi analizën 6-mujore në ambientet e Hotel Vlora Internacional, në qytetin e Vlorës në respekt të qytetit të pavarësisë dhe 100-vjetorit të shtetit të parë shqiptar.

Mënyra e organizimit të kësaj analize, e hapur për median dhe inkurajuese për debatin profesional me vlerësime për atë çfarë është bërë mirë dhe si duhet të bëhet më mirë, ishte një risi për institucionin. Forma e organizimit është marrë nga Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, e drejtuar nga Z. Lars Lage Olofsson, një personalitet në fushën e auditimit.

Ditën e parë, më 30 korrik, diskutimin kryesor e mbajti Kryetari, Z. Bujar Leskaj i cili paraqiti arritjet e institucionit gjatë periudhës janar – korrik 2012 si dhe sfidat e KLSH-së në 6-mujorin e dytë të 2012-tës, duke vënë theksin tek veprimtaria audituese si dhe marrëdhëniet e KLSH-së me institucionet e tjera homologe ndërkombëtare dhe ato brenda vendit puna dhe qëllimi i të cilave ndërthuret me atë të KLSH-së. Më pas analiza vazhdoi me raportet e dy drejtorëve të përgjithshëm, Z. Rober Gjini dhe Zj. Helga Vukaj. Ata reflektuan më në detaje mbi punën e departamenteve të auditimit që respektivisht drejtojnë, duke vënë theksin tek raportet e deritanishme të auditimit, përfshirë gjetjet, rekomandimet, masat, proceset gjyqësore, ndjekja e ankesave, konkluzionet, ndjekja e rekomandimeve, etj.

Ditën e dytë, më 31 korrik, drejtuesit e departamenteve të auditimit, përkatësisht Z. Ded Trieshi, Z. Pëllumb Beqiraj, Z. Aleksandër Lipivani dhe Z. Athanas Karaja prezantuan analizën e secilit departament duke u ndalur tek arritjet, problematikat dhe sfidat e punës së tyre. Ata prezantuan gjithashtu të dhëna reale nga raportet e KLSH-së për 6-mujajt e parë të vitit 2012. Për Drejtorinë Juridike analizën e 6-mujorit e prezantoi juristi me përvojë Z. Koço Sokoli, i cili vuri theksin tek proceset gjyqësore dhe bashkëpunimin me departamentet e tjerë për çështjet juridike dhe gjithashtu pjesën juridike të kallëzimeve penale të institucionit.

Gjithashtu ditën e dytë Zj. Luljeta Nano, Kryeaudituese, prezantoi materialin me temë “Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli”, i cili u pasua nga një prezantim i ekspertit të jashtëm Gjon Ndreaj me temë “Kontrolli i Lartë i Shtetit në Sytë e një Eksperti të Jashtëm”

Më pas u vazhdua me prezantimet e punës në grupe. Motoja e kësaj pjese të analizës ishte se çfarë kemi bërë mirë dhe çfarë duhet të bëjmë më mirë. Audituesit e institucionit u ndanë në 13 grupe në bazë të kriterëve të grupimit si përvoja, eksperiencia dhe fusha në të cilën audituesit janë specializuar dhe sipas departamenteve. Përmendim: grupin e auditimit të ministrive dhe institucioneve, të prokurimeve, të organeve tatimore, doganore, të njësisve të qeverisjes vendore, grupi i mbrojtjes së mjedisit, financimeve të huaja, shoqërive publike etj. Në kushtet e rritjes së ndërgjegjshmërisë, llogari-dhënies dhe transparencës çdo auditues ishte pjesëmarrës proaktiv dhe kontribues gjatë gjithë kësaj faze të analizës.

Në ditën e tretë, më 1 gusht prezantimi i parë u bë nga Zj. Elfrida Tarku dhe Z. Bajram Lamaj, mbi auditimin e performancës si domosdoshmëri për shtimin e vlerës së parasë. Ky prezantim ishte frut i përvojës së përfutur në trajnimin mbi auditimin e performancës të zhvilluar në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Polonisë, NIK.

Çdo prezantim i kësaj analize u shoqërua me pyetje, sugjerime dhe diskutime për të sjellë në vëmendjen e të gjithëve arritjet dhe sfidat e secilit departament. Në fund të aktivitetit, Kryetari i KLSH-së, Z. Bujar Leskaj paraqiti konkluzionet dhe drejtimet kryesore të punës për muajt në vazhdim të vitit 2012, duke falenderuar në të njëjtën kohë pjesëmarrësit, përfaqësuesit e medias që e paraqitën drejtpërdrejt këtë aktivitet si dhe qytetin mikpritës të Vlorës.

Z. Bujar Leskaj
Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit

*“Ne do ta forcojmë pavarësinë tonë me një armë që askush s’do guxonte të na e merrte: **diturinë mbi auditimin**, që na pajis me ide ose mendime të pavarura dhe analizë”.*

Terence Nombembe, President i INTOSAI

Kontrolli i Lartë i Shtetit(KLSH) fiton tërësisht pavarësinë, profesionalizmin dhe eficientë në punën e tij, në rast se zbaton me rigorozitet korpusin kushtetues e ligjor në vend si dhe standardet e përditësuara të organizatës ndërkombëtare INTOSAI, e cila bashkon institucione të auditimit më të lartë publik nga 191 vende të botës prej gati 60 vitesh tashmë. Më 23 dhjetor 2011, në ditën e parë të punës, si Kryetar i KLSH punova me stafin e institucionit platformën drejtuese që kisha paraqitur në nëntor përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit. Themelin e kësaj platforme e përbën respektimi i standardeve të përditësuara INTOSAI, standardeve ISSAI. Në vijimësi, në KLSH është kërkuar një respektim konkret i këtyre standardeve, jo thjesht me fjalë dhe deklarata për një realitet i cili duhet të shtrihet kapilar në çdo ditë pune të secilit auditues. Rezultatet e kësaj kërkesë duken tani, kur ka kaluar më shumë se një gjysëm viti nga nisja e zbatimit të këtij programi koherent për institucionin.

Çfarë ka arritur KLSH në periudhën janar-qershor të këtij viti?

Treguesit e performancës së institucionit flasin për një rritje cilësore në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjatë periudhës janar-qershor 2012, KLSH, në auditimet e zhvilluara në institucionet qendrore dhe vendore mbi veprimtaritë disavjeçare të tyre:

1. ka zbuluar një dëm ekonomik ndaj Shtetit në masën 3.664.788.000 Lekë, ose 36.6 milionë dollarë;
2. ka konstatuar shkelje financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara në shumën 1.447.104.000 Lekë;
3. dëmi ekonomik dhe ndikimi negativ financiar i zbuluar nga KLSH arrijnë në shumën totale 5.111.892.000 Lekë, ose rreth 50 milionë dollarë, ku përfshihen edhe institucionet fiskale, shoqëritë tregtare ku Shteti ka mbi 50 përqind të aksioneve, etj.;
4. ka dhënë 2,113 rekomandime, ose 29 përqind më shumë se e njëjta periudhë një vit më parë;
5. ka rekomanduar 489 masa disiplinore, ose 86 përqind më shumë se periudha janar-qershor 2011;
6. ka rekomanduar 1,137 masa organizative, ose 24 përqind më shumë;
7. ka kryer 18 kallzime penale për konsumimin e veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe shkeljes së barazisë në tendera publike, shifër kjo afërsisht e barabartë me numrin e kallzimeve të bëra në tre vitet e fundit 2009-2011, të marra së bashku;
8. Institucioni ka arritur një stad të ri të reflektimit ndaj publikut. Vetëm letra nga populli kanë ardhur 165 dhe janë shqyrtuar 127 si kompetencë e KLSH(73 përfunduar, 54 në proces);
9. KLSH ka rritur transparencën dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile. Artikujt në median e shkruar dhe sekuencat filmike për gjashtëmuajorin e parë të këtij viti janë si numër të barabarta me artikujt dhe sekuencat e gjithë vitit të kaluar;
10. Nga 2.1 ditë trajnimi në vit që kishte çdo auditues i KLSH gjatë vitit të kaluar, deri tani ka 6 ditë trajnime për audituesit e vjetër dhe për nëpunësit e rinj 13 ditë trajnime në 6 muaj.

Së dyti, është rritur përgjegjësia, transparenca, thellësia dhe profesionalizmi i auditimeve të kryera

Gjetjet e auditimeve të zhvilluara gjatë vitit të kaluar dhe që përfunduan si raportim në këtë vit, apo të filluara këtë vit, janë parë nga institucioni në këndvështrimin e një përgjegjesie më të madhe ndaj interesave të mirëadministrimit të fondeve dhe pronës publike dhe pritshmërive të qytetarit dhe taksapaguesit shqiptar. Raportimet e KLSH për mangësitë në performancën dhe shkeljet e konstatuara në institucione si Porti Detar Vlorë, Drejtoria e Përgjithshme e Hekurrudhave, Drejtoria Qëndrore dhe disa drejtori rajonale të ALUIZNI, në KESH, OST, në METE për koncesionet në fushën e kromit, bakrit dhe hidroenergjitikës, në disa ministri për përdorimin e shpenzimeve buxhetore për spote publicitare, festa dhe ngjarje kulturore e solemne, në disa bashki apo komuna të vendit, etj. kanë sensibilizuar opinionin publik dhe goditur anti-kulturën e mosndëshkueshmërisë së zyrtarëve të mesëm e të lartë të Shtetit, dukuri kjo shumë e dëmshme që po perhapet në vend. Rekomandimet e propozuara nga KLSH kanë rritur frymën e kërkesës së llogarisë ndaj performancës së ulët të institucioneve publike dhe pritshmërive të qytetarëve për një luftë më efektive ndaj korrupsionit. Tematikat e auditimeve të përzgjedhura këtë vit mbulojnë institucionet dhe aktivitetet kryesore të Shtetit. E veçanta e tyre është përzgjedhja mbi bazën e metodës së analizës së riskut, në veçanti të perpunuar nga standardet ISSAI 1315 për “Identifikimin e Rreziqeve të Keqdeklarimeve Materiale” dhe ISSAI 1330 për “Përgjigjet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuara”. Një analizë më e thelluar e vlerësimit të riskut i ka dhënë dhe do t’i japë në vijimësi mundësi KLSH të përqëndrohet në agjensitë dhe ndërmarrjet publike me një ekspozim më të lartë ndaj dukurive abuzive dhe korruptive, duke rritur forcën goditëse dhe parandaluese të institucionit ndaj korrupsionit.

Në tërësi, institucioni ka punuar mirë dhe ka patur ritëm në kryerjen e auditimeve, edhe pse jo të gjithë audituesit kanë patur intensitet të plotë pune dhe kanë marrë pjesë në më shumë se një auditim gjatë kësaj kohe. Janë përfunduar gjithsej 91 auditime, ndërsa 14 janë përfunduar, por jo evaduar dhe 21 të tjera janë në proces, nga 154 auditime të parashikuara për gjithë vitin. KLSH ka dhënë 25 propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacion, ose 10 përqind më pak se sa e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Ky rezultat duhet të na bëjë të reflektojmë dhe dëshmon

se ende mungon në shumicën e ekipeve tona të auditimit këndvështrimi i plotë për institucionin që auditojnë, për lidhjet e tij me strukturat superiore ose vartëse dhe për pozicionin që ka dhe rolin që luan në administratën shtetërore. Ende auditimet tona shohin më tepër përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret përkatëse të veprimtarisë së departamenteve dhe sektorëve të veçantë të entit që auditojnë, se sa funksionimin e tij në sistem dhe rezultatet në bazë të këtij funksionimi.

Në programimin efikas të auditimeve për këtë vit, kanë ndihmuar analizat e thelluara për veprimtarinë e institucionit përgjatë vitit 2011 nga secili department auditimi, drejtori dhe në nivel institucioni, që KLSH zhvilloi në janar 2012. Këto analiza u kërkua të prodhoheshin nën prizmin e problematikës së mprehtë të hasur nga çdo departament apo drejtori e KLSH, me pjesëmarrjen e të gjithë punonjësve. Ndoshta për herë të parë, analizat në nivel departamenti u realizuan në praninë e mediave dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile. Ky proces ndihmoi stafin e institucionit të përcaktonte më qartë problemet dhe rrugët për zgjidhjen e tyre.

Në ndihmë të audituesve dhe për informim të plotë e transparent të publikut, institucioni ka përgatitur edicionin e parë të kolanës “Botime KLSH”, me titull “KLSH: Raporti Vjetor 2011”. Botimi përmban informacion të detajuar për auditimet e kryera gjatë vitit 2011, si dhe analizat e zgjeruara për performancën e vitit 2011, me raportime dhe diskutime të hapura. Gjetjet dhe sugjerimet nga këto raportime dhe diskutime kanë përbërë bazën për planifikimin e auditimeve të institucionit gjatë këtij viti.

Një ndihmë për audituesit për të parë të reflektuar punën e tyre të deritanishme dhe orientimet për përmirësim ka qenë edhe përgatitja dhe dërgimi në Kuvend i raportit “Mbi veprimtarinë e KLSH të vitit 2011” në mars 2012. Raporti, krahas përshkrimit të performancës së institucionit, ishte një përgjigje ndaj rekomandimeve shumë të vlefshme të Kuvendit në Rezolutën e tij të datës 2 qershor 2011 për aktivitetin e institucionit.

Rezultatet e KLSH u panë në këndvështrimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve, por edhe në këndvështrimin kritik të një performance të dobët të realizuar nga institucioni, sidomos në luftën kundër korrupsionit (shumë pak kallëzime penale për në Prokurori), në kontrollet e performancës dhe në trajnimin e audituesve për fitimin e shprehive të auditimit modern. Kjo, në bazë të orientimeve të Nenit 17 të ISSAI 1, pika 1 e të cilit thotë se :”*raportet(e institucioneve të larta të kontrollit) duhet të prezantojnë faktet dhe vlerësimin e tyre në një mënyrë objektive dhe të qartë* (Deklarata e Limës, faqe 12).

Sërisht, në ndihmë të audituesve dhe për informim të plotë e transparent të publikut, institucioni ka përgatitur edicionin e dytë të kolanës “Botime KLSH”, me titull “KLSH dhe Kuvendi”. Botimi përmban informacion të detajuar për prezantimin e Raportit Vjetor të KLSH 2011 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit dhe në seancën plenare të Kuvendit. Ai i sjell të plota diskutimet e deputetëve në Komision dhe në seancë plenare. Shumica e diskutime janë me shumë vlera, që e orientojnë drejt audituesin. Detyrimi për të publikuar eksperiencat e fituara, krahas detyrimit kushtetues për KLSH për t’i raportuar Kuvendit dhe publikut, buron dhe nga standardi bazë ISSAI 20 i standardeve të INTOSAI, i cili rendit ndër Parimet themelore të punës së një institucioni të auditimit më të lartë (SAI):” *SAI-t komunikojnë në kohë dhe gjerësisht për aktivitetet e tyre dhe rezultatet e auditimeve nëpërmjet medias, publikimeve të ndryshme, faqeve në internet dhe mjeteve të tjera të komunikimit masiv”, faqeve në internet dhe mjeteve të tjera të komunikimit masiv* (ISSAI 20, Parimi 8);

Në rritjen e cilësisë së auditimit ka ndikuar edhe rishikimi i rregullores së organizimit dhe funksionimit të KLSH, të përfunduar në prill të këtij viti. Ajo u harmonizua më mirë me dispozitat ligjore në fuqi, me ndryshimet në strukturën e KLSH dhe në pritje të amendamenteve të ligjit integral të institucionit. Rregullorja e përditësuar u mundësoi audituesve dokumenta auditimi më koherente dhe më të plota, lehtësoi komunikimin vertikal dhe horizontal mes departamenteve, drejtorive dhe sektorëve, si dhe rriti intensitetin e komunikimit dhe ndërveprimit mes këtyre strukturave. Ajo unifikoi imazhin e institucionit në korrespondencën e jashtme dhe

të brendshme të tij. Rregullorja është përgatitur duke respektuar modelin e rregullores së Gjykatës Europiane të Audituesve, institucionit që auditon buxhetin dhe zbatimin e fondeve të BE-së.

Së treti, është thelluar realizimi i misionit të KLSH në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e fondeve dhe pronës publike. Në bazë të Deklaratës së Simpoziumit të 20-të të INTOSAI dhe Kombeve të Bashkuara, të zhvilluar në Vjenë në shkurt 2009 me temë “INTOSAI-partner aktiv në rrjetin ndërkombëtar antikorrupsion”, konkluzionet e të cilit ishin që *“korrupsioni është një problem mbetës dhe global që kërcënon financat publike, rendin ligjor dhe prosperitetin social”* dhe që *“riafirmojmë me forcë Deklaratën e Meksikos që thekson rëndësinë e institucioneve të auditimit suprem të pavarura dhe profesionale si parakusht themelor për një auditim efektiv ndaj qeverisjes dhe për një parandalim efektiv të mashtrimit financiar, korrupsionit dhe keqmenaxhimit”*, si dhe të Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013, e cila thekson *“përcaktimin strategjik të mjeteve të duhura ligjore e institucionale për të siguruar zbulimin e efektshëm të personave të dyshuar për vepra korruptive dhe garantuar përgjegjësinë e autorëve të veprimeve korruptive”* (Kapitulli i Dytë i Strategjisë, miratuar me VKM Nr. 1561 dt. 03.10.2008, faqe 3).

Duke përcjellë konstatimin dhe shqetësimin e INTOSAI, si dhe orientimin e Qeverisë,

Duke konsideruar pritshmëritë e qytetareve dhe të opinionit publik shqiptar, KLSH realizoi aktivitetet e mëposhtme:

- 1) Në shkurt 2012 nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, e cila ka shumë rëndësi, për faktin se nëse të dyja strukturat publike bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë në mënyrë të institucionalizuar, ato rrisin eficiencën e masave që propozojnë kundër administratorëve publikë të korruptuar apo në konflikt interesi, dhe nga ana tjetër, zgjerojnë spektrin e kontrolleve dhe investigimeve. Në bazë të

Marrëveshjes, KLSH e informon në kohën e duhur dhe tërësisht Inspektoratin e Lartë për rastet e prokurimeve publike dhe kontratave administrative kur dyshohet se janë nxjerrë në kushtet e konfliktit të interesit, ndërsa Inspektorati i Lartë, sa herë konstaton praktika abuzive, korruptive apo arbitrare nga ana e zyrtarëve të cilët janë subjekt i ligjeve të tij, informon KLSH të ushtrojë auditimet e tij. Marrëveshja po funksionon. Lista e funksionarëve të kapur me shkelje financiare e procedurale i shkon në kohe reale ILDKP nga KLSH dhe i jep indicie të mjaftueshme këtij institucioni për të hetuar dhe për të ngarkuar me përgjegjësi penale edhe personat e lidhur me zyrtarët deklarues të pasurisë. Marrëveshja realisht krijon lehtësira të mëdha për shkëmbimin e informacionit në një kohë shumë të shpejtë, duke siguruar efikasitet të lartë në punën e KLSH dhe ILDKP dhe forcë goditëse më të madhe ndaj korrupsionit dhe zyrtarëve të korruptuar. Institucioni i dërgon rregullisht informacion ILDKP;

- 2) Në mars 2012, KLSH nënshkroi me Autoritetin e Konkurrencës Marrëveshjen e Bashkëpunimit, për rastet kur gjatë auditimeve të tij konstatohen praktika të administratës publike, ose kontrata administrative si prokurime, ankande, konçesione etj. që mund të ndikojnë negativisht në shkallën e konkurrencës. Ndërsa Autoriteti i Konkurrencës njofton institucionin në përfundim të kontroleve apo hetimeve të tij, në rast zbulimi të praktikave abuzive apo arbitrare që çenojnë interesat pasurore të shtetit. Në maj, Autoriteti i Konkurrencës, në koordinim me Agjensinë e Prokurimeve Publike zhvilloi një seminar trajnues për Prokurimet Publike Elektronike, ku u ftuan edhe auditues të KLSH, të cilët fituan një eksperiencë të vyer;
- 3) Në prill 2012, KLSH lidhi marrëveshje bashkëpunimi me 6 nga shoqatat më aktive të shoqërisë civile që luftojnë korrupsionin dhe kërkojnë rritjen e transparencës së institucioneve publike të vendit, dhe pikërisht me Transparency Internacional në Shqipëri, me lëvizjen

Alternativa Civile, me Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë, me Institutin e Studimeve Bashkëkohore, me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe me Lëvizjen Evropiane Shqipëri. Në bazë të marrëveshjeve, institucioni dhe shoqatat marrin përsipër të shkruajnë projekte së bashku për luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës të institucioneve shtetërore. Shoqatat do ta ndihmojnë me ekspertizë KLSH gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimeve. Sikurse thekson me forcë pika 2 e Nenit 11 të Deklaratës së Limës, *“Në masën që gjetjet e institucionit të auditimit të lartë nuk dalin si gjykime ligjërish të vlefshme dhe të zbatueshme, ky institucion duhet të fuqizohet të takohet me autoritetin shtetëror përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme dhe t’i kërkojë këtij partneri të pranojë përgjegjësinë”* (ISSAI 1, faqe 8). Është kjo sjellje dhe kjo përgjegjësi që e shtyn KLSH të kërkojë tek të gjithë institucionet e tjera shtetërore dhe civile partneritet në luftën kundër korrupsionit;

- 4) Në qershor 2012, KLSH nënshkroi me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm një Marrëveshje Bashkëpunimi. Më 20 korrik 2012, 18 juriste dhe auditues të KLSH morën pjesë në një seminar trajnimi me specialistë të Prokurorisë. Si KLSH dhe Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ranë dakord të përgatisin një manual për të përmirësuar cilësinë e kallëzimeve penale dhe për të zhdërvjelltësuar procedurat e trajtimit të tyre nga Prokuroria.

KLSH, sikurse është agjent i Kuvendit për miradministrimin e pronës dhe financave publike, është gati të shërbejë edhe si agjent i Prokurorisë për denoncimin e krimit ekonomik me pronën shtetërore. Na e mundësojnë këtë pozicion në rradhë të parë standardet ndërkombëtare të auditimit më të lartë publik, standardet e INTOSAI dhe pikërisht standardi 1240, i cili flet për përgjegjësitë e audituesit në lidhje me korrupsionin dhe mashtrimin financiar në

auditimet e deklaratave financiare. Po ashtu, Kongresi i fundit i INTOSAI në Johannesburg të Afrikës së Jugut në nëntor 2010, në rezolutën e tij ka theksuar se *“Institucionet e auditimit më të lartë publik duhet të çojnë më tej luftën kundër korrupsionit”*.

Në raport me institucionet brenda vendit, si një ndihmë e strategjisë së tij institucionale është edhe Strategjia Anti-Korrupsion 2008-2013 e qeverisë Berisha, e cila kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuara dhe pikërisht: *“Shkëmbimin e informacionit, jo vetëm ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, por të çdo organi shtetëror që luan rol dhe ka përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili synon shkëmbimin e informacionit jo si pjesë e detyrimit e përgjegjësisë ligjore e institucionale të zakonshme, por mbi baza funksionale, proaktive dhe me periodicitet më të shpejtë”* (f. 16, Strategjia Ndërsektoriale e Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013).

Në këtë kuadër, KLSH i dërgon kallëzimet e tij penale në Prokurori mbi bazën e Nenit 281 të Kodit të Procedurës Penale, i cili i mundëson nëpunësit publik ta denoncojë krimin ekonomik. Këtë krim e argumentojmë në bazë të Nenit 248 të Kodit Penal për rastet e shpërdorimit të detyrës si funksionar publik dhe në bazë të Nenit 258 të Kodit Penal për rastet e shkeljes së barazisë të pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike.

KLSH nuk e mendon dhe as nuk do të ndërhyjë në punët e Prokurorise, por kërkon që hapi i parë, mbas vlerësimit të cilësisë së kallëzimit të tij, të jetë pezullimi nga ushtrimi i së drejtës publike i nëpunësit publik të denoncuar prej Kodit Penal, në bazë të Nenit 22, pika 2 a të Ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil. Ka ndodhur në të kaluarën që KLSH ka paditur funksionarë të Shtetit në Prokurori dhe institucione të ndryshme i kanë emëruar më vonë drejtues këta të paditur. Kur garantohet cilësia e kallëzimit të tij, mund të shikohet mundësia nga organi i Akuzës që për personat e denoncuar nga KLSH të kërkohet masa e arrestit shtëpiak, atëherë kur

për këto raste e parashikon ligji. Kjo, për vetë faktin se kur personi lihet në gjendje të lirë dhe akoma më tepër, vazhdon detyrën në kushtet e mëparshme, ai ose ajo mund të dëmtojë provat.

Lufta kundër korrupsionit dhe sidomos efekti parandalues i saj ka një anë morale shumë të rëndësishme. Ndëshkimi moral i rasteve të dyshuara që përmbajnë indicie të mjaftueshme rrit ndjeshëm forcën parandaluese ndaj korrupsionit. Është krijuar tashmë opinionin gati si bindje se zyrtarët e lartë dhe ata të mesëm të Shtetit i kalojnë pa u lagur situatat abuzive me interesat dhe pronën publike dhe këtë bindje KLSH ka mundësinë ta përmbysë. Duhet të luftojmë anti-kulturën e pandëshkueshmërisë që po instalohet në administratën tonë. Ajo i bën institucionet shtetërore që ta pranojnë abuzimin dhe korrupsionin si një e keqe e domosdoshme, duke ulur kundërveprimin e tyre.

KLSH do të përpiqet të jetë efektiv në përgatitjen e kallëzimeve të tij penale. Juristë dhe auditues me përvojë të institucionit kanë kryer një seminar trajnues të përbashkët me prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm më datën 20 korrik. KLSH do të intensifikojë kontaktet dhe aktivitetet e përbashkëta me këtë Zyrë, për të rritur aftësinë e juristëve dhe audituesve të tij për identifikimin e saktë të shkeljeve që përbëjnë vepër penale në fushën e administrimit të fondeve publike, administrimit të pronës publike dhe privatizimit të saj. Do të marrë masa për të qenë sa më objektiv dhe profesional në rastet e kallëzimeve të tij penale, por nga Prokuroria ka kërkuar që procesi i hetimeve paraprake, i ushtrimit të ndjekjes penale si dhe i ngritjes dhe përfaqësimit të akuzës të bëhet brenda një afati kohor më të shkurtër, për arsye se shpesh zgjatja e hetimit ul ndjeshëm vlerën reale të denoncimit të kryer.

Së katërti, është përmirësuar metodologjia e auditimit, duke u përpjekur për të kthyer vëmendjen në auditimin e performancës, krahas rritjes së eficiencës së auditimit financiar. Ky objektiv paraqitet afatgjatë, por në periudhën janar-qershor 2012 përmirësimi metodologjik u pasqyrua në aktivitetet e mëposhtme:

- a) U përkthyen në shqip parimet kryesore të auditimit të performancës (ISSAI 3100), si dhe udhëzimi përkatës. Keto materiale baze ndihmojnë efektivisht audituesit e performances ne KLSH;
- b) U hartuan formularët standardë për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të njësive të auditura dhe krijimin e lehtësive për përdorimin e tyre;
- c) U përmirësuan (nëpërmjet miratimit të Rregullores së përditësuar) përmbajtja dhe forma e dokumentave të auditimit, duke filluar nga shkresa për nisjen e tij deri tek Projekt-Raporti dhe Raporti përfundimtar i auditimit;
- d) U vendos në çdo program auditimi vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të njësisë që auditohet;
- e) Nisi puna për përditësimin e manualeve të auditimit financiar, të auditimit të performancës dhe të standardeve të brendshme të institucionit, bazuar në Nenin 13, pika 2 e ISSAI 1:”*Është në dobi të Institucionit më të Lartë të Auditimit që të përgatisë manuale auditimi në ndihmë të audituesve të veç*” (Deklarata e Limës, faqe 9), punë e cila po vijon me intensitet.

Së pesti, është përmirësuar struktura e KLSH, për t’ju përgjigjur kërkesave të kohës dhe rritjes cilësore të veprimtarisë audituese. Për të realizuar këtë objektiv, institucioni:

- a) krijoi sektorin e Auditimit të Buxhetit Qendror në Departamentin e Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm;
- b) krijoi Departamentin e ri të Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Teknologjisë së Informacionit, për të nxitur asimilimin e njohurive bashkohore mbi auditimin publik, rritjen efektive të kapaciteteve të audituesve të institucionit, përgatitjen e manualeve, broshurave dhe dokumentacionit shtesë informativ ndihmues për audituesit, zhvillimin e mendimit profesional në KLSH dhe zgjerimin e përfaqjes së punës së institucionit me projekte zhvillimore;
- d) plotësoi çdo Departament auditimi me nga 2 juristë të përgatitur;
- e) rekrutoi staf të ri mbi bazën e Standardeve ISSAI, (Neni 14, pika 2:”*Në rekrutimin e stafit për Institucionet më të Larta të Auditimit, vëmendja e duhur i*

duhet kushtuar njohurive mbi mesataren dhe experiencës profesionale të kandidatëve” (Deklarata e Limës, faqe 9). Ky rekrutim në KLSH u zhvillua me procedura transparente dhe testim paraprak të aftësive me shkrim dhe me intervistë verbale me kandidatët për vendet vakante të punës, të shpallura për një kohë të arësyeshme në website të KLSH dhe nëpër gazeta me qarkullim kombëtar.

Stafi i ri është në provë dhe nuk do të ketë asnjë tolerim, nëse nuk përvetëson standardet INTOSAI. KLSH do të forcojë programin e trajnimeve në institucion, duke krijuar Sektorin e Trajnimeve, një strukturë brenda Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë, e cila bëhet operative në muajin shtator 2012.

Së gjashti, KLSH ka nisur realizimin e sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të së njëjtës fushë apo të ngjashme në vend. Duke u bazuar në Standardin ISSAI 9150 të INTOSAI: “*Koordinimi dhe Bashkëpunimi mes Institucioneve të Auditimit Suprem dhe Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik*”, në maj 2012 institucioni lidhi një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Financave, për koordinim pune me Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik në këtë ministri. Strukturat e Njësisë Qendrore të Harmonizimit po bashkëpunojnë me KLSH dhe kanë kryer deri tani disa seminare njohës dhe trajnues për audituesit e institucionit. Marrëveshja parashikon komunikimin e ndërsjelltë të planeve dhe strategjive të auditimit, dokumentimin e proceseve operacionale dhe sistemeve të enteve të audituara, zhvillimin dhe kryerjen e procedurave të koordinuara të auditimit; si dhe investigimin e përbashkët të rasteve të dyshuara si mashtrim financiar apo korrupsion. Në 24 korrik, drejtuesit e Njësisë Qendrore të Harmonizimit në Ministrinë e Financave, të Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Inspektimit Financiar prezantuan strukturat e tyre dhe lidhjet me auditimin e jashtëm suprem, në një seminar nismëtar të organizuar nga SIGMA në Tiranë, në kuadrin e Programit të saj për Mbështetjen e KLSH. Këto prezantime i ndihmuan mbi 50 auditues të KLSH të pranishëm në seminar, për të parë më qartë drejtimet e bashkëpunimit mes auditimit të jashtëm dhe auditimit të brendshëm, për shmangjen e dublimeve dhe uljen e kostos së auditimit.

Së shtati, KLSH ka rritur ndjeshëm kapacitetet e stafit të tij në kryerjen e auditimeve cilësore dhe efçiente.

Në bazë të nenit 14, pika 1 e ISSAI 1, “Anëtarët e stafit auditues të SAI-t duhet të kenë kualifikimet dhe integritetin moral të kërkuar për të plotësuar detyrat e tyre” (Deklarata e Limes, faqe 9) . Për ne ka qenë e qartë se rritja e kapaciteteve të KLSH në auditim është pavarësia reale e tij. Dhe sa më i pavarur të jetë ky institucion jetik për ruajtjen e parasë publike, aq më mirë luftohet korrupsioni dhe parandalohet ai. Për të përmbushur këtë objektiv:

- a) Institucioni nxori një Urdhër që numri i ditëve të trajnimit të audituesve dhe punonjësve me pervojë të shkonte në 10 ditë në vit (deri në fund të 2011-ës ishte 2.1 ditë trajnimi, ndër më të ultit në rajon si tregues), ndërsa për personelin e ri në 25 ditë trajnimi në vit;
- b) Intensifikuam programin e trajnimeve të brendshme të KLSH, sipas një plani temash auditimi të përcaktuar mirë dhe të organizuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Metodologjisë me ekspertë tanë; KLSH ka shfrytëzuar tërësisht mundesitë e krijuara nga trajnues të tjerë publikë dhe privatë në vend, si dhe jashtë shtetit, si Instituti i Trajnimeve të Administratës Publike (ITAP) në vend, Autoriteti i Konkurrencës i Shqipërisë, por edhe Qendra për Ekselencë në Financë (CEF) në Slloveni, Seminari i SIGMA për sigurimin e cilësisë në Pragë, Rrjeti i SAI-t të vendeve kandidate apo aspirante për në BE, i mbështetur nga SIGMA dhe Gjykata Evropiane e Audituesve, rrjeti PEM-PAL (inicialet në anglisht për Menaxhimi i Shpenzimeve Publike dhe i Mësimit të Asistuar nga Kolegë), etj. Si rezultat, gjatë periudhës janar-qershor 2012, treguesi i ditëve të trajnimit për auditues praktikisht është shtatëfishuar në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë, në mesatarisht 6.2 ditë trajnimi në vit për punonjësit me pervojë dhe 12.7 ditë trajnimi për audituesit dhe specialistët e rinj të KLSH;

- c) KLSH ka kryer në vijimësi gjatë gjashtëmuajorit të parë testimet me shkrim për vlerësimin e aftësive profesionale të kryeaudituesve dhe të audituesve të tij. Tezat janë përgatitur nga komisione ad-hoc vlerësimi, në përbërje të të cilëve janë drejtuesit e lartë të institucionit dhe audituesit më me përvojë dhe më të trajnuar ndër vite. Për të gjithë audituesit që duan të rriten në gradë dhe karrierë, mjafton një kërkesë e tyre dhe ata kalojnë në sprovën e testimit për gradën që kanë kërkuar;
- d) Sikurse është përmendur më lart, mbi 50 auditues të KLSH, ose gati gjysma e kapaciteteve tona audituese u trajnuan në datat 24-25 korrik në një seminar dyditor të organizuar dhe me ekspertë të SIGMA. Ata u njohën me zhvillimet e fundit në strukturat e auditimit të brendshëm, menaxhimit dhe inspektimit financiar, me përvojën nga autoriteti portugez i auditimit, me përvojën e pasur të Gjykatës holandeze të Auditimit në kryerjen e auditimeve të performancës, si dhe me konceptet dhe përfaqesjet kryesore në auditimin financiar, të pajtueshmërisë dhe të IT. Ky aktivitet ishte preludi i një sërë trajnimesh intensive njëjavore që do të zhvillohen me ekspertë të SIGMA gjatë muajve shtator, tetor dhe dhjetor të këtij viti;
- e) Po ashtu, në datat 2-5 korrik 14 auditues të KLSH u trajnuan për një javë në Varshavë pranë Zyrës Kombëtare të Auditimit (NIK) të Polonisë për auditimin e performancës.
- f) Rritjes së kapaciteteve audituese i shërben pa dyshim edhe revista shkencore në çdo katër muaj “**Audituesi Publik**”, numri i parë i së cilës është gati dhe pret vetëm përshëndetjet dhe opinionet e personaliteteve të auditimit suprem publik në Evropë, si z. Jacek Jezierski, Presidenti i NIK-ut polak dhe z. Joop Vrolijk, ekspert i lartë i SIGMA për financat publike. Revista po realizohet në bashkëpunim me akademikë të njohur të fushës, me levrues të shkencës së financave publike dhe jurisprudencës në vendin tonë dhe me ekspertë të auditimit në institucione qendrore publike. Ajo do të jetë një forum i mendimit më të përparuar akademik dhe shkencor të vendit në auditimin publik, por edhe një arenë e debatit të shëndetshëm profesional për zgjedhjet

e strukturave drejtuese dhe përjasjet e auditimeve të brendshme dhe të jashtme që kryhen në auditimin publik shqiptar. Revista do të promovojë auditimin e performancës, të integritetit dhe të pajtueshmërisë, që konsiderohen si ndër më të rëndësishmet sot në botë në auditimin publik. Krahas eksperiencave nga vendi, ajo do të shërbejë edhe si burim informacioni dhe platformë e ideve dhe praktikave të reja të auditimit më të lartë, që lansojnë periodikisht organizata si INTOSAI dhe EUROSAI, por edhe SAI të veçanta që ndodhen në pararojë të mendimit shkencor.

Së teti, institucioni ka intensifikuar bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare si INTOSAI dhe EUROSAI, me programe dhe struktura të BE, si SIGMA dhe Gjykata Evropiane e Audituesve, me institucionet homologe të kontrollit të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit, me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

Duke u bazuar në moton e INTOSAI “Eksperiencia e përbashkët u shërben të gjithëve), por edhe në Nenin 15, pikat 1 dhe 3 të ISSAI 1, dhe përkatësisht “*Shkëmbimi ndërkombëtar i ideve, eksperiencës dhe i informacionit shërben si një mjet i mirë ndihmues për institucionet e kontrollit më të lartë, për të përmbushur detyrat e tyre*” dhe :”*Është e dëshirueshme të shtohen dhe intensifikohen këto perpjekje dhe aktivitete(bashkëpunimi ndërkombëtar). Zhvillimi i një terminologjie uniforme të auditimit të qeverisjes, bazuar në ligje krahasuese, është e një rëndësie parësore*” (Deklarata e Limës, faqe 9), KLSH :

- a) Nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës në shkurt 2012. Kjo marrëveshje ishte e veçantë, jo vetëm pse lidhi dy institucione shqiptare të auditimit suprem, por sepse në krye të Zyrës kosovare të Audituesit të Përgjithshëm qëndron një nga personalitetet më të larta të auditimit publik në kontinent, zoti Lars Lage Olofsson. Marrëveshja parashikon trajnime dhe shkëmbim eksperience mes të dyja institucioneve, si dhe unifikimin e terminologjisë së auditimit në gjuhën shqipe. Janë përkthyer rreth 120 faqe të Shënimeve të Praktikës së standardeve të fushës ISSAI për auditimin financiar, të cilat do të orientojnë më mirë audituesit e të dyja vendeve në respektimin e standardeve

ndërkombëtare të INTOSAI gjatë punës së tyre konkrete. Në datat 10-13 korrik 2012 drejtues dhe auditues të KLSH morën pjesë në konferencën vjetore të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës në Pejë dhe në një seminar përmbyllës me konsulencë nga SAI suedez, i zhvilluar në Prishtinë, duke fituar eksperiencë për organizimin e aktiviteteve të tilla dhe në Shqipëri;

- b) Në prill 2012 KLSH nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Gjykatën e Auditimit të Sllovenisë. Kjo marrëveshje u përgatit në bazë të parimeve të përbashkëta të respektit, besimit dhe bashkëpunimit dypalësh të Organizatës INTOSAI, si edhe të Organizates Europiane të Institucioneve të Auditimit Suprem EUROSAI. Ajo përfshin shkëmbimin e mësimeve të nxjerra, sikundër trajnimin e audituesve dhe këshillimin mbi metodat e auditimit. Dokumenti i nënshkruar është shumë i rëndësishëm për KLSH-në. Institucioni Suprem i Auditimit në Slloveni është modern, një ndër institucionet më profesionale në Evropë. Nëpërmjet mbështetjes së parashikuar në marrëveshje, KLSH dhe Gjykata e Auditimit e Sllovenisë do të shkëmbejnë eksperiencë në auditimin financiar, atë të përputhshmërisë dhe të performancës, si dhe në çertifikimin e deklaratave financiare. Po ashtu do të eksplorojmë mundësitë për të përgatitur projekte të përbashkëta, për të forcuar kapacitetet e KLSH në planifikimin strategjik dhe përdorimin e teknikave të auditimit modern.
- c) Në maj 2012, KLSH nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Polonisë(NIK). Kjo zyrë është një institucion suprem auditimi tejet i zhvilluar dhe i madh, me mbi 1700 auditues. Presidenti i saj Jacek Jezierski përfaqëson ndër figurat më aktive të INTOSAI dhe sidomos të EUROSAI, ku deri në fund të vitit 2011 ka qenë presidenti i rradhës i organizatës evropiane të institucioneve të auditimit suprem. Sikurse u përmend më lart, në javën e parë të korrikut 2012, 14 auditues me përvojë dhe të rinj me perspektivë nga KLSH u trajnuan për auditimin e performancës në Poloni. Morën një eksperiencë të çmuar në përzgjedhjen e tematikave të auditimeve të performancës, në vendosjen e kriterëve për secilin auditim në këtë fushë, në përdorimin e metodave

bashkohore për mbledhjen e një informacioni sa më të besuar dhe të përditësuar rreth performancës së entit që auditohet, etj., te cilen do ta prezantojnë edhe ne kete analize gjashtemujore. Kjo eksperiencë e fituar, se bashku me ate qe do te marrim nga SIGMA ne shtator te këtij viti, do ta ndihmojë shumë KLSH në të ardhmen e afert, në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve intensive të performancës, që masin rezultatet e shumë institucioneve të rëndësishme apo të kryerjes së investimeve publike në degë jetike të ekonomisë së vendit, në këndvështrimin e përdorimit me ekonomi, efektivitet dhe eficiency të parasë publike të vënë në dispozicion. Aktivitetet e trajnimit dhe të shkëmbimit të eksperiencës do të vijojnë në vjeshtën e këtij viti si në Tiranë dhe në Varshavë, në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe mashtrimit financiar, në auditimin e IT, në auditimet e përbashkëta, etj.;

- d) Gjykata e Llogarive e Turqisë dhe Zyra e Auditimit Suprem e Kroacisë, institucione me traditë në auditimin suprem publik, të kontaktuar nga KLSH, kanë shprehur interesimin e tyre për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionin dhe pritet nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve në gjysmën e dytë të këtij viti;
- e) KLSH ka intensifikuar marrëdhëniet me programin e BE-së SIGMA (Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim), duke përgatitur me këtë program Projektin e Aktiveteve Urëlidhëse 2012 “SIGMA në mbështetje të KLSH”, deri në fitimin e një projekti binjakëzimi IPA 2013 nga ana e KLSH. Aktiviteti i parë në formën e një seminari nismëtar u zhvilluar në korrik 2012 në Tiranë, ku u trajnuan mbi 55 auditues dhe drejtues të KLSH në temat e zhvillimeve në auditimin e brendshëm, në menaxhimin financiar dhe në inspektimin financiar në vend, të funksionimit të autoritetit të auditimit, i cili do të ngrihet edhe në Shqipëri në kuadrin e perspektivës së marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE(u muar eksperiencia e suksesshme portugeze). Seminari trajtoi edhe auditimin financiar dhe atë të pajtueshmërisë, auditimin e performancës dhe të IT, në një përpjekje për të hedhur bazat për një trajnim të thelluar dhe tërësor për këto tema në muajt në vijim nga eksperte të SIGMA. Dhe pikërisht, në muajt shtator, tetor dhe dhjetor parashikohen trajnime njëjavore të drejtuesve dhe audituesve të

institucionit përkatësisht për auditimin e performancës, auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë, si dhe për auditimin e IT. Gjate kohës së kryerjes së trajnimeve, ekspertet e SIGMA do të asistojnë drejtuesit e KLSH në draftimin e planit të zhvillimit strategjik 2013-2016 të institucionit. SIGMA parashikon po ashtu t'i kërkojë DG-Budget në Bruksel vazhdimin e mbështetjes së saj për KLSH edhe për vitin 2013;

- f) Institucioni ka vendosur raporte të rregullta komunikimi dhe shkëmbimi idesh me Zyren e Përhershme të Bankës Botërore në Shqipëri. Nga ana e drejtueses së kësaj Zyre, zj. Ksenya Lvovski është shprehur dëshira për mbështetje konkrete për KLSH;
- g) KLSH ka aplikuar pranë Delegacionit të Komisionit Evropian në Shqipëri për realizimin e një projekti binjakëzimi në kuadër të fondeve IPA 2013, për të ngritur kapacitetet e tij audituese në nivelin e kerkesave të standardeve të përditësuara të INTOSAI. Aplikimi ynë është vlerësuar lart nga ekspertët e delegacionit të BE në Shqipëri, është mbështetur nga Qeveria Shqiptare dhe informatat paraprake janë që KLSH do të arrijë të sigurojë mbështetje nga fondet IPA 2013;
- h) Në qershor 2012, erdhi në Tiranë një mision vlerësimi nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë. Misioni do të japë në vjeshtë 2012 vlerësimin e tij, nga ku pritet që KLSH të përfitojë një marrëveshje partneriteti dhe asistence nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë. Konsideratat e para të shprehura nga Misioni janë shumë pozitive.

Së nëndti, KLSH po përpiqet të rrisë aftësitë e stafit të KLSH në përdorimin e teknologjisë së informacionit, për të fuqizuar kapacitetet e institucionit në zbulimin dhe parandalimin e krimit ekonomik në IT. Eshte ende në fillim. Ky objektivi është shumë koherent në zhvillimet e sotme, kur qeverisja elektronike ka marrë përparësi dhe është shtrirë bindshëm në të gjitha sferat e veprimtarisë publike. Për ta realizuar atë, KLSH:

1. Ka përfunduar shërbimin e komunikimit elektronik në sistem brenda institucionit, duke :

- a. ngritur dhe konfiguruar një server me programin Windows 2000;
 - b. instaluar programi MDaemon v10. për postën elektronike dhe konfiguruar të gjithë përdoruesit;
 - c. hartuar rregulloren e komunikimit elektronik në KLSH;
 - d. ngritur librin e adresave për postën elektronike të KLSH me domain “...@klsh.org”
2. Ka përgatitur materialin trajnues dhe zhvilluar trajnim me të gjitha departamentet e drejtoritë mbi programin e auditimit IDEA, program i cili perdoret nga SAI-t e zhvilluara, për rritjen e cilësisë e uljen e kostos së auditimit;
3. Ka përfunduar përzgjedhjen, zbatimin dhe marrjen në dorëzim i programit të legjislacionit shqiptar Alba-Lex prodhim i kompanisë DATATECH për server me shërbim për gjithë rrjetin kompjuterik të KLSH. Sot çdo auditues mund të kërkojë dhe sigurojë aktet ligjore e nënligjore në formë elektronike;
4. Ka përfunduar zgjedhjen, përshtatjen dhe instalimin e programit të menaxhimit të burimeve njerëzore të KLSH.

Së fundi, institucioni ka përmirësuar ndjeshëm transparencën dhe komunikimin me publikun dhe me qytetarin, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me mediat dhe shoqatat jo-fitimprurëse të interesuara për bashkëpunim, por dhe në raportet me qytetarët e thjeshtë denoncues dhe që ankohen.

Ky objektivi ka qenë në vëmendjen absolute të KLSH, për të realizuar misionin e tij kushtetues të informimit me përparësi dhe me transparencë të plotë të publikut, si dhe në zbatim të standardit bazë të INTOSAI, ISSAI 20, i cili rendit ndër parimet themelore të punës së një institucioni suprem auditimi (Parimi 8):” *SAI-t komunikojnë në kohë dhe gjerësisht për aktivitetet e tyre dhe rezultatet e auditimeve nëpërmjet medias, faqeve në internet dhe mjeteve të tjera të komunikimit masiv*”.

Për realizimin e objektivit, KLSH:

- a) hartoi një udhëzues i veçantë për procedurën që duhet të ndiqet për pranimin e shpejtë, shqyrtimin eficient dhe mënyrën e zgjidhjes së problemeve të ngritura në letrat e dërguara nga qytetarët. Në hartimin e

Udhëzuesit u shfrytëzua përvoja e institucioneve të tjera, si Këshilli i Ministrave, Avokati i Popullit, etj. Gjatë këtij 6-mujori, institucionit i kanë ardhur 165 letra dhe ankesa për probleme të ndryshme, nga të cilat 38 ishin jashtë kompetencave të tij. Nga 127 kërkesa dhe ankime në kompetencë të KLSH, 73 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigjja përkatëse, ndërsa 54 janë në vazhdim të verifikimit.

b) Analizat vjetore 2011 të departamenteve të KLSH u zhvilluan në praninë e gazetarëve. Ato patën jehonë edhe në shtypin e ditës.

c) Rezultatet e auditimeve u janë komunikuar mediave në vijimësi, me transparencë të plotë dhe pa konsiderata hipotetike për abuzimet dhe vjedhjet e mundshme të pronës shtetërore. Kontaktet dhe komunikimi me mediat janë rritur ndjeshëm. Vetëm në periudhën janar-qershor 2012 u transmetuan për KLSH rreth 204 sekuenca filmike, edicione informative apo kronika të ndryshme televizive, ose më shumë se dy herë numrin e kronikave të realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2011. Janë botuar 278 artikuj në median e shkruar, ndërkohë që për të gjithë vitin 2011 ata kanë qenë vetëm 280.

d) Institucioni nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me gjashtë nga organizatat jofitimprurëse (OJF) më të spikatura të vendit në luftën kundër korrupsionit dhe për rritjen e transparencës (aktivitet i përmendur dhe me siper). Marrëveshjet u lidhën nën moton e organizatës ndërkombëtare të institucioneve supreme të kontrollit, INTOSAI “ Eksperienca e përbashkët i shërben të gjithëve” dhe synojnë kontribute dhe aktivitete të përbashkëta të KLSH dhe shoqatave, si vrojtme, prognoza dhe studime të përbashkëta, pjesëmarrje reciproke në workshope, simpoziume, konferenca, etj për luftën ndaj korrupsionit, parandalimin e tij dhe rritjen e transparencës së institucioneve publike. Me këto marrëveshje është realizuar Parimi 9 themelor i SAI-t në standardin bazë ISSAI 20, i cili kërkon SAI-t “*Përdorimin*

e këshillës dhe ekspertizës së jashtme të pavarur për të rritur cilësinë dhe besueshmërinë e punës së SAI-t’.

Shtrohet pyetja: **Çfarë do të bëjë KLSH në gjysmën e dytë të këtij viti?**

Së pari, institucioni ka marrë komentet dhe sygjerimet përfundimtare nga SIGMA dhe Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të Komisionit të BE, për rishikimin dhe bërjen e amendimeve në Ligjin Organik të KLSH. Këto komente na orientuan më drejtë se ku duhet ndërhyrë në ligjin e derisotëm, për të fuqizuar të drejtat kushtetuese, për të zgjeruar fushën e auditimeve financiare me certifikimin e llogarive financiare, si dhe për të rritur nivelin e zbatimit të rekomandimeve tona. Nëpërmjet amendamenteve që kemi përgatitur rregullohen në mënyrë përfundimtare pavarësia e institucionit, konceptimi modern i të drejtave dhe detyrave të KLSH, rritja e kapaciteteve administrative, saktësimi i së drejtës së KLSH të auditojë fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë deri tek përdoruesi i fundit dhe saktësimi i së drejtës të certifikojë llogaritë financiare. Në qershor 2012 Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të Komisionit të BE dërgoi dhe dy sugjerime të fundit dhe rikonfirmoi mbështetjen e saj për draft-ligjin, duke u shprehur se varianti i fundit është “...*më i strukturuar dhe frazeologjia e sjellë më pranë standardeve të INTOSAI-t’*”(nga letra e z. Robert Gielisse, Kryetar i Njesisë së Buxhetit, drejtuar KLSH më datën 29 qershor 2012). Me marrjen dhe të miratimit përfundimtar nga ana e SIGMA, do të dërgojmë draft-ligjin me amendamentet në Kuvend në vjeshtë të këtij viti. Ky aksion ligjberës do të na krijojë hapësira më të mëdha për të plotësuar më me efikasitet misionin tonë kushtetues,

Së dyti, me SIGMA është biseduar për të koordinuar një program të gjerë plotësues trajnimi, ku ndihma e institucioneve të larta të auditimit si Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë, NIK i Polonisë, Gjykata e Auditimit e Sllovenisë do të inkuadrohet natyrshëm në mbështetjen e fortë që vetë SIGMA do t’i japë KLSH jo vetëm për gjysmën e dytë të këtij viti, por edhe përgjatë gjithë vitit 2013, deri në nisjen e projektit të binjakëzimit me fondet IPA 2013, i cili pritet të fillojë në vitin 2014. Këto trajnime do të thellojnë dhe plotësojnë dijet e audituesve tanë për

auditimin e mirëfilltë financiar dhe të pajtueshmërisë, për auditimin aq të nevojshëm e parësor të performancës, për auditimin e integritetit dhe anti-korrupsion, si dhe për përdorimin e gjerë të mjeteve të IT dhe të auditimit të IT, sidomos për procedurat e prokurimeve publike, aktivitetit tatimor e doganor, etj.

Së treti, ekspertët e SIGMA do të orientojnë dhe drejtojnë KLSH gjatë gjithë gjysmës së dytë të vitit në përgatitjen e Planit të tij strategjik të Zhvillimit 2013-2016, i cili do të bazohet në përqendrimin e punës audituese drejt auditimit të performancës, në thellimin e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë, si dhe në intensifikimin e luftës kundër korrupsionit dhe për parandalimin e tij, duke punuar në sistem me të gjithë partnerët shtetërorë dhe të shoqërisë civile.

-/-

RAPORT

Mbi Analizën 6/mujore të vitit 2012 të Veprimtarisë së Departamenteve të Auditimit të Buxhetit Qendror dhe të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, si dhe të Drejtorisë Ekonomike

Z. Robert Gjini
Drejtori i Përgjithshëm

Në këtë analizë 6/mujore të vitit 2012, do të fokusohen në punën e kryer dhe rezultatet e arritura gjatë kësaj periudhe, nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, Departamenti i Auditimit të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit dhe Drejtoria Ekonomike, po kështu nga ana ime.

Rezultatet e arritura, si dhe dobësitë e konstatuara, të cilat do të paraqes në raportimin tim, përgjithësisht përcaktojnë dhe performancës e punës sime.

Fillimisht, do të paraqes:

1. Realizimin 6/mujor të objektivave dhe detyrave të matshme të programuara për këtë periudhë, të shprehura me shifra dhe përqindje;
2. Më pas, realizimin e aktiviteteve të parashikuara në programin e 100 ditëve (janar-prill 2012);
3. Do të vijoj me disa përfundime të nxjerra bazuar në rezultatet e veprimtarisë audituese të punonjësve të dy departamenteve të auditimit të sipërcituara; dhe
4. Së fundmi, përdorimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore të planifikuara për KLSH për këtë 6/mujor.

I. Realizimi i objektivave dhe detyrave të matshme të parashikuara për 6/mujorin e parë 2012.

a) Referuar programit të veprimtarisë audituese të miratuar në fillim të vitit 2012 nga Kryetari i KLSH, për të dy Departamentet e Auditimit kanë qenë parashikuar për t'u evaduar gjatë 6/mujorit të parë 2012, gjithsej **33** auditime, në fakt janë realizuar **29** auditime, me një mosrealizim prej **4** auditimesh. Ndarë sipas departamenteve, DABQ&ALP&MF&AB nga 22 auditime të programuara ka **realizuar 23, ose 1 më tepër**; kurse DAABSH nga 11 auditime të programuara ka **realizuar 6 auditime ose 5 më pak**, kryesisht subjekte që i përkasin sektorit të tatim-taksave, si pasojë e mosfillimit të auditimit në subjektet e programuar gjatë këtij 6/mujori, si në Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, Drejtoritë Rajonale Tatimore Tiranë, Vlorë dhe Fier.

Gjatë muajit korrik dhe fillimi i muajit gusht 2012, janë në proces evadimi **7 auditime**, nga të cilat 4 i përkasin DABQ&ALP&MF&AB dhe 3 DAABSH. Më konkretisht:

a) (DABQ&ALP&MF&AB) –ISSH, ISKSH, MTKRS dhe ATSH (performancë).

b) (DAABSH) - auditimi i performancës në DPD; auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare në DPT dhe auditimi në Degën Doganore Fier.

▪ Sipas llojit të auditimeve, auditimet financiare nga **6** të programuara janë realizuar **6**; kurse auditimet e performancës nga **2** të programuara është realizuar **1**, dhe ky auditim i prapambetur nga viti i kaluar në DPD mbi sistemin e funksionimit të penaliteteve. Ndërkohë, janë në proces evadimi ditët e fundit të muajit korrik apo fillimit të muajit gusht, **2 auditime performance**, 1 nga DABQ&ALP&MF&AB të ushtruar në ATSH Tiranë mbi eficiencën dhe efektivitetin e këtij institucioni dhe 1 nga DAABSH në DPD mbi ecurinë e importit të mallrave të akcizës dhe efektet në të ardhurat e buxhetit të shtetit.

Performanca e KLSH janar-qershor 2012

b) Për periudhën raportuese, në **29** auditimet e evaduara nga të dy departamentet e auditimit, janë bërë gjithsej **444** rekomandime të llojeve të ndryshme për përmirësimin e gjendjes dhe është kërkuar shpërblimi i dëmit në shumën **740,354 mijë lekë**; për të cilat bazuar në përgjigjet e dërguara nga vetë subjektet e audituar, në zbatim të nenit 9 dhe 16 të Ligjit Organik të KLSH, numri i rekomandimeve të **realizuara plotësisht dhe ato në proces rezulton 256, ose në masën rreth 58%**; ndërsa vlefëta për shpërblim për të cilat janë **nxjerrë urdhrat e shpërblimit të dëmit dhe ato në proces rezulton 713,096 mijë lekë, ose në masën rreth 96%**. Më konkretisht:

Nr.	EMËRTIMI	Rekoma-nduar Gjithsej	Nga këto realizuar:			Në % (2:1)
			Plotësisht	Në proces	Pa realizuar	
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
1.	Propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore	16	4	8	4	25
1.1	DABQ&ALP&MF&AB	15	4	8	3	27
1.2	DAABSH	1	-	-	1	0
2.	Masa Organizative	270	102	87	81	38
2.1	DABQ&ALP&MF&AB	249	95	86	68	38
2.2	DAABSH	21	7	1	13	33
3.	Masa Disiplinore	146	25	30	91	17
3.1	DABQ&ALP&MF&AB	121	25	30	66	21
3.2	DAABSH	25	-	-	25	0.00
4.	Masa Administrative	12	-	-	12	0.00
4.1	DABQ&ALP&MF&AB	12	-	-	12	0.00
4.2	DAABSH	-	-	-	-	-
I.	TOTALI (1+2+3+4):	444	131	125	188	30
I.1	DABQ&ALP&MF&AB	347	124	124	149	36
I.2	DAABSH	47	7	1	39	15
5.	Masa zhdëmtimi – numër	82	45	24	13	55
5.a	DABQ&ALP&MF&AB	72	41	23	8	57
5.b	DAABSH	10	4	1	5	40
5.1	Masa zhdëmtimi mijë/lekë	740,354	628,573	84,523	27,258	85
5.1a	DABQ&ALP&MF&AB	718,961	624,810	81,987	12,164	87
5.1b	DAABSH	21,293	3,763	2,536	15,094	17.6
6.	Kallëzime Penale–në numër	5	-	-	-	-
6.1	DABQ&ALP&MF&AB	5	-	-	-	-
6.2	DAABSH	-	-	-	-	-
6.a	Kallëzime Penale-në persona	21	-	-	-	-
6.b	Kallëzime Penale–në mijë/lekë	608,841	-	-	-	-

Ndonëse, Ligji Organik i KLSH dhe Urdhri i Kryeministrit nr. 70, datë 18.4.2006 “Për masat në zbatim të rekomandimeve të KLSH, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ e Antikorrupsion në KM, në institucionet në varësi të Kryeministrit e të Ministrive”, kërkojnë dhe urdhërojnë zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, niveli i realizimit të rekomandimeve të dërguara subjekteve të audituar këtë 6/mujor, rezulton i ulët, **vetëm 30% (po të zbresim rekomandimet që janë në proces gjithsej 125)**.

Për mendimin tim, janë disa arsye që kanë pasur impakt negativ në këtë nivel realizimi, si:

- disa nga subjektet kanë kthyer përgjigje pjesore, duke anashkaluar mjaft rekomandime, sidomos ato për përmirësime ligjore, administrative dhe disiplinore;
- disa subjekte të tjerë si METE, MPCSSH (auditimi për spotet), KQZ, Qendra e Publikimeve Zyrtare, DPD dhe Dega Doganore Berat, nuk kanë kthyer përgjigje brenda periudhës 6/mujore;

Performanca e KLSH janar-qershor 2012

- gjithashtu, disa subjekte të audituar, të cilëve raportet e auditimit së bashku me masat rekomanduese u janë dërguar ditët e fundit të muajit qershor, janë brenda kufirit ligjor limit 20 ditor për kthimin e përgjigjeve.

Theksoj se, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, si; numri i auditimeve të evaduar, zbulimet me pasojë dëm ekonomik, rekomandimet e bëra (me përjashtim të propozimeve për ndryshim ose përmirësime ligjore), si dhe kallëzimet penale, paraqiten me rritje të ndjeshme, dhe konkretisht:

Nr.	EMËRTIMI	6/mujori 2011	6/mujori 2012	Në % 2012/2011
I.	Auditime të evaduara gjithsej	27	29	107.4
I.1	DABQ&ALP&MF&AB	21	23	110
I.2	DAABSH	6	6	100
II.	Zbulime me dëm ekonomik (në mijë lekë)	77,484	745,919	9.6 herë
II.1	DABQ&ALP&MF&AB	46,466	724,526	15.5 herë
II.2	DAABSH	31,020	21,393	69
III.	Rekomandime gjithsej në numër (1+2+3+4)	394	444	113
III.1	DABQ&ALP&MF&AB	266	397	149
III.2	DAABSH	128	47	37
1.	Propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore	21	16	76
1.1	DABQ&ALP&MF&AB	20	15	75
1.2	DAABSH	1	1	100
2.	Masa organizative	261	267	102
2.1	DABQ&ALP&MF&AB	172	246	143
2.2	DAABSH	89	21	24
3.	Masa disiplinore	118	146	124
3.1	DABQ&ALP&MF&AB	70	121	173
3.2	DAABSH	48	25	52
4.	Masa administrative	4	12	300
4.1	DABQ&ALP&MF&AB	4	12	300
4.2	DAABSH	-	-	-
IV.	Kallëzime penale, në numër rastesh	2	5	2.5 herë
IV.1	DABQ&ALP&MF&AB	-	5	5 herë
IV.2	DAABSH	2	-	0.00
1.	Në numër personash	2	21	
1.1	DABQ&ALP&MF&AB	-	21	
1.2	DAABSH (për shpërdorim detyre, K/Degës Tatimore Durrës dhe Sarandë)	2	-	
2.	Në vlerë (mijë/lekë)	-	608,841	
2.1	DABQ&ALP&MF&AB	-	608,841	
2.2	DAABSH	-	-	

a) Nga vlera e dëmit ekonomik prej 745,919 mijë lekë, të konstatuar dhe evidentuar gjatë këtij 6/mujori, nga KLSH është kërkuar nxjerrja e titujve ekzekutivë dhe ndjekja në rrugë ligjore për arkëtimin e saj në masën 100 për qind. Nga kjo vlerë dëmi, kërkuar për dëmshpërblim, gjendja paraqitet:

- për shumën **628,573 mijë/lekë** titullarët e subjekteve të audituar kanë nisur procedurat dhe kanë nxjerrë urdhrat për kthimin e vlerave të përfituara padrejtësisht; ndërkohë që shuma prej **84,523 mijë/lekë** është në procesin e verifikimit apo gjykimit; kurse për shumën **27,258 mijë/lekë**, e cila zë rreth **4% të totalit të vlerës**, subjektet ende nuk kanë kthyer përgjigje, për rrjedhojë konsiderohen të pazbatuara.

- Krahas sa më sipër, janë konstatuar dhe evidentuar *shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituar, në shumën totale prej 1,448,704 mijë lekë*, e konstatuar tërësisht nga audituesit e DABQ&ALP&MF&AB, në:
 - *METE*, shuma **1,113,730 mijë lekë**, në dhënien e pronës publike me koncension në industrinë e bakrit, kromit dhe energjetikës;
 - *Autoritetin Rrugor Shqiptar*, **285,788 mijë lekë** si pasojë e llogaritjes së gabuar të analizave teknike të çmimeve dhe rritjen artificiale të fondit limit për disa raste;
 - *Qendrën e Publikimeve Zyrtare*, **22,553 mijë lekë**, shkaktuar nga shpërndarja falas e kopjeve të fletores zyrtare dhe botimeve të tjera, si dhe shitja e botimeve përfshirë dhe fletoren zyrtare me çmime më të ulta se kostoja e prodhimit;
 - *Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë* **13,756 mijë lekë**, parashikuar më tepër vlera e kontratës në 4 objekte për ndërtimin dhe rehabilitimin e ujësjellësve; dhe
 - *MMPAU*, **12,877 mijë lekë**, nga menaxhimi i dobët i punës për llogaritjen dhe mbledhjen e të ardhurave për vitin 2010 dhe 6/mujorin e parë 2011.

b) Lidhur me *propozimet për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi*, të rekomanduara nga KLSH **gjithsej 16, janë zbatuar 4**. Këtu nuk janë përfshirë përgjigjet e mbërritura në KLSH në fund të muajit korrik 2012 nga Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor dhe Dega e Doganës Tiranë, ndërkohë që priten përgjigje për masat e marra nga:

- Autoriteti Rrugor Shqiptar për 3 rekomandime; Qendra e Publikimeve Zyrtare 2; MASH 1; MMPAU 1; Administrata e Presidentit të Republikës 1; ATSH 1; dhe Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë 1.

c) Përsa i përket *masave disiplinore* të rekomanduara, **146 gjithsej**, konstatohet një rritje e masave të tilla si, pezullim, ulje në detyrë, largim nga shërbimi civil apo detyra dhe konkretisht:

- “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për 1 vit”, janë rekomanduar 9 masa;
- “Kalim në detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një vit” 23 masa;
- “Largim nga shërbimi civil” 9 masa;
- “Largim nga detyra” 7 masa;
- “Largim nga puna - zgjidhje kontrate” 4 masa; **gjithsej 52 masa ose në masën rreth 40%**, shifër kjo 4 herë më e madhe krahasuar me një vit më parë ku janë propozuar gjithsej 13 masa të tilla.

d) Kallëzimet penale të depozituara në organet e prokurorisë gjatë këtij 6/mujori, **gjithsej 5**, janë bërë të gjitha nga DABQ&ALP&MF&AB. Në krahasim me një vit më parë ku janë bërë 2 kallëzime penale për shpërdorim detyre nga DAABSH, këtë vit ato janë 2.5 herë më shumë.

Lidhur me nivelin e pamjaftueshëm të realizimit të rekomandimeve, theksoj se, krahas kërkesave të vazhdueshme dhe përpjekjeve që duhet të bëjmë në vijimësi pranë subjekteve të audituar, të gjithë ne, duke filluar nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve, Krye-audituesit, Përgjegjësit e Grupeve të Auditimit dhe vetë audituesit sipas përkatësisë, në zbatim të rregullores së brendshme dhe të programit vjetor të auditimit, duhet të fillojmë nga përgatitjet për ushtrimin

e auditimit në muajt nëntor-dhjetor 2012 në të gjithë subjektet e audituar, për zbatimin e rekomandimeve të dërguara.

2. Realizimi i aktiviteteve të parashikuara në programin e 100 ditëve (janar-prill 2012).

Referuar programit “Mbi objektivat dhe aktivitetet për zbatim nga KLSH në 100 ditë, nga 3 janari 2012 deri në 15 prill 2012”, lidhur me ndjekjen dhe realizimin e tyre raportoj përvoja vijon:

- Janë përgatitur raportet respektive nga unë, departamentet dhe drejtoria ekonomike dhe janë kryer analizat e veprimtarisë të vitit 2011, të hapura dhe transparente, duke kërkuar dhe siguruar prezencën në këto analiza, të medias dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile.
- Kontributin tim, të punonjësve të Departamenteve të Auditimit e të Drejtorisë Ekonomike, në përgatitjen e raportit për veprimtarinë e vitit 2011 të KLSH, raport i cili u paraqit në Kuvend dhe u raportua në muajin mars 2012 në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave.
- Bashkëpunimin me Drejtoren e Drejtorisë J&KC dhe punonjësit e tjerë të ngarkuar në programin e 100 ditëve, për marrjen e sugjerimeve nga SIGMA dhe Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në BE, për amendimet e bëra nga ana e jonë në Ligjin Organik të KLSH
- Në bashkëpunim me Drejtoren e Drejtorisë J&KC, Drejtorin e Departamentit KSH&ZH&TI, si dhe grupin e audituesve të cilësuar në program, përfshirë Kryeauditues dhe auditues nga të dy Departamentet e Auditimit, kemi punuar për hartimin e rregullores së re të brendshme për organizimin dhe funksionimin e KLSH, tashmë e miratuar dhe e shpërndarë për ndjekje dhe zbatim.
- Bashkëpunimin me Drejtoren e Drejtorisë J&KC dhe juristin e kësaj Drejtorie z. Koço Sokoli për rishikimin dhe përgatitjen e draf-marrëveshjes së bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme, marrëveshje tashmë e lidhur dhe hyrë në fuqi për zbatim.
- Bashkëpunimin me grupet e punës të ngarkuar për përmirësimin e paraqitjes dhe përmbajtjes të materialeve të auditimit, si dhe hartimin e dokumentave standarde të auditimit, përfshirë Kryeauditues dhe auditues nga të dy Departamentet e Auditimit, tashmë të miratuar dhe pjesë përbërëse të rregullores së re, të shpërndarë për ndjekje dhe zbatim.
- Plotësimin nga Drejtori dhe audituesit e DABQ&ALP&MF&AB të detyrës për përcaktimin në çdo program kontrolli të një pike të veçantë për vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Ngritjen brenda DABQ&ALP&MF&AB, të Sektorit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, përcaktimi dhe miratimi i mënyrës së funksionimit të tij, si dhe detyrat që duhet të ndjekë e të realizojë.
- Bashkëpunimin me Drejtoren e DJ&KC dhe Drejtorin e DKSH&ZH&TI, për përgatitjen e draft-marrëveshjes me ILDKP, marrëveshje tashmë e lidhur dhe hyrë në fuqi për zbatim.
- Bashkëpunimin me Drejtoren e DJ&KC dhe Drejtorin e DKSH&ZH&TI, për përgatitjen e draft-marrëveshjes me Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në KM, draft i cili është përgatitur dhe dërguar këtij Departamenti, por ende pa përgjigje prej tij.
- Bashkëpunimin me Drejtorët e Departamenteve të ABQ&ALP&MF&AB dhe DKSH&ZH&TI, si dhe Drejtoren e Drejtorisë J&KC, për hartimin e projekt/marrëveshjes të bashkëpunimit me NJQHAB dhe DIFP në MF, marrëveshje tashmë e lidhur me MF, hyrë në fuqi dhe filluar nga konkretizimi. Sekretariati i ngritur bazuar në nenin 5 të kësaj marrëveshjeje i përbërë nga Drejtori i Përgjithshëm në KLSH Kryetar i Sekretariatit, dhe anëtarë Drejtori i NJQHAB z. Igli Stambolla dhe Drejtori i IFP z. Ilir Meçe, në takimin e organizuar analizuan rezultatet e deritanishme të bashkëpunimit dhe përcaktuan drejtimit e bashkëpunimit në të ardhmen. Madje, në përfundim të takimit u hartua dhe Raporti përkatës drejtuar Kryetarit të KLSH dhe Ministrit të Financave, kërkesë kjo e marrëveshjes. Mbi bazën e këtij raporti, Kryetari

i KLSH ka nxjerrë për zbatim urdhërin nr. 74, datë 09.07.2012 urdhër me të cilin tashmë jeni njohur dhe po ndiqni zbatimin e tij.

- Në bashkëpunim me sektorin e statistikës, realizimin e detyrës për dërgimin në Departamentin e Administratës Publike, të të dhënave për nëpunësit publikë të përgjegjësuar nga KLSH për shkelje nga më të ndryshmet gjatë ushtrimit të detyrës.
- Realizimin e detyrës për vendosjen e kontakteve të bashkëpunimit me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe vijimin e bashkëpunimit.
- Bashkëpunimin me Drejtorin e MJ&P dhe Drejtoreshen e DJ&KC, për përgatitjen e draft-marrëveshjes së bashkëpunimit me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, marrëveshje tashmë e lidhur, hyrë në fuqi dhe në proces materializimi.
- Realizimin e detyrës për dërgimin e kërkesës SIGMA për përfitim të asistencës teknike nëpërmjet një Projekti Binjakëzimi, me synim ngritjen e kapaciteteve në fushën e auditimit të performancës, certifikimit të pasqyrave financiare dhe teknologjisë së informacionit. Siç jeni në dijeni, në saj të mbështetjes së SIGMA, sidomos të z. Joop Vrolijk është në proces sigurimi i një Projekti Binjakëzimi me fondet e IPA për vitin 2013, ndërkohë që SIGMA z. Vrolijk me mbështetjen e DPB të BE ka filluar asistencën ndaj KLSH me seminarët urëlidhëse, siç ishte Seminari nismëtar i zhvilluar javën e kaluar me temë “Mbështetja e SIGMA ndaj KLSH” ku morën pjesë 50 punonjës të KLSH, si dy Drejtorët e Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive, Kryeaudituesit, audituesit e lartë dhe të gjithë audituesit e DABQ&ALP&MF&AB. Ndër temat e prezantuara përmend “Zhvillimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik”, “Zhvillimi i funksionit të inspektimit financiar”, “Marrëdhënia Autoritet i Auditimit dhe SAI - rolet dhe përgjegjësitë”, “Zhvillimi i auditimit të brendshëm në sektorin publik”, “Auditimi financiar”, “Auditimi i pajtueshmërisë”, “Auditimi i performancës” dhe “Auditimi TI”.

Seminare të tjerë do të pasojnë në muajt e ardhshëm të vitit 2012 dhe në fillim të vitit 2013.

- Bashkëpunimin me Drejtorin e DKSH&ZH&TI, Drejtorin e DMJ&P dhe Drejtoreshen e DJ&KC për organizimin e një tryeze të përbashkët me organizatat jofitimprurëse, e cila u zhvillua dhe u konkretizua më tej nga Kryetari i KLSH me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me gjashtë organizata jofitimprurëse të vendit, më të spikatura në luftën kundër korrupsionit dhe për rritjen e transparencës.
- Dërgimin në Kuvendin e Shqipërisë, në zbatim të nenit 3 të Ligjit Organik të KLSH të kërkesës për ushtrimin e një kontrolli mbi llogaritë vjetore të institucionit, nga një organizëm i pavarur i caktuar nga Kuvendi.
- Punën e bërë deri tani për trajnimin e punonjësve të dy Departamenteve të Auditimit, si brenda institucionit të KLSH dhe në institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit. Referuar të dhënave të raportuara në nivel institucioni, deri në fund të muajit qershor 2012, ishin realizuar mesatarisht 6.2 ditë trajnimi për punonjësit me përvojë pune dhe 12.7 ditë trajnimi për audituesit dhe specialistët e rinj.

3. Disa përfundime të nxjerra bazuar në rezultatet e veprimtarisë audituese të punonjësve të dy Departamenteve të Auditimit.

Duke pasur rezervat e mia për përfundimet e nxjerra për veprimtarinë e realizuar gjatë këtij 6/mujori nga stafi auditues i të dy Departamenteve të Auditimit, të cilat do t'i paraqes në vijim, më lejoni të parashtoj përsa vijon:

1. Në shqyrtimi i dosjes së auditimit në **METE** për koncensionet, me Përgjegjës Grupi Bajram Lamaj dhe auditues Andrea Kristo dhe Fadil Dekovi, filluar në 1 nëntor 2011, rezulton se nuk janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe

evadimin e materialeve të auditimit, kryesisht si pasojë e ngërçit të krijuar në fund të vitit 2011. Ky grup ka propozuar **23** masa organizative; **25** raste zhdëmtimi në shumën **606,926 mijë lekë**; **24** masa disiplinore (2 “largim nga shërbimi civil”, 4 “kalim në detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një vit”, 14 “vërejtje me shkrim”, gjithashtu për 4 ish punonjës përkatësisht 2 drejtorë, 1 përgjegjës sektori dhe 1 Kryetar i Njesisë së Hartimit të Dokumenteve, ka propozuar të njoftohet DAP që për ta duhej dhënë masa disiplinore “largim nga shërbimi civil”.

Gjithashtu, nga moszbatimi i akteve nënligjore në fuqi, buxhetit të METE i është shkaktuar një mungesë në të ardhurat në shumën rreth **1,113,730 mijë lekë**.

Ky grup ka bërë dhe **dy kallëzime penale** në organet e prokurorisë për **5** punonjës të kësaj ministrie, për vleftën e dëmit ekonomik **595,146 mijë lekë**.

2. Në **MPPT**, me Përgjegjës Grupi Bajram Lamaj dhe auditues Andrea Kristo, Nikoleta Piranian dhe Vjollca Selmani, filluar në 5 shtator 2011, nuk janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit, dhe kjo kryesisht si pasojë e ngërçit të krijuar në fund të vitit 2011. Ky grup ka propozuar **15** masa organizative; **2** masa zhdëmtimi në shumën **15,657 mijë lekë**; si dhe lënien në kompetencë të Titullarit të Ministrisë dhënien e masës disiplinore për ish Drejtorin e DRSHTRR, Kryetarin dhe antarët e Këshillit Drejtues të DRSHTRR.

3. Në **MMPAU**, me Përgjegjës Grupi Bajram Lamaj dhe auditues Fadil Dekovi dhe Vjollca Selmani, filluar në 1 shkurt 2012, rezulton se janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **1** masë për përmirësim ligjor; **18** masa organizative; dhe **10** masa disiplinore (8 “vërejtje me shkrim” sipas statusit të nëpunësit civil dhe dhe 2 “vërejtje me shkrim” sipas kodit të punës dhe kontratës të lidhur ndërmjet punëdhësit dhe punëmarrësit). Gjithashtu, nga menaxhimi i dobët i punës për llogaritjen dhe mbledhjen e të ardhurave për vitin 2010 dhe 6/mujorin e parë 2011, janë krijuar debitorë në vlerën **112,877 mijë lekë**.

4. Në **7 Ministri (Kryeministri, MPÇSSHB, MTKRS, MPJ, MM, MI dhe MB)** për shpenzimet e bëra për spotet publicitare, veprimtari dhe festa të ndryshme, me Përgjegjës Grupi Fadil Dekovi me auditues Bajram Lamaj dhe e kundërta, janë rekomanduar **1** propozim për përmirësim ligjor në legjislacionin në fuqi, **1** masë organizative; **3** raste zhdëmtimi në shumën **9,527 mijë lekë**; **19** masa disiplinore (4 “zgjidhje të kontratës së punësimit”, 6 “pezullim si nëpunës civil” dhe 9 “vërejtje me shkrim”); gjithashtu, janë bërë **dy kallëzime penale** në organet e prokurorisë, përkatësisht për **7** punonjës të **MPÇSSHB**, për vleftën e dëmit ekonomik **9,238 mijë lekë** dhe **3** punonjës të **MTKRS** për vleftën e dëmit **4,457 mijë lekë**.

5. Në **METE**, në auditimin e kryer për vlerësimin e veprimtarisë ekonomike financiare, me Përgjegjës Grupi Aleksandër Tereziu dhe auditues Din Zenelaj, Yllka Dede, Nerënxa Llapashtica, filluar në 5 shtator 2011, rezulton se nuk janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit, kryesisht si pasojë e ngërçit të lartpërmendur. Ky grup ka propozuar **13** masa organizative; **2** masa zhdëmtimi në shumën **1,450 mijë lekë**; **18** masa disiplinore (1 “kalim në detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një vit”, 1 “vërejtje me paralajmërim”, 2 “vërejtje me shkrim”; nga të cilat i janë propozuar APP **14** masa, përkatësisht 4 “kalim në detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një vit”, 8 “vërejtje me shkrim” dhe 2 “vërejtje me paralajmërim”, nga të cilët 8 për punonjës të larguar.

6. Në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, me Përgjegjës Grupi Aleksandër Tereziu dhe auditues Pjetër Beleshi dhe Milo Pano, filluar në 6 shkurt 2012, rezulton se janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **1** përmirësim ligjor, **19** masa organizative; **7** raste zhdëmtimi në shumën **1,431 mijë lekë**; **6** masa disiplinore (1 “shkarkim nga detyra”, 1 “kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një vit”, 1 “vërejtje me paralajmërim”, 2 “vërejtje me shkrim” dhe 1 “këshillim”).

7. Në Qendrën e Publikimeve Zyrtare, me Përgjegjës Grupi Aleksandër Tereziu dhe auditues Pjetër Beleshi, Din Zenelaj dhe Milo Pano, filluar në 11 nëntor 2011, ka rezultuar se përgjithësisht janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **2** përmirësime ligjore, **18** masa organizative; **1** rast zhdëmtimi në shumën **133 mijë lekë**; **2** masa disiplinore “vërejtje me shkrim”; gjithashtu i është kërkuar APP shqyrtimi dhe dhënia e **9** masave disiplinore (1 “kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një vit” dhe 8 “vërejtje me shkrim”, nga të cilat 2 për punonjës të larguar nga puna). Gjithashtu, grupi ka konstautar se, nga shpërndarja falas të fletores zyrtare dhe botimeve të tjera, si dhe shitja e botimeve me çmime më të ulta se kostoja e prodhimit, është shkaktuar një mungesë në të ardhurat në shumën **22,553 mijë lekë**.

8. Në Administratën e Presidentit të Republikës, me Përgjegjës Grupi Aleksandër Tereziu dhe auditues Pjetër Beleshi dhe Vasil Vane, filluar në 23 prill 2012, rezulton se janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka rekomanduar **1** propozim për përmirësim ligjor në legjislacionin në fuqi dhe **4** masa organizative.

9. Në Autoritetin Rrugor Shqiptar, me Përgjegjës Grupi Bashkim Harizaj dhe auditues Aleksandër Papadhimitri dhe Mina Blushi, filluar në 3 tetor 2011, rezulton se përgjithësisht janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **3** përmirësime ligjore, **7** masa organizative; dhe **9** masa disiplinore “vërejtje me shkrim”. Gjithashtu, si pasojë e llogaritjes së gabuar të analizave teknike të çmimeve, grupi ka konstautar një efekt negativ ekonomik në shumën **200 milionë lekë**, kurse nga rritja artificiale e fondit limit në disa raste **85,788 mijë lekë**.

10. Në DPSHTRR, me Përgjegjës Grupi Bashkim Harizaj dhe auditues Luljeta Nano, Aleksandër Papadhimitri, Dritan Kore dhe Mina Blushi, filluar në 1 shkurt 2012, rezulton se përgjithësisht janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **1** përmirësim ligjor, **12** masa organizative; **5** raste të shpërblimit të dëmit në vlerën **17,934 mijë lekë**; dhe **10** masa disiplinore “vërejtje me shkrim”.

11. Në MASH, me Përgjegjës Grupi Luljeta Nano dhe auditues Ludmilla Sula, Vasil Vane, Monika Dushku dhe Mina Blushi, filluar në 5 tetor 2011, rezulton se përgjithësisht janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **1** përmirësim ligjor; **15** masa organizative; **2** raste zhdëmtimi në vlerën **937 mijë lekë**; **4** masa disiplinore (1 “zgjidhje e kontratës së punësimit” dhe 3 “vërejtje me paralajmërim”, si dhe **6** masa administrative për **6** mbikëqyrës punimesh dhe kolaudatorë “gjobë në shumën 50 mijë lekë për person”, gjithsej **300 mijë lekë**.

12. Në Bankën e Shqipërisë, me Përgjegjës Grupi Nerënxa Llapashtica dhe auditues Nikoleta Piranian, Evis Çela dhe Vasil Vane, filluar në 1 shkurt 2012, rezulton se janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka rekomanduar **3** propozime për përmirësime ligjore në legjislacionin në fuqi dhe **9** masa organizative.

13. Në Ministrinë e Drejtësisë, me Përgjegjës Grupi Vladimir Rizvani dhe auditues Dritan Kore dhe Evis Çela, filluar në 6 tetor 2011, rezulton se nuk janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **4** masa organizative dhe **1** masë zhdëmtimi në vlerën **880 mijë lekë**.

14. Në Agjencinë Telegrafike Shqiptare, me Përgjegjës Grupi Vladimir Rizvani dhe auditues Evis Çela, filluar në 7 shtator 2011, rezulton se është shkelur çdo lloj afati i përcaktuar në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **1** përmirësim ligjor; **2** masa organizative; **2** masa për shpërblimin e dëmit në vlerën rreth **1,168 mijë lekë**; dhe **3** masa disiplinore “vërejtje me shkrim”.

15. Në KQZ, me Përgjegjës Grupi Andrea Kristo dhe auditues Ludmilla Sula dhe Vladimir Rizvani, filluar në 1 shkurt 2012, rezulton se janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka rekomanduar **5** masa organizative dhe dy masa për shpërblim dëmi në shumën **1,079 mijë lekë**.

16. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë, me Përgjegjës Grupi Selime Bica dhe auditues Vladimir Vangjeli, filluar në 5 shtator 2011, rezulton se nuk janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **5** masa organizative dhe **1** masë zhdëmtimi në vlerën **146.5 mijë lekë**. Gjithashtu, Grupi ka konstatuar se, për ndërtimin dhe rehabilitimin e ujësjellësave, vlera e kontratës është parashikuar më e madhe në vlerën **13,756 mijë lekë**.

17. Në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, me Përgjegjës Grupi Selime Bica dhe auditues Vladimir Vangjeli, filluar në 24 tetor 2011, rezulton se përgjithësisht janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka rekomanduar **8** masa organizative; **1** masë për shpërblim dëmi në shumën **541 mijë lekë**; **6** masa administrative drejtuar Inspektoratit të Ndërtimit pranë Bashkisë Shkodër për **6** mbikëqyrës punimesh dhe kolaudatorë “gjobë në shumën 50 mijë lekë për person”, gjithsej **300 mijë lekë**; dhe **7** masa disiplinore (2 “vërejtje me paralajmërim” dhe 5 “vërejtje me shkrim”).

18. Në SHISH, me Përgjegjës Grupi Selime Bica dhe auditues Vladimir Vangjeli e Rasim Hoxha (dalë në pension), filluar në 15 mars 2012, rezulton se janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka rekomanduar **4** masa organizative.

19. Në Inspektoriatin Shtetëror të Punës, me Përgjegjës Grupi Zyhra Kepi dhe auditues Pranvera Doçi, Qeram Cibaku dhe Rajmond Koçi, filluar në 12 shtator 2011, rezulton se nuk janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **19** masa organizative.

20. Në Shërbimin Social Shtetëror, me Përgjegjës Grupi Zyhra Kepi dhe auditues Pranvera Doçi, Qeram Cibaku dhe Rajmond Koçi, filluar në 1 nëntor 2011, rezulton se përgjithësisht janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **20** masa organizative dhe **1** masë zhdëmtimi në vlerë **5 mijë lekë**.

21. Në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me Përgjegjës Grupi Zyhra Kepi dhe auditues Pranvera Doçi dhe Din Zenelaj, filluar në 1 shkurt 2012, rezulton se janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **16** masa organizative dhe **5** masa zhdëmtimi në shumën **60,103 mijë lekë**. Duhet pasqyruar se, masat disiplinore dhe **kallëzimin penal**, Grupi e ka lënë në kompetencë të Drejtores së ISSH, pas saktësimit të vlerës së dëmit ekonomik.

22. Në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MF (auditim vlerësues, me Përgjegjës Grupi Qeram Cibaku dhe auditues Selfo Zeneli dhe Rajmond Koçi, filluar në 1 shkurt 2012, rezulton se janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **14** masa organizative, disa prej të cilave janë kundërshtuar nga subjekti i audituar, me argumentin se janë jashtë kompetencave të tij.

23. Në DPD, auditim performance në fushën e shkeljeve doganore dhe sanksionet e zbatuara, me Përgjegjës Grupi Livan Hoxha dhe auditues Alfred Zylfi dhe Sali Agaj, filluar në 15 shtator 2011, rezulton se nuk janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit, kryesisht si pasojë e ngërçit të lartpërmendur. Në përfundim të këtij auditimi janë propozuar vetëm **3** masa organizative.

24. Në Degën Doganore Bllatë, me Përgjegjës Grupi Neritan Matoshi dhe auditues Përparim Gjuzi, filluar në 12 shtator 2011, nga shqyrtimi konstatohen vonesa në përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **4** masa organizative; **3** masa zhdëmtimi për vlerën **4,675 mijë lekë**; dhe **9** masa disiplinore, nga të cilat 1 “largim nga shërbimi civil” dhe 8 “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një vit”.

25. Në Degën Doganore Berat, me Përgjegjës Grupi Meritan Matoshi dhe auditues Përparim Gjuzi, filluar në 1 shkurt 2012, rezulton se përgjithësisht janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **4** masa organizative; **2** masa për shpërblim dëmi në vlerën **2,972 mijë lekë**; dhe **2** masa disiplinore, nga të cilat 1 “largim nga shërbimi civil” dhe 1 “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një vit”.

26. Në Degën Doganore Rinas, me Përgjegjës Grupi Faik Qosja dhe auditues Odhise Veshi dhe Hysen Metko, filluar në 1 shkurt 2012, rezulton se përgjithësisht janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të auditimit. Ky grup ka propozuar **4** masa organizative; **2** masa për shpërblimin e dëmit në vlerën **922 mijë lekë**; dhe **2** masa disiplinore “humbje e së drejtës së shpërblimit për një vit”.

27. Në Degën Doganore Tiranë, me Përgjegjës Grupi Alketa Pernaska dhe auditues Aqif Klosi, Xhovan Domi dhe Bashkim Shehu, filluar në 1 shkurt 2012, rezulton se janë respektuar afatet e përcaktuara në rregulloren e brendshme të KLSH për përgatitjen dhe evadimin e materialeve të

Performanca e KLSH janar-qershor 2012

auditimit. Ky grup ka rekomanduar **1** propozim për përmirësim ligjor në legjislacionin doganor në fuqi; **6** masa organizative; **3** masa për shpërbllim dëmi në vlerën **12,824 mijë lekë**; dhe **12** masa disiplinore, nga të cilat 6 “ulje një shkallë në kategori dhe transferimi nga pozicioni i punës për 6 muaj” dhe 6 “humbje e së drejtës së shpërbllimit për një vit”.

Shënim: Në numrin e auditimeve të sipërcituara nuk përfshihet auditimi për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH gjatë vitit 2011.

Përsa më sipër, në mënyrë të grupuar të dhënat për secilin Grup Auditimi të DABQ&MF&AB, rezulton:

<i>Nr.</i>	<i>Përgjegjësi Grupit</i>	<i>Numri i auditimeve</i>	<i>Numri i përmirësimeve ligjore</i>	<i>Numri i masave organizative</i>	<i>Numri i masave disiplinore</i>	<i>Numri i masave administrative</i>	<i>Masa zhdëmtimi mijë/lekë</i>
1.	Bajram Lamaj	4	2	57	55	-	632,110
2.	Aleksandër Tereziu	4	4	54	33	-	3,114
3.	Bashkim Harizaj	2	4	19	19	-	17,934
4.	Selime Bica	3	-	17	7	6=300,000 lek	687.5
5.	Zyhra Kepi	3	-	53	-	-	60,108
6.	Vladimir Rizvani	2	1	6	3	-	2,048
7.	Luljeta Nano	1	1	15	4	6=300,000 lek	937
8.	Nerënxa Llapashtica	1	3	9	-	-	-
9.	Andrea Kristo	1	-	5	-	-	1,079
10.	Qeram Cibaku (auditim vlerësues)	1	-	14	-	-	-
	TOTALI:	22	15	249	121	12=600,000 lek	718,961

▪ **Kallëzimet penale gjithsej 5**, nga të cilat 3 janë bërë nga grupet e auditimit me Përgjegjës Grupi *Bajram Lamaj*, 1 me Përgjegjës Grupi *Fadil Dekovi* dhe 1 i përket auditimit të bërë në MTKRS disa vite më parë.

Për Grupet e DAABSH, rezulton:

<i>Nr.</i>	<i>Përgjegjësi Grupit</i>	<i>Numri i auditimeve</i>	<i>Numri i përmirësimeve ligjore</i>	<i>Numri i masave organizative</i>	<i>Numri i masave disiplinore</i>	<i>Masa zhdëmtimi mijë/lekë</i>
1.	Neritan Matoshi	2	-	8	11	7,647
2.	Alketa Pernaska	1	1	6	12	12,824
3.	Faik Qosja	1	-	4	2	922
4.	Livan Hoxha	1	-	3	-	-
	TOTALI:	5	1	21	25	21,393

Nga shqyrtimi i të dhënave të lartpërmendura, secili Grup Auditimi dhe auditues është në gjendje të analizoj rezultatet dhe cilësinë e veprimtarisë audituese të tij, për rrjedhojë të vlerësojë **performancën e Grupit të tij të Auditimit dhe të vetvetes.**

Për më keq, më duhet të cilësoj se ka Grupe Auditimi për të cilët veprimtaria audituese e tyre le shumë për të dëshiruar, gjithashtu, ka mjaft auditues kryesisht të Departamentit të Auditimit të të ABSH, që janë prezent vetëm në 1 auditim të evaduar gjatë 6/mujorit të parë 2012.

Krahas konstatimeve korrekte dhe realiste të prezantuara më sipër, më duhet të parashtroj se, në performancën e njërit apo tjetrit Përgjegjës Grupi apo auditues, ndikim jo të pakët ka pasur natyra dhe volumi i punës të objektit të auditimit, lloji i auditimit, ndarja e subjekteve për auditim grupeve të auditimit; kompozimi i grupeve të auditimit (përbërja e tyre); niveli i materialitet dhe riskut të këtij apo atij auditimi etj. Shtoj se, për të nxjerrë përfundime më të sakta lidhur me performancën e njërit apo tjetrit auditues, duhej të përcaktonim paraprakisht indikatorë të tillë që të matnin apo të vlerësonin cilësinë dhe dobinë e përmbajtjes së formulimit të propozimit të bërë nga çdo grup apo auditues, çka aktualisht është e pamundur të realizohet.

Madje, në vlerësimin e produktit të veprimtarisë audituese të punonjësve të Departamentit të Auditimit të të ABSH, duhet konsideruar ndikimi i konfliktit tashmë disavjeçar me DPT, për auditimin e grumbullimit të të ardhurave nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, ku për 6/mujorin analizues nuk është kryer asnjë kontroll në këto Drejtori. Më duhet t'ju informoj se për këtë problem, në datën 24 korrik 2012, Kryetari i KLSH është takuar me Ministrin e Financave, të cilit për normalizimin e marrëdhënieve KLSH-DPT i ka propozuar miratimin e një Memorandumi Mirëkuptimi.

Përsa më sipër, krahas përgjegjësisë së dy Drejtorëve të Departamenteve të Auditimit dhe të Kryeaudituesve, më konkretisht:

- kërkesa e pamjaftueshme e tyre në procesin e studimit dhe hartimit të strategjisë afatmesme të planifikimit të auditimeve dhe programit vjetor të tyre, sidomos përcaktimin e objekteve dhe të tematikave të auditimit;
 - mosngarkesa dhe mosvënia në eficiencë e aftësive dhe nivelit të kualifikimit të audituesve, duke patur në konsideratë kualifikimin dhe arsimimin e tyre sipas degëve universitare;
 - mosndjekja në mënyrë sistematike në të gjitha fazat e auditimit, si të studim-planifikimit, të auditimit në terren, përgatitjes së materialeve, të raportimit dhe ndjekjes së rekomandimeve;
- Përgjegjësi mbaj edhe unë si Drejtor i Përgjithshëm i ngarkuar me monitorimin e veprimtarisë së këtyre dy departamenteve, për mosndjekjen në nivelin e kërkuar të veprimtarisë audituese të grupeve të auditimit, sidomos në terren, për t'u njohur nga afër me punën e tyre madje dhe të audituesve, për të dhënë ndihmën dhe ekspertizën përse disponoj, në mbarëvajtjen dhe rritjen e produktivitetit të veprimtarisë audituese të KLSH.*

Në kontekstin e realizimit të objektivave, aktiviteteve dhe detyrave të programuara për vitin 2012, mendoj të parashtroj disa drejtime ku duhet të përqendrohet më mirë vëmendja jonë dhe e punonjësve të auditimit, konkretisht në:

1. Rritjen e rolit dhe kontributit tonë në drejtim të miradministrimit të financave publike, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve më cilësore dhe raportimit mbi rregullshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të të gjithë burimeve financiare shtetërore.

2. Rritjen e ndjenjës së përgjegjësisë të gjithsecilit punonjës të dy departamenteve të auditimit për të kuptuar dhe vlerësuar përgjegjësinë që ata mbartin, para së gjithash ndaj institucionit, publikut dhe organeve më të larta shtetërore. Duhet të ndërgjegjësohemi që të kuptojnë dhe vlerësojnë realisht pozicionin dhe përgjegjësinë që kemi si punonjës të organit më të lartë të kontrollit ekonomik dhe financiar; të punojmë dhe të sigurojnë profesionalizmin e dëshiruar, gjithashtu të jemi promotorë të konsolidimit të arritjeve të institucionit dhe të përmirësimit cilësor të veprimtarisë audituese. Kjo mund të arrihet:

- duke rritur në radhë të parë kërkesën ndaj vetvetes si staf drejtues për auditime më cilësore dhe rezultative dhe duke e përçuar këtë ndjenjë kërkesë dhe përgjegjësie tek të gjithë punonjësit që drejtojmë, si dhe

- duke kryer auditime në mënyrë objektive, profesionale dhe me kompetencën e duhur.

3. Rritjen sistematike të forcës zbuluese dhe parandaluese gjatë ushtrimit të procesit auditues me cilësi dhe efektivitet sa më të mirë. Madje, kjo efektivitet duhet të vlerësohet në këndin e shfrytëzimit nga subjektet e kontrollit dhe publiku në tërësi, të zbulimeve, të konkluzioneve e të rekomandimeve.

4. Sigurimin e cilësisë së kontrollit, duke përcaktuar procedura dhe rregulla të qarta të institucionalizuara për këtë çështje dhe ndjekur zbatimin e tyre.

5. Ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, duke përdorur të gjitha format e mundshme, që nga kërkesa për zbatimin e detyrimit ligjor për kthimin e përgjigjeve brenda afatit limit 20 ditor, ngulmimin pranë subjekteve që nuk kanë respektuar këtë afat për kthimin sa më parë të përgjigjeve, informimin e organeve eprore për subjektet që nuk zbatojnë detyrimin ligjor dhe së fundi ushtrimin brenda muajve nëntor dhjetor 2012 të auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve. Shtoj se, niveli i realizimit të rekomandimeve për periudhën e 6-mujorit të dytë 2012, duhet të rezultojë shumë më i lartë se ai i realizuar deri më tani vetëm në masën 30%, për të bërë të mundur realizimin e objektivit të parashikuar si vjetor, realizimin e rekomandimeve në një përqindje më të lartë se ajo e rezultuar në vitin 2011.

6. Përmirësimin e komunikimit brenda institucionit dhe mundësia e përdorimit të përbashkët të dokumenteve dhe informacionit; gjithashtu, përmirësimi i teknologjisë së informacionit.

7. Zhvillimin profesional tonin dhe motivimin e punonjësve etj.

Së fundi, në kuadër të mënjanimit të mangësive të konstatuara deri tani, jeni të lutur që të plotësoni me seriozitet dhe me përgjegjshmëri të lartë pyetësonin që do t'ju shpërndajmë në këtë analizë, ku kemi përcaktuar një mori çështjesh dhe nënçështjet, për të cilat kërkohet mendimi Juaj si auditues profesionist.

Mendoj, se në ndër çështjet që kërkon vëmendje po cilësoj një prej tyre, konstatimi dhe evidentimi gjatë kryerjes së auditimeve të parregullsive dhe shkeljeve financiare, me impakt negativ në përdorimin e shpenzimeve dhe në administrimin e të ardhurave, madje hartimi dhe plotësimi i një evidencë të veçantë për pasqyrimin dhe raportimin e tyre.

4. Realizimi i shpenzimeve buxhetore të planifikuara për këtë 6/mujor.

Ndër drejtimet kryesore të veprimtarisë të punonjësve të Drejtorisë Ekonomike dhe timen si Nëpunës Autorizues ka qenë përdorimi efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare të

institucionit dhe menaxhimi i aktiveve të tij, për krijimin e kushteve optimale për zhvillimin normal të punës.

Më konkretisht, në koordinim me Drejtoreshën e Drejtorisë Ekonomike, si Nëpunëse Zbatuese, i kemi kushtuar kujdes të veçantë:

- ndjekjes së zbatimit të detyrave të përcaktuara për administrimin e buxhetit të miratuar, duke respektuar kërkesat ligjore financiare, si dhe duke kryer në mënyrë periodike kontrollin e shpenzimeve ditore për të gjitha llojet e shpenzimeve të kryera me bankë dhe arkë, përfshirë rastet e prokurimeve të drejtpërdrejta;
- rakordimit mujor të situacioneve të shpenzimeve të buxhetit me Degën e Thesarit dhe Ministrinë e Financave, si dhe akt-rakordimet për çeljen dhe lëvizjen e fondeve buxhetore me Drejtorinë e Buxhetit në MF;
- kryerjen saktë dhe në kohë të veprimeve lidhur me përpilimin e dokumentacionit të bankës, arkës dhe magazinës;
- kryerjen brenda rregullave të të gjitha pagesave të punonjësve si paga, dieta, paradhënie e shërbime të tjera me arkën;
- ushtrimin e kontroleve periodike në arkë;
- dërgimin rregullisht në Drejtorinë e Thesarit pranë MF të situacionit të shpenzimeve të valutës jo tregtare;
- kryerjen në kohë të veprimeve ekonomike dhe pasqyrimin e tyre në dokumentet përkatëse menjëherë pasi kryhet veprimi;
- hartimin dhe dërgimin brenda afatit të regjistrin të realizimit të prokurimeve publike për vitin 2011 dhe regjistrin të parashikimeve për vitin 2012;
- përpilimin e dokumentacionit përkatës për prokurimet publike konform listës së proceseve të punës për prokurimet me vlerë të vogël;
- përgatitjen e dokumenteve dhe zhvillimin e tenderave për blerje të ndryshme të programuara;
- ndjekjen në vazhdimësi të zbatimit të kontratave me të tretët për furnizimin me energji elektrike, uji dhe telefon etj.

Situacioni i zbatimit të buxhetit për periudhën 6/mujore kundrejt planit (sipas strukturës së shpenzimeve të miratuar) paraqitet si më poshtë:

<i>Në mijë/lekë</i>					
Artikulli	Emërtimi	Plani vjetor	Plani 6-mujor	Realizimi 6-mujor	Në %
600	Paga	182,242	91,120	88,107	97
601	Sigurime shoqërore	25,791	12,600	12,206	97
602	Shpenzime operative	46,853	23,200	17,960	77
604	Shpërblim i menjëhershëm	586	586	586	100
605	Kuotë antarësimi	200	150	125	83
606	Ndihmë fond i veçantë	188	188	188	100
231	Investime	5,000	1,900	639	34
	TOTALI:	260,860	129,744	119,811	92

Analizuar sipas zërave, rezulton se:

a) Në zërin “paga” mosrealizimi me 3 pikë përqindje, ka ardhur kryesisht si pasojë e mosrealizimit të numrit të miratuar të punonjësve, që në 3/mujorin e parë të vitit 2012. Aktualisht kemi të punësuar në KLSH 150 punonjës, nga 156 të miratuar sipas organikës të miratuar, ose 6 punonjës më pak.

b) Në zërin “shpenzime operative”, mosrealizimi i ndjeshëm ka ardhur pothuajse tërësisht nga mosrealizimi i zërit “Shpenzime udhëtimi”, i cili sipas detajimit në fillim të vitit zë 74% të shpenzimeve operative. Këto shpenzime, ndarë në shpenzime udhëtimi brenda vendit dhe jashtë vendit, plan 6/mujor dhe realizimi faktik paraqitet:

Në mijë/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani 6/mujor	Fakti 6/mujor	Përqindja realizimit	Diferenca	
					+	-
I.	Shpenzime për dieta gjithsej	17,300	11,519	67	- 5,581	
	Nga këto:					
1.	Brenda vendit	11,550	7,720	67	- 3,830	
2.	Jashtë vendit	5,750	3,799	66	- 1,951	

Mosrealizimi në këtë zë të shpenzimeve është i madh, madje dhe po të përfshijmë në këtë nivel realizimi shpenzimet për dieta brenda vendit të dërguara ditët e para të muajit korrik për likuidim në Degën e Thesarit Tiranë në shumën 1,632,750 lekë dhe shpenzimet faktike për dieta jashtë vendit (shërbimi në Poloni) në shumën 1,023,218 lekë, *gjithsej 2,655,968 lekë*.

Në mosrealizimin e vleftës së shpenzimeve të programuara për dieta brenda vendit, mendoj se kanë ndikuar:

1. Mospërputhja e nivelit të shpenzimeve për dieta brenda vendit me subjektet që përfitojnë dietë të propozuara nga Departamentet e Auditimit dhe të përcaktuara në programin e veprimtarisë audituese për vitin 2012.
2. Shkurtimi i ditëve (afatit kohor) për ushtrimin e auditimit në terren në zonat, qytetet dhe komunat që përfitojnë dietë (për shpenzime transporti, ushqim dhe fjetje), mbi 100 km larg nga qyteti i Tiranës.
3. Ushtrimi gjatë këtij 6/mujori të auditimeve në zonat, qytetet dhe komunat nën 100 km, ku punonjësit e KLSH nuk përfitojnë dieta.

c) Në zërin “investime”, ndonëse si 6/mujor realizimi është në masën 34%, situata është krejt ndryshe. Aktualisht në këtë zë kemi kryer procedurat e prokurimit, kemi kontraktuar dhe jemi në procesin e pagesës së disa investimeve si:

1. Kontrata për blerjen e pajisjeve kompjuterike me vlerë 2,266,800 lekë.
2. Kontrata për programin e dispozitave ligjore dhe apdetimin mujor të tyre me vlerë 397,000 lekë, tashmë e realizuar.
3. Faqja e re në internet e KLSH me vlerë 300,000 lek, tashmë e realizuar.
4. Programi i personelit me vlerë 450,000 lekë, në proces realizimi.

Pra, *gjithsej 3,413,800 lekë*. Po t'i shtojmë kësaj vlere, shumën prej 639,000 lekë të shpenzuar sipas situacionit 6/mujor, shuma në total e shpenzuar dhe e kontraktuar në zërin “investime” rezulton **4,052,800 lekë**, nga 5,000,000 lekë plani vjetor, ose në masën 81%.

Nisur nga të metat dhe mangësitë e deritanishme të rezultuara si pasojë e kërkesës dhe detajimit të fondeve në zëra dhe nënzëra për vitin 2012, si mosbërja e kërkesave nga departamentet dhe drejtoritë dhe planifikimi në nivele të ulëta të shpenzimeve për kontraktimin e ekspertëve të jashtëm, për trajnimin dhe kualifikimin e punonjësve, për botimet e ndryshme përfshirë revistën e KLSH, shpenzimet për pritje e përcjellje, për vizita të ndërsjellta me institucionet homologe të huaja, për organizim të seminareve apo konferencave, për investimet sidomos në fushën e teknologjisë së informacionit etj.;

Siç jeni në dijeni, për mënjanimin e tyre në vitin e ardhshëm buxhetor, kemi përgatitur dhe ju kemi shpërndarë formularin për hartimin e kërkesave për vitin 2013 për çdo zë dhe nënzë të shpenzimeve, i cili duhet të dorëzohet brenda datës 30 korrik 2012, pasi afati i fundit i paraqitjes

së projektbuxhetit të vitit 2013 në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe MF është data 31 gusht 2012.

Kjo periudhë përkon me dhënien e lejeve vjetore, ndërkohë që kemi përpara disa punë mjaft të rëndësishme, si: hartimi dhe dërgimi brenda datës 15 shtator në Kuvend i raportit për zbatimin e buxhetit të vitit 2011; hartimi dhe dërgimi në Ministrinë e Financave të kërkesave buxhetore për vitin 2013. Për punonjësit e ngarkuar me kryerjen e këtyre detyrave, nuk ka ulje të ngarkesës në punë, përkundrazi kërkohet përqendrim dhe përgjegjshmëri, ndaj gjithsecili prej Jush, duhet të bëjë mirë llogaritë.

RAPORT

MBI

VEPRIMTARINË DHE PERFORMANCËN 6 MUJORE TË vitit 2012

Zj. Helga Vukaj
Drejtores e Përgjithshme

Me rastin e përfundimit të veprimtarisë 6 mujore të vitit 2012, bazuar në programin vjetor të kontrollit, dhe duke vlerësuar edhe veprimtarinë për përmbushjen e objektivave të parashikuara në programin e 100 ditëve, mbi bazën e informacioneve të depozituara, raportoju mbi ecurinë e Departamenteve dhe të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun, si më poshtë:

- ❖ *Departamenti i Investimeve të Huaja dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit*
- ❖ *Departamenti i Auditimit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Shtetërore*

- ❖ *Për Departamentin e Auditimit të Investimeve të Huaja dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit*

I. Në programin vjetor të auditimit të parashikuar për vitin 2012, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, për këtë departament janë planifikuar **16 auditime**, nga të cilat janë evaduar **14** auditime, **7** prej tyre të trashëguara nga viti 2011. Në proces evadimi janë **4 auditime** si dhe vazhdon auditimi në **5 subjekte**.

II. Gjatë kësaj periudhe 6 mujore ky departament ka marrë pjesë dhe ushtruar edhe veprimtari të tjera, si trajtimi i ankesave të ndryshme adresuar KLSH, mbrojtja e padive civile kur KLSH është thirrur në cilësinë e palës, etj. Gjithashtu audituesit kanë marrë pjesë në trajnime me tematika të ndryshme.

I. Përsa i përket auditimeve të kryera specifikisht për këtë departament raportohet:

Auditimet e evaduara i përkasin:

- **4** (katër) në fushën e projekteve;
- **5** (pesë) në shoqëritë publike;
- **3** (tre) në fushën mjedisore;
- **1** (një) performancë mjedisore;
- **1** (një) çertifikim i llogarive

Auditimet e evaduara sipas llojit të kontrollit të ushtruar:

- **4** (katër) të llojit të kombinuar,
- **8** (tetë) ligjshmërie dhe rregullshmërie;
- **1** (një) performancë mjedisore si dhe një çertifikim i llogarive.

Për **14 auditimet** e evaduara nga ky departament është raportuar se janë zbuluar dhe rekomanduar **427 masa** të llojeve e natyrave të ndryshme, ku të gjitha kanë pasur si qëllim ndikimin pozitivisht në përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituar, konkretisht :

1. Ky departament raporton se masa e dëmit ekonomik/efektit negativ financiar të zbuluar shkon në vlerën **2,695,042** mijë lekë;

2. Ka rekomanduar **masa për shpërblim dëmi në 12 subjekte;**
3. Ka rekomanduar **247 masa organizative;**
4. Ka rekomanduar **172 masa disiplinore dhe administrative;**
5. **Ka propozuar 4 Kallëzime penale;**
6. Ka rekomanduar **përmirësime ligjore në 6 subjekte.**

Ndërsa po t'i referohemi realizimit të rekomandimeve, pas bilancit të kryer nga vet departamenti rezulton se:

Brenda afatit 20 ditor të përcaktuar në dokumentet standarde të KLSH, për realizimin e rekomandimeve janë përgjigjur **9 subjekte**, ndërkohë që 5 subjekte si, *Ujësjetës-kanalizime, Fier dhe Projekti “Ndërtimi i banesave sociale”*, të cilët janë subjekte të evaduara në tremujorin e parë nuk kanë kthyer ende përgjigje për rekomandimet. Ndërsa për tre subjekte të cilat janë evaduar në muajin Qershor 2012, nuk është plotësuar ende afati kohor 20 ditor dhe për to mbetemi në pritje të përmbushjes.

Pavarësisht këtij raportimi për pjesën e rekomandimeve të porealizuara (përsa kohë informacioni nga subjektet mungon atëherë pasivitetin e institucioneve subjekt auditimi nuk mund ta konsiderojmë pozitiv) ndaj mbetet si detyrë fokusimi më tej në këtë problem subjektet që nuk kanë kthyer përgjigje, duke u angazhuar qoftë në kuadrin shkresor dhe atë verifikues në subjekt. Madje ky “ngërç” administrativ duhet të diskutohet edhe me Drejtorinë Juridike.

Megjithatë mbështetur në ato kthim përgjigje, të ardhura në kohë nga subjektet rezultojnë realizimet si më poshtë:

Në **9 subjekte** është raportuar se janë rekomanduar dhe realizuar:

- **Masa organizative**, nga **135** janë në proces për realizim **122 prej tyre**, ose **90%** e tyre;
- **Masa disiplinore** nga **113**, janë realizuar **71**, ose **63%**;
- **Dëmi ekonomik/efekt negative financiar** me vlerë **2,695,042** mijë/lekë, për të cilin sipas përgjigjeve të ardhura, subjektet kanë filluar procedurat për ndalimin e vlerës së dëmit.

Krahasuar me treguesit e të njëjtës periudhë të vitit të kaluar departamenti në fjalë ka disa elementë pozitiv në treguesit e veprimtarisë së tij.

Së pari, në drejtim të zbulimit të rasteve që përmbajnë elementë të veprës penale të shpërdorimit të detyrës, për këtë 6 muajor janë konstatuar **4 (katër) raste** me efekte negative financiare kur në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar raportohet vetëm **1 (një) rast**, pra **(+3) raste më shumë**. Katër rastet e depozituara në organin e ndjekjes së akuzës për konsumimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, kanë shënuar efekte financiare, dëm ekonomik në **vlerën 296,106 mijë lekë**.

- **Porti Detar Vlore, një kallëzim penal, 1 person**, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, neni 248 i kodit penal, dëmi i shkaktuar 187,931 mijë lekë;
- **Operatori i Sistemit të Transmetimit, një kallëzim penal, 1 person**, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, neni 248 i kodit penal, dëmi i shkaktuar 45,490 mijë lekë
- **Autoriteti i aviacionit Civil, dy kallëzime penale:**
- **1 person**, për shpërdorim detyre dhe shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera, apo ankande publike, neni 248 dhe 258 i kodit penal, dëmi i shkaktuar 62,685 mijë lekë;
- **1 person**, për shpërdorim detyre dhe ndërhyrje në transmetimet kompjuterike, neni 248 dhe 192/b të kodit penal, për të cilët vazhdon procedimi penal.

Së dyti, në drejtim të zbulimit të shkeljeve administrative për të cilat është rekomanduar marrja e masave disiplinore administrative, për 6 mujorin e këtij viti janë rekomanduar **172 masa disiplinore**, nga të cilat **60** në kompetencë të Agjencisë së Prokurimit Publik, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar janë rekomanduar **72 masa disiplinore**, pra **(+100) masa administrative më shumë**.

Nga 172 masat, 60 propozime janë bërë për Agjencinë e Prokurimit Publik, përkatësisht 14 në subjektin Ujësjellës Kanalizime Fier dhe 10 në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave, 23 në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare, 13 në Autoritetin e Aviacionit Civil. Masat e tjera janë të karakterit disiplinor si “Largim nga puna” 8 raste, “Largim nga detyra” kemi propozuar tetë raste, “Kalim në një nivel më të ulët” tre raste, “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”, janë propozuar 33 raste, “Vërejtje me shkrim” 50 raste si dhe dënimin me gjobë 50 mijë lekë është dhënë ndaj gjashtë firmave të ndërtimit të cilat operojnë në investime publike si në ndërtim të banesave sociale për komunitetin në nevojë, pa përkrahje dhe të ardhura të pakta, si dhe ndaj katër personave specialist në ndërtimin e projektit “Ndërtimi i banesave sociale” .

Së treti, në drejtim të zbulimit të parregullsive procedimore për shkak të pamjaftueshmërisë ligjore, për 6 mujorin e këtij viti janë rekomanduar **6 (gjashtë) raste për përmirësim ligjor**, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2011, janë rekomanduar **5 raste, pra (+1) rast më shumë**. *Gjashtë masat për përmirësim ligjor, janë përkatësisht për subjektet, Drejtoria e Shërbimit Pyjor Durrës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare dhe Autoriteti i Aviacionit Civil.*

Së katërti, në drejtim të zbulimit dhe evidentimit të pamjaftueshmërisë apo të metave e mangësive organizative, për këtë 6 mujor janë rekomanduar **247 masa me karakter organizativ**, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2011 janë rekomanduar **215**. Pra rezultojnë të jenë rekomanduar **(+15) masa organizative më shumë**.

247 masat me karakter organizativ janë rekomanduar për: Autoritetin e Aviacionit Civil 33 masa, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare 31 masa, Ujësjellës Kanalizime Tiranë 30 masa, Drejtoria e Shërbimit Pyjor Durrës me 18 masa organizative, MMPAU me 14 masa, Certifikimi i Llogarive i kryer në projektin “Menaxhimi integruar i ujërave” 4 masa organizative, Ujësjellës Kanalizime Fier 17 masa, Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave 20 masa etj.

II. Veprimtari të tjera

• Përgjigjet e ankesave

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 në këtë Departament janë trajtuar me **kthim përgjigje 13** ankesa, në të cilat vend të veçantë zënë ankesat për auditim në subjekte sh.a. **si ujësjellës, Albpetrol, Qendra e trajtimit të studentëve nr.1, dhe nr.2 etj.**

- a. Ankesa për administrim financiar dhe prokurime 6, të cilat janë verifikuar, dhe rezultoi 1 (një) e drejtë dhe në 5 (pesë) subjekte vazhdon verifikimi;
- b. Ankesa për privatizim dhe administrim prone 1 (një), e cila është konstatuar të jetë jashtë kompetencave të KLSH;
- c. Të tjera 6, nga të cilat kanë rezultuar: 1 (një) e drejtë, vazhdon verifikimi për një ankesë dhe ardhur jashtë kompetencave institucionale 4 (nga të cilat dy anonime pa adresë).

Gjatë veprimtarisë 6 mujore kontrollorët e këtij departamenti për rritjen e performancës së tyre në disa drejtime janë angazhuar dhe marrë pjesë edhe në trajnime me tematika të ndryshme, si më poshtë:

- **Kualifikimet dhe Trajnimet nga:**

- *Instituti Trajnimit të Administratës Publike*, në temat:
- *Trajnime të kryera nga specialistë të KLSH*
- *Trajnime të zhvilluara mbi performancën në Slloveni dhe Poloni*

- **Pjesë e veprimtarisë 6 mujore, në kuadër të mbrojtjes së çdo zbulimi e rekomandimi të dhënë, ka qënë edhe pjesëmarrja dhe ndjekja e proceseve gjyqësore, ku ky departament ka marrë pjesë në:**

- **6 (gjashtë) procese gjyqësore**, nga të cilat 3 (tre) kanë përfunduar, 2 (dy) janë në proces dhe 1 (një) është mbyllur, konkretisht:

procesi: Shoqëria italiane “Ingenieria&Servizi” S.r.l.,

*Në kontrollin e ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë, në projektin “Ndërtimi dhe rehabilitimi i pesë poliklinikave”, viti 2009, Ministria e Shëndetësisë ka hapur çështje civile në ngarkim të palëve përfituese, shoqëria italiane “Ingenieria&Servizi” S.r.l., në të cilën kërkohet shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **4 531 euro** e përfituar padrejtësisht për mos derdhjen e tatimit mbi të ardhurat e përfituara në Shqipëri. Në seancën gjyqësore u komunikua pushimi i çështjes, pasi pala paditëse Ministria e Shëndetësisë nuk mori pjesë.*

procesi civil me paditës, Skënder Shkoza dhe me palë të paditur KLSH, me objekt padie “Shfuqizim Vendimi”, sqarojmë se: *Në bazë të nenit 154 të K.Pr.C. u mor vendimi për “Kthim Aktesh” për faktin se, avokati mbrojtës i palës paditëse nuk paraqiti prova shkrësore për të argumentuar padinë.*

procesi civil me Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare; Objekti: Detyrim për pagimin e shumës 2,000,000 lekë, të përcaktuar si dëm ekonomik në rekomandimet e lënë nga KLSH, në kontrollin e ushtruar në KESH, sha .

Palë e paditur Shoqata “Olimpiku Special, Shqiptar”

Pas zhvillimit të gjashtë seancave gjyqësore, trupi gjykues vendosi: Në mbështetje të nenit 6, të kontratës së lidhur midis palëve, i padituri të paguajë shumën 2,000,000 lekë në favor të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, nga të cilat 1,000,000 lekë, të sponsorizuara nga KESH, SHA dhe 1,000,000 lekë, kamat vonesa.

- **Janë në vazhdim proceset gjyqësore për çështjet civile:**

“ESI Energia & Servizi Italia”. *Ministria e Shëndetësisë ka hapur çështje civile në ngarkim të palës përfituese firma “ESI Energia & Servizi Italia” s.p.a, për dëmin ekonomik me vlerë 14 094 euro, të përfituar padrejtësisht nga pala e paditur.*

Helvetika Profarma. *Në kontrollin e ushtruar në Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, në vitin 2008, është rekomanduar t'i kërkohet në rrugë ligjore operatorit ekonomik “Helvetika Profarma” Tiranë, arkëtimin e dëmit në vlerën 8.831.822 lekë, pasi furnizuesi nuk ka zbatuar detyrimet kontraktuale dhe për të cilën duhet të paguaj dëmet për lëvrim të vonuar të mallrave të llogaritura me tarifën 4/1000 e çmimit total të kontratës të përcaktuar në nenin 3 pika 8 e kontratës, dhe për mosrealizim të kontratës, sigurimin e saj në masën 10% të vlerës, sipas Kushteve të përgjithshme të Kontratës (Mallra), nenet 24 “Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar” dhe 32 “Sigurimi i Kontratës”, pika 32.2.*

Cështje e mbyllur: Paditës: Ministria e Shëndetësisë, të paditur: Shoqëria “DECs.p.a.” kthim shume të përfitim në mënyrë të padrejtë 25,280 euro.KLSH në këtë gjyq nuk ka marrë njoftim për t’u përfaqësuar si palë e tretë. Në apel nuk mund ta hapim ne çështjen, pasi nuk jemi palë e paditur dhe as paditës.

Nisur nga sa më sipër u raportua, rezulton se Departamenti i Kontrollit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit, përgjithësisht ka rritje në vëllimin e veprimtarisë kontrolluese. Ky departament ka bërë përpjekje të gjithanshme për të rritur cilësinë shkresore dhe aftësinë zbuluese, në rritjen e numrit të rekomandimeve në drejtim të përmirësimit të punës për të ardhmen, këto arritje do të shërbejnë si bazë për rritjen e cilësisë së mëtejshme në veprimtarinë kontrolluese për vitin 2012. Megjithatë në vazhdim të përmbushjes së veprimtarisë vjetore nga ky departament kërkohet të fokusohet më shumë si në analizimin paraprak të riskut ashtu edhe në zbulimet specifike në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, konkretisht në administrimin e pyjeve si zë kadastror dhe fizik si edhe në fushën e menaxhimit të ujërave.

Ndaj edhe njëherë e theksoj se pavarësisht arritjeve dhe përshkrime specifike për performancën në tërësi, shifrat nuk duhet të na përcjellin vetëkënaqësi, pasi vihet re se ka ende nevojë për përmirësime të mëtejshme, si në trajtimin e problemeve ashtu edhe në trajtimin dhe interpretimin e fakteve e të dhënave. Pra ka nevojë të mbushet pamjaftueshmëria në terminologji dhe në përshkrimin analizues të zbulimeve, gjë që ka qenë e dukshme përsa i përket tre muajve të fundit të këtij 6 mujori, në formën e riciklimeve për rivlerësim nga eprori. Në këto kushte konsideroj se çdo grup domosdoshmërisht duhet të ketë në përmbajtjen e tij një auditues të profilit jurist. Gjithashtu në kuadër të konsolidimit të produktit në kuptimin cilësor e të gjithanshëm të tij duhet të rritet vëmendja dhe përqendrimi vlerësues, ballafaques e evidentues nga ana e Drejtorisë Juridike e cila duhet të jetë jo vetëm monitoruesja por edhe këshilltarja e stabilizimit dhe gjetjes së formulës ligjore, ndoshta edhe të risive, pasi dinamizmi i përshtatshmërisë së akteve ligjore duhet të reflektojë edhe në konceptin e konsiderimit dhe trajtimit të problemeve.

Konkluzionet para dhe pasvijuese mbeten njëherësh edhe sfidat për të ardhmen e afërt për Departamentin e Kontrollit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit:

- Njohja më mirë e legjislacionit specifik dhe organik me qëllim zbatimin me korrektësi të standarteve të reja të raportimit të auditimit dhe të gjithë procesit të auditimit në përgjithësi;
- Thellimi në hulumtim me qëllim llogaritjen në detaje të riskut e përcaktimin e veprimeve konkrete për zbulimin e tij;
- Rritja e ndërgjegjësimit në përmbushje të misionit si agjent i pavarur dhe profesionist në zbulime e rakordime të përputhura masash, duke respektuar gjerësisht tolerancën zero ndaj korrupsionit;
- Rritja e sensibilitetit ndaj çdo normimi ligjor specifik, si, ligji “Për kundravajtjet administrative”, për thellimin dhe zgjerimin e masave të rekomanduara kryesisht atyre disiplinore dhe administrative, pa hequr vëmendjen nga përmirësimet ligjore, organizative dhe masat për shpërblimin e dëmit;
- Përqendrim në auditimet e performancës, në fusha sensitive për mbarë shoqërinë në përputhje me prioritetet e vendosura nga Z.Kryetar; Pikërisht në këtë kuadër është iniciuar edhe auditimi i performancës në fushën mjedisore me kotrollorë të përzgjedhur nga të dy departamentet.
- Rritja e argumentit ligjor në dhënien e çdo mase;

- Rritje vëmendje ndaj vënies në shërbim institucional nga cdo kontrollor me sa më shumë efikasitet, dhe eficiencë;
- Rritja e transparencës dhe përkushtim në hedhjen e fakteve dhe interpretimin e tyre;

Nga gjithë sa sipër përmenda nëse në filozofinë e veprimitarisë sonë nuk do të ketë ndjesi civile në drejtim të rritjes dhe lartësimit të figurës së audituesit të jashtëm nuk mund të pretendojmë të arrijmë në emëruesin e përbashkët të frymës së gjithë akteve ligjore e nënligjore që shoqërojnë veprimitarinë tonë. Emëruesi i përbashkët i tyre është ruajtja e interesit publik dhe mospranimi i patologjive penguese, një prej të cilave është pa dyshim korrupsioni!

Aneks 1

Imtësisht e konkretisht subjektet e audituara dhe audituesit, mbi bazën e raporteve të të cilëve u krye edhe kjo përmbledhje për performancën e Departamentit të Kontrollit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit, janë:

1. Kontroll ligjshmërie, rregullshmërie financiare dhe vlerësues në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për periudhën 01.05.2009-30.06.2011. Përgjegjës grupi Pullumb Beqiri, auditues Nefail Xhepexhi, Keida Muca. Auditimi ka filluar më datën **05.09.2011**, dhe ka përfunduar më **28.10.2011**, konform programit të auditimit nr. 341/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara për përmirësimin e gjendjes janë: 2 për përmirësim ligjor, masa organizative 14, masa disiplinore në numër 4, nga të cilat 2 “vërejtje me shkrim”, 2 “kalim në një nivel më të ulët”. Dërgimi i Raporti Përfundimtar të auditimit është bërë me vonesë për arsye të nderimit të titullarit drejtues të KLSH.**

2. Certifikim të llogarive vjetore në projektin “Menaxhimi i integruar dhe ekosistemit”, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës Kanalizimeve, nga fillimi i projektit deri në qershor 2011. Përgjegjës grupi Gjovalin Preçi, auditues Nikolin Gjonaj, Teuta Qatipi; Auditimi ka filluar më datën **05.09.2011**, dhe ka përfunduar më **28.10.2011**, konform programit të auditimit nr.344/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara për përmirësimin e gjendjes janë: masa organizative 4, masa zhdëmtimi në numër 1 dhe vlerë 1331 mijë lekë, masa disiplinore në numër 1, nga të cilat 1 “vërejtje me shkrim”. Dërgimi i Raporti Përfundimtar të auditimit është bërë me vonesë për arsye të nderimit të titullarit drejtues të KLSH.**

3. Kontroll ligjshmërie, rregullshmërie financiare dhe vlerësues në Projektin “Spitalin Universitar Nënë Tereza, Tiranë”, MSH, për periudhën nga fillimi i projektit deri në qershor 2011, Përgjegjës grupi Yllka Pullashi, auditues Albana Pengili, Lavdie Fshazi, Luljeta Shtylla; Auditimi ka filluar më datën 05.09.2011, dhe ka përfunduar më 28.10.2011, konform programit të auditimit nr. 342/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara për përmirësimin e gjendjes janë: masa organizative 7, masa zhdëmtimi në numër 2 dhe vlerë 9, 921 mijë lekë. Dërgimi i Raporti Përfundimtar të auditimit është bërë me vonesë për arsye të nderimit të titullarit drejtues të KLSH.**

4. Kontroll ligjshmërie, rregullshmërie financiare dhe vlerësues në projektin “Ndërtimi i banesave sociale në Shqipëri”, MPPT, për periudhën nga fillimi i projektit deri në qershor 2011. **Përgjegjës grupi** Mariola Lleshi, **auditues** Mimoza Lloji, Artan Topiama, Mimoza Bedini, Elfrida Agolli; Auditimi ka filluar më datën **05.09.2011**, dhe ka përfunduar më **28.10.2011**, konform programit të auditimit nr. 343/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara** për përmirësimin e gjendjes janë: **masa organizative 5, masa zhdëmtimi në numër 11 dhe vlerë 8554 mijë lekë, masa administrative 6 me vlerë 30000 mijë lekë, masa disiplinore në numër 13, nga të cilat 2 “vërejtje me shkrim”, 11 “vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”**. *Dërgimi i Raporti Përfundimtar të auditimit është bërë me vonesë për arsye të nderimit të titullarit drejtues të KLSH.*

5. Kontroll ligjshmërie, rregullshmërie financiare dhe vlerësues në Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhave, Durrës për periudhën **30.06.2009-31.10.2011**. **Përgjegjës** Shefki Jaupi, **auditues** Andi Buzo, Kledi Xhani; Auditimi ka filluar më datën **26.09.2011**, dhe ka përfunduar më **31.10.2011**, konform programit të auditimit nr. 393/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara** për përmirësimin e gjendjes janë: **masa organizative 20, masa zhdëmtimi në numër 3 dhe vlerë 1547 mijë lekë, masa disiplinore në numër 22, nga të cilat 4 “vërejtje me shkrim”, 8 “largim nga detyra”, 10 për kompetencë Agjencisë së Prokurimit Publik**. *Dërgimi i Raporti Përfundimtar të auditimit është bërë me vonesë për arsye të nderimit të titullarit drejtues të KLSH.*

6. Kontroll ligjshmërie, rregullshmërie financiare dhe vlerësues në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Durrës për periudhën **30.06.2009 - 31.10.2011**. **Përgjegjës grupi** auditues Elfrida Taraku, Edmond Gjini, Selman Hysi, Mirosh Bogdo, Teuta Oatipi; Auditimi ka filluar më datën **05.09.2011**, dhe ka përfunduar më **28.10.2011**, konform programit të auditimit nr. 345/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara** për përmirësimin e gjendjes janë: **2 për përmirësim ligjor, masa organizative 18, masa zhdëmtimi në numër 5 dhe vlerë 1068 mijë lekë, masa disiplinore në numër 7, nga të cilat 7 “vërejtje me shkrim”**. *Dërgimi i Raporti Përfundimtar të auditimit është bërë me vonesë për arsye të nderimit të titullarit drejtues të KLSH.*

7. Kontroll ligjshmërie, rregullshmërie financiare në Ujësjellës Kanalizime SHA, Fier, për periudhën **01.01.2009-30.06.2011**, **Përgjegjës grupi**, Gjovalin Preçi, **auditues** Mirosh Bogdo; Auditimi ka filluar më datën **01.10.2011**, dhe ka përfunduar më **15.11.2011**, konform programit të auditimit nr. 411/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara** për përmirësimin e gjendjes janë: **masa organizative 17, masa zhdëmtimi në numër 5 dhe vlerë 2018 mijë lekë, masa disiplinore në numër 17, nga të cilat 1 “vërejtje me shkrim”, 1 “vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, 1 “largim nga puna”, 14 për kompetencë Agjencisë së Prokurimit Publik**. *Dërgimi i Raporti Përfundimtar të auditimit është bërë me vonesë për arsye të nderimit të titullarit drejtues të KLSH.*

8. Kontroll ligjshmërie, rregullshmërie financiare dhe vlerësues në Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve, Tiranë për periudhën **10.10.2009** deri **31.12.2011**, **Përgjegjës grupi** Agron Maksutaj, **auditues** Mimoza Bedini, Keida Muca, Mirosh Bogdo. Auditimi ka filluar më datën **01.02.2012**, dhe ka përfunduar më **15.03.2012**, konform programit të auditimit nr. 180/1, duke ju

përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara** për përmirësimin e gjendjes janë: **masa organizative 18, masa zhdëmtimi në numër 16 dhe vlerë 2063 mijë lekë, masa disiplinore në numër 5, nga të cilat 5 “vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”**.

9. Kontroll ligjshmërie, rregullshmërie financiare dhe vlerësues në Operatorin e Sistemit të Transmetimit, për projektin “Ndërtimi i linjës 400 kv Tiranë –Podgoricë” për periudhën nga fillimi i projektit deri më datë **31.12.2011**, **Përgjegjës grupi Mariola Lleshi, auditues Albana Pengili, Elfrida Agolli**. Auditimi ka filluar më datën **01.02.2012**, dhe ka përfunduar më **23.03.2012**, konform programit të auditimit nr. 177/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara për përmirësimin e gjendjes janë: masa organizative 10, masa zhdëmtimi në numër 2 dhe vlerë 7687 mijë lekë, masa disiplinore në numër 2, nga të cilat 1 “kalim në një nivel më të ulët”,1 “largim nga puna”**.

10. Kontroll ligjshmërie, rregullshmërie financiare dhe vlerësues në Autoritetin Rrugor Shqiptar, për projektin “Ndërtimi i rrugës Shkodër Hani i Hotit”, për periudhën nga fillimi i projektit deri më datë **31.12.2011**, **Përgjegjës grupi Gjovalin Preçi, auditues Nikolin Gjonaj, Yllka Pulashi, Luljeta Shtylla**; Auditimi ka filluar më datën **01.02.2012**, dhe ka përfunduar më **23.03.2012**, konform programit të auditimit nr. 178/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara për përmirësimin e gjendjes janë masa organizative 9, masa zhdëmtimi në numër 1 dhe vlerë 30041 mijë lekë, masa administrative në numër 1, masa disiplinore në numër 2, një “vërejtje me shkrim” dhe një “largim nga puna”**.

11. Kontroll ligjshmërie, rregullshmërie në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare, Tiranë, për periudhën nga data **04.01.2011** deri më datë **31.12.2011**, **Përgjegjës grupi Shefki Jaupi, auditues Lavdie Fshazi, Selman Hysaj, Andi Buzo**; Auditimi ka filluar më datën **01.02.2012**, dhe ka përfunduar më **24.03.2012**, konform programit të auditimit nr. 173/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara për përmirësimin e gjendjes janë masa organizative 31, masa zhdëmtimi në numër 3 dhe vlerë 9019927 mijë lekë, masa disiplinore në numër 46, nga të cilat 3 “vërejtje me shkrim”, 16 “vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, 4 “largim nga puna” 23 për kompetencë Agjencisë së Prokurimit Publik**.

12. Kontroll ligjshmërie, rregullshmërie në Drejtorinë e Ujësjetës Kanalizimeve, Tiranë, për periudhën nga data **01.07.2009** deri më datë **31.12.2011**; **pergjegjes grupi, Rustem Tare, auditues Osman Alushi, Artan Topiana, Nefail Xhepexhi**; Auditimi ka filluar më datën **10.02.2012**, dhe ka përfunduar më **06.04.2012**, konform programit të auditimit nr. 176/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara për përmirësimin e gjendjes janë: masa organizative 30, masa zhdëmtimi në numër 5 dhe vlerë 4865 mijë lekë, masa administrative në numër 3 dhe vlerë 30000 mijë lekë, masa disiplinore në numër 3, nga të cilat 3 “vërejtje me shkrim”**

13. Kontroll ligjshmërie, rregullshmërie në Autoritetin e Aviacionit Civil, për periudhën 01.01.2011 deri më datë 31.03.2012, **Përgjegjës grupi Shefki Jaupi, auditues Lavdie Fshazi, Albana Pengili, Filjazi Iliazi**; Auditimi ka filluar më datën **11.04.2012**, dhe ka përfunduar më **31.05.2012**, konform programit të auditimit nr. 466/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara

në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara** për përmirësimin e gjendjes janë : **1 për përmirësim ligjor, masa organizative 33, masa zhdëmtimi në numër 3 dhe vlerë 65378 mijë lekë, masa disiplinore në numër 40, nga të cilat 26 “vërejtje me shkrim”, 1 “largim nga puna”, 13 për kompetencë Agjencisë së Prokurimit Publik.**

14. Performancë mjedisore, Bashkia Lezhë “Mjedisi urban në qytet, prirjet dhe tendenca”, për periudhën nga data 01.01.2010 deri më datë 31.12.2011, **Përgjegjës grupi** auditues *Agron Maksutaj, Keida Muça, Ermira Vojka*. Auditimi ka filluar më datën **23.04.2012**, dhe ka përfunduar më datë **18.05.2012**, konform programit të auditimit nr. 467/1, duke ju përmbajtur afateve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH. **Masat e propozuara dhe rekomanduara për përmirësimin e gjendjes janë masa organizative 31.**

❖ **Për Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Shtetërore**

I. Në programin vjetor të auditimit të parashikuar për vitin 2012, për këtë departament janë programuar **28 auditime**. Bazuar në parashikimet e këtij programi dhe shtesave të tjera në program nga ky departament raportohet të jenë realizuar **32 auditime**, dhe mbeten pa u realizuar sipas programit 6 mujor **dy** auditime (Bashkia Tiranë dhe Durrës). Gjithashtu vlen të theksohet se për gjashtë mujorin e parë Departamenti I Auditimit të Pushtetit vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Shtetërore, ka evaduar **47 auditime**, nga të cilat **25 janë auditime të kryera gjatë vitit paraardhës(2011)** por të evaduara në këtë 6 mujor të parë të vitit 2012. Sqarohet se disa prej auditimeve të realizuara kanë qenë të paplanifikuara dhe u përfshinë në auditim për shkak të treguesve të lartë të riskut si, **Komuna Karinë (Peqin), ALUIZNI Rajonal Vlorë dhe Komuna Qukës, Bashkia Librazhd dhe ndërkaq është në proces auditimi AKKP Tiranë.**

II. Gjatë kësaj periudhe 6 mujore edhe ky departament ka marrë pjesë dhe ushtruar edhe veprimtari të tjera, si trajtimi i ankesave të ndryshme adresuar KLSH, mbrojtja e padive civile ku KLSH është thirrur në cilësinë e palës së paditur apo palës së tretë. Gjithashtu audituesit kanë marrë pjesë në trajnime me tematika të ndryshme.

I. Përsa i përket auditimeve të kryera specifikisht për këtë departament raportohet:

Auditimet e evaduara i përkasin:

- **21 (njëzet e një)** në veprimtarinë e Bashkive, në fushën e prokurimeve, urbanistikë, tatime taksa, dhënie me qira, në paga, etj;
- **17 (shtatëmbëdhjetë)** në veprimtarinë e Komunave, në fushën e prokurimeve, urbanistikës, etj
- **5 (pesë)** në veprimtarinë e ALUIZNI (vendor dhe qendror);
- **3 (tre)** në veprimtarinë e ZVRPP;
- **1 (një)** në veprimtarinë e Prefekturës, Tiranë.

Auditimet e evaduara sipas llojit të kontrollit të ushtruar:

- **3(tre)** auditime financiare,
- **44(dyzetekatër)** ligjshmërie dhe rregullshmërie;

Për **47 auditimet** e evaduara në periudhën raportuese, ky departament ka raportuar se janë zbuluar dhe rekomanduar **348 masa të llojeve e natyrave të ndryshme**, përmes të cilave është synuar ndikimi pozitivisht në përmirësimin e gjendjes së subjekteve të audituar, konkretisht :

1. Sipas raportimit të departamentit është zbuluar dëm ekonomik në vlerën **278, 543** mijë lekë (kjo është shifra që rezulton sipas formularit 9/2);
2. Ka rekomanduar **masa për shpërblim dëmi në 37 subjekte;**
3. Ka rekomanduar **masa organizative 620;**
4. Ka rekomanduar **masa disiplinore dhe administrative 348, nga të cilat 242 masa disiplinore, 106 masa administrative.**
5. **Kallëzime penale për 8 subjekte të audituara dhe 29 punonjës.**
6. Rekomandime për **3 përmirësime ligjore në 2 subjekte (ALUIZNI, APP).**

Ndërsa po t'i referohemi realizimit të rekomandimeve, pas bilancit të kryer nga vet departamenti rezulton se:

Brenda afatit 20 ditor të përcaktuar në dokumentet standarde të KLSH, për realizimin e rekomandimeve janë përgjigjur **36 subjekte**, ndërkohë që 4 subjekte si, ***Komuna Milot, Farkë, Bashkia Cërrik, Rrëshen të cilët janë subjekte të evaduara në tremujorin e parë nuk kanë kthyer ende përgjigje për rekomandimet.*** Ndërsa për **7 subjekte të cilat janë evaduar në muajin Qershor 2012, nuk është plotësuar ende afati kohor 20 ditor dhe për to mbetemi në pritje të përmirësimit.**

Duke ju referuar konstatimeve të më sipërme, theksoj se ngelet për t'u fokusuar më gjerë në këtë problem për subjektet që nuk kanë kthyer përgjigje, duke u angazhuar qoftë në kuadrin shkresor dhe atë verifikues në subjekt. Ndaj lind e nevojshme që vet Departamenti në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të angazhohen në vijim për masat që duhet të marrim në drejtim të rritjes së ndërgjegjes për zbulimet tona dhe rekomandimet. Pra, del si detyrë analizimi i arsyeve institucionale dhe jointucionale që kanë çuar në mosrealizimin e rekomandimeve. Kjo analizë do të fillojë që tek balanca e masave me shkeljet e konstatuara dhe këtu del edhe si obligim vëzhgues dhe analizues edhe për Drejtorinë Juridike e të Sigurimit të Cilësisë. Gjithashtu menjëherë këto dy segmente të angazhohet në vlerësimin e akteve ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me detyrimin administrativ që mund të mbartin këto institucione si pasojë e mosrespektimit të çfarë rekomandohet nga ana e KLSH.

Megjithatë në kuadër të kësaj analize mbi veprimtarinë 6 mujore të këtij departamenti duhen përmendur konkretisht se cila është situata me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e aj në të ardhmen:

Në **47 subjekte** janë rekomanduar dhe realizuar:

- **Masa organizative**, nga **620** janë zbatuar **110** ose **17.7%** e tyre dhe **janë në proces për realizim 510 ose 82.3% e tyre;**
- **Masa disiplinore** nga **242**, janë realizuar **16**, ose **6.6 %;**
- **Dëmi ekonomik** i raportuar me vlerë **278,543** mijë/lekë, sipas përgjigjeve të ardhura, subjektet kanë filluar procedurat për ndalimin e tij në 5 subjekte vlere prej 14,059 mijë lekë, ose 5%.

Pavarësisht treguesve të vitit të kaluar ajo që është e dukshme dëshmon për pamjaftueshmëri në pritshmërinë tonë dhe kjo na nxit edhe njëherë për t'u ndalur gjerësisht në analizimin e këtij problemi duke nisur që nga cilësia dhe garancia juridike e materialeve respektive të departamentit dhe njëherësh në verifikimin në vend të ecurisë së tyre.

Krahasuar me treguesit e të njëjtës periudhë të vitit të kaluar departamenti në fjalë ka rënie në drejtim të zbatimit të rekomandimeve dhe përmirësim në treguesit e tjerë, konkretisht:

Së pari, në drejtim të zbulimit të dëmit ekonomik rezulton të jetë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar, konkretisht në vlerën **131,574 mijë/lekë** më shumë.

Viti 2011 vlera 146,969 mijë Viti 2012 vlera 278,543 mijë diferenca + 131,574 mijë

Së dyti, në drejtim të zbulimit të rasteve që përmbajnë elementë të veprës penale të shpërdorimit të detyrës, për këtë 6 mujor janë konstatuar **8 (tetë) raste me efekte financiare prej 151,751 mijë** lekë, kur për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar nuk raportohet asnjë rast.

Megjithatë edhe këtu në kuadër të konsolidimit të materialeve tona, rritjes së profesionalizmit lind e nevojshme të kryhet një analizë pasvijuese së bashku me Drejtorinë juridike se sa bindës kanë qënë argumentet tona ligjore në përpunimin e trajtimin e atyre zbulimeve në raport me vijimin e atyre kallëzimeve në organin e ndjekjes së akuzës.

- Zyra Qendrore e ALUIZNI, një kallëzim penal për 4 persona, për konsumimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i KP, dëmi ekonomik i shkaktuar 51,900 mijë lekë.
- Zyra Rajonale e ALUIZNI Durrës, dy kallëzime penale për 12 persona, për konsumimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i KP, dëmi ekonomik i shkaktuar 31,529 mijë lekë.
- Komuna Petrelë, një kallëzim penal për 3 persona, për konsumimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe shkeljes së barazisë në tendera, parashikuar nga neni 248 dhe 258 i KP, dëmi ekonomik i shkaktuar 4.485 mijë lekë.
- Bashkia Rrëshen, një kallëzim penal për 3 persona, për konsumimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe shkeljes së barazisë në tendera, parashikuar nga neni 248 dhe 258 i KP, dëmi ekonomik i shkaktuar 13.207 mijë lekë.
- Komuna Kukur, një kallëzim penal për 3 persona, për konsumimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i KP, dëmi ekonomik i shkaktuar 802 mijë lekë.
- Komuna Qukës, një kallëzim penal për 1 person, për konsumimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe shkeljes së barazisë në tendera, parashikuar nga neni 248 dhe 258 i KP, dëmi ekonomik i shkaktuar 10.270 mijë lekë.
- Bashkia Përrenjas, një kallëzim penal për 1 person, për konsumimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i KP, dëmi ekonomik i shkaktuar 4,001 mijë lekë.
- Zyra Rajonale e ALUIZNI Vlorë, një kallëzim penal për 2 persona, për konsumimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i KP, dëmi ekonomik i shkaktuar 35,558 mijë lekë.

Së treti, në drejtim të zbulimit të shkeljeve administrative për të cilat është rekomanduar marrja e masave disiplinore administrative, për 6 mujorin e këtij viti janë rekomanduar **106 masa disiplinore**, nga të cilat **55** në kompetencë të Agjencisë së Prokurimit Publik, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar janë rekomanduar **112 masa disiplinore**, pra **(-6) raste më pak, pra në rënie**.

Nga 106 masat, 55 propozime janë bërë për Agjencinë e Prokurimit Publik, 48 janë gjoba propozuar Inspektoriatit Ndërtimor, 2 propozim për heqje license mbikqyrësish drejtuar MPBT dhe 1 heqje license noteri drejtuar M.D., përkatësisht sipas institucioneve:

Në 15 Bashki duke u rekomanduar dhënia e 106 masave disiplinore:

- 27 në Bashkinë Elbasan; 16 në Bashkinë Shkodër; 13 në Bashkinë Peshkopi; 12 në Bashkinë Rrëshen; 6 në Bashkinë Berat; 6 në Bashkinë Tropojë; 5 në Bashkinë Shijak; 5 në Bashkinë

Tepelenë; 5 në Bashkinë Peqin; 3 në Bashkinë Lezhë; 2 në Bashkinë Laç; 2 në Bashkinë Rubik; 1 në Bashkinë Rrogozhinë; 1 në Bashkinë Vorë; 1 në Bashkinë Cërrik; dhe 1 në Bashkinë Përrenjas.

Në 12 Komuna duke u rekomanduar dhënia e 64 masave disiplinore:

- 12 në Komunën Bushat; 8 në Komunën Gjepalaj; 8 në Komunën Markat; 8 në Komunën Lenie; 5 në Komunën Milot; 5 në Komunën Dajç; 4 në Komunën Kuman; 4 në Komunën Xarrë; 4 në Komunën Qukës; 3 në Komunën Bradashesh; 2 në Komunën Petrelë dhe 1 në Komunën Farkë.

Në 5 ALUIZNI duke u rekomanduar dhënia e 54 masave disiplinore:

- 22 në ALUIZNI Durrës; 16 në ALUIZNI Tiranë; 8 në ALUIZNI Fier, 4 në ALUIZNI Qendror dhe 4 në ALUIZNI Vlorë.

Në 3 ZVRPP duke u rekomanduar dhënia e 18 masave disiplinore:

- 14 në ZVRPP Durrës, 2 ZVRPP Sarandë dhe 2 ZVRPP Shkodër.

Së katërti, në drejtim të zbulimit të parregullsive procedimore për shkak të pamjaftueshmërisë ligjore, për 6 mujorin e këtij viti janë rekomanduar 3 (tre) raste **për përmirësime ligjore**, po kaq janë rekomanduar edhe në të njëjtën periudhë të vitit 2011, **pra paraqitet e njëjta gjendje**. Tre masat për përmirësim ligjor, janë përkatësisht për subjektet, ALUIZNI, dhe APP.

Së pesti, në drejtim të zbulimit dhe evidentimit të pamjaftueshmërisë apo të metave e mangësive organizative, për këtë 6 mujor janë rekomanduar **620 masa me karakter organizativ**, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2011 janë rekomanduar **442**. Pra (+178) masa më shumë. Pra kemi rritje të dukshme. Më konkretisht paraqiten si vijon:

Në 22 Bashki, duke u rekomanduar dhënia e 276 masave organizative:

- 19 në Bashkinë Peshkopi; 18 në Bashkinë Përrenjas; 18 në Bashkinë Shijak; 17 në Bashkinë Laç; 17 në Bashkinë Peqin; 17 në Bashkinë Poliçan; 17 në Bashkinë Tropojë; 16 në Bashkinë Elbasan; 14 në Bashkinë Vorë; 13 në Bashkinë Rrogozhinë; 13 në Bashkinë Rrëshen; 12 në Bashkinë Rubik; 12 në Bashkinë Cërrik; 11 në Bashkinë Shkodër; 11 në Bashkinë Mamurras; 9 në Bashkinë Delvinë; 9 në Bashkinë Ura-Vajgurore; 9 në Bashkinë Maliq; 9 në Bashkinë Tepelenë; 8 në Bashkinë Lezhë dhe 7 në Bashkinë Berat.

Në 17 Komuna duke u rekomanduar dhënia e 215 masave organizative:

- 26 në Komunën Farkë; 24 në Komunën Gjepalaj; 18 në Komunën Bushat; 18 në Komunën Lenie; 16 në Komunën Milot; 15 në Komunën Petrelë; 15 në Komunën Kryevidh; 14 në Komunën Qukës; 11 në Komunën Dajç; 11 në Komunën Markat; 9 në Komunën Karinë; 9 në Komunën Xarrë; 7 në Komunën Pezë; 7 në Komunën Golem; 7 në Komunën Kuman; 5 në Komunën Bradashesh dhe 3 në Komunën Kukur.

Në 5 ALUIZNI duke u rekomanduar dhënia e 84 masave organizative:

- 27 në ALUIZNI Qendror; 19 në ALUIZNI Tiranë; 16 në ALUIZNI Durrës; 11 në ALUIZNI Fier dhe 11 në ALUIZNI Vlorë.

Në 3 ZVRPP duke u rekomanduar dhënia e 34 masave organizative:

- 18 ZVRPP Shkodër; 10 në ZVRPP Durrës dhe 6 ZVRPP Sarandë.

Në Prefekturën Tiranë janë rekomanduar dhënia e 11 masave organizative.

II. Në kuadër të përmbushjes edhe të detyrave të tjera nga ky department raportoj I veprimtari të tjera

- **Përgjigjet e ankesave**

Për gjashtëmuorin e parë të vitit 2012 në këtë Departament janë trajtuar një volum I konsiderueshëm rastesh me kthim përgjigje **148 ankesa**, në të cilat vend të veçantë **zënë ankesat për auditim në fushat e administrimit të pronës** si vijon:

- a. Ankesa për administrim financiar dhe prokurime 26, të cilat janë verifikuar, dhe rezulton 5 të drejta, 5 të padrejta, 12 janë për verifikim dhe në 4 janë vlerësuar jashtë kompetence;
- b. Ankesa për privatizim dhe administrim prone 107, dhe rezultojnë 23 të drejta, 17 të padrejta, 38 në verifikim, 28 janë konstatuar jashtë kompetencave të KLSH;
- c. Ankesa në fushën e taksave, tatimeve e doganave, janë administruar 2, të dyja kanë rezultuar të drejta;
- d. Të tjera 14, nga të cilat kanë rezultuar: 2 të padrejta, 3 për verifikim, 9 jashtë kompetencave.

• **Kualifikimet dhe Trajnimet**

Departamenti ka marrë pjesë në trajnimet e kryera nga:

- *Instituti Trajnimit të Administratës Publike,*
- *Trajnime të kryera nga specialistë të KLSH*
- *Trajnime të zhvilluara në Slloveni dhe Poloni*

• **Pjesëmarrja dhe ndjekja e proceseve gjyqësore**

Për gjashtëmuorin e parë 2012, ky departament ka marrë pjesë në **15 procese gjyqësore**, nga të cilat **11 kanë përfunduar** në shkallë të parë, **3 (tre) janë në proces** dhe **1 (një)** KLSH nuk është pranuar si palë në proces, konkretisht:

- *Procesi me palë paditëse shoqëria “BM Konstruksion”, palë e paditur Bashkia Shkodër dhe KLSH, objekti i padisë anullimi i akteve administrative të nxjerra nga Bashkia Shkodër dhe KLSH. Padia ka ardhur si shkak i rekomandimeve për shpërblim dëmi të lënë nga KLSH gjatë kontrollit të ushtruar në Bashkinë Shkodër në vitin 2011. Procesi ka përfunduar në shkallë të parë me rrëzim të kërkesë padisë së paditësit.*
- *Procesi me palë paditëse shoqëria “Ndërtim Rruga Ura”, palë e paditur Bashkia Tiranë dhe palë e tretë KLSH, objekti i padisë anullimi i akteve administrative të nxjerra nga Bashkia Tiranë. Padia ka ardhur si shkak i rekomandimeve për shpërblim dëmi të lënë nga KLSH gjatë kontrollit të ushtruar në Bashkinë Tiranë. Gjykata ka pushuar gjykimin në shkallë të parë për mos prani të paditësit në seancë gjyqësore. Ky vendim i gjykatës është ankimuar nga paditësi. Çështja është për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.*
- *Procesi me palë paditëse shoqëria “Gysi&Drini-A”, palë e paditur Bashkia Shkodër dhe KLSH, objekti i padisë anullimi i akteve administrative të nxjerra nga Bashkia Shkodër dhe KLSH. Padia ka ardhur si shkak i rekomandimeve për shpërblim dëmi të lënë nga KLSH gjatë kontrollit të ushtruar në Bashkinë Shkodër në vitin 2011. Procesi është në zhvillim.*
- *Procesi me palë paditëse shoqëria “Bazel”, palë e paditur Bashkia Kavajë dhe KLSH, objekti i padisë anullimi i akteve administrative të nxjerra nga Bashkia Kavajë dhe KLSH. Padia ka ardhur si shkak i rekomandimeve për shpërblim dëmi të lënë nga KLSH gjatë kontrollit të ushtruar në Bashkinë Kavajë. Gjykata me vendim ka vendosur nxjerrjen jashtë kompetence të kërkesë padisë së paditësit.*
- *Procesi me palë paditëse Baftjar Kafexhiu, palë e paditur Bashkia Berat, palë e tretë KLSH, objekti i padisë anullimi i akteve administrative të nxjerra nga Bashkia. Padia ka ardhur si shkak i rekomandimeve për shpërblim dëmi të lënë nga KLSH gjatë kontrollit të ushtruar në Bashkinë Berat. Procesi është në Gjykatë të Lartë, pas rekursit të ushtruar nga paditësi.*

- *Procesi me palë paditëse Rakip Karaj, palë e paditur ZVRPP Tiranë dhe KLSH, objekti i padisë anullimi i akteve administrative të nxjerra nga ZVRPP. Padia ka ardhur si shkak i rekomandimeve për vendosje kufizimi nga KLSH gjatë kontrollit të ushtruar në ZVRPP Tiranë. Procesi është në Gjykatën e Lartë.*
- *Procesi me palë paditëse Majlinda Selita, palë e paditur ZVRPP Tiranë dhe palë e tretë KLSH, objekti i padisë anullimi i akteve administrative të nxjerra nga ZVRPP. Padia ka ardhur si shkak i rekomandimeve për vendosje kufizimi nga KLSH gjatë kontrollit të ushtruar në ZVRPP Tiranë. Gjykata ka pushuar gjykimin për mos paraqitje të paditësit në seancë gjyqësore.*
- *Procesi me palë paditëse Nuri Abdiu, palë e paditur Nevzat Abdiu, ZVRPP Tiranë dhe palë e tretë KLSH, objekti i padisë pavlefshmërinë e kartelës së pasurisë së paluajtshme. Çështja është në gjykim në shkallë të parë në Gjykatën e Tiranës.*
- *Procesi me palë paditëse Skënder Shkoza, palë e paditur ZVRPP Tiranë dhe palë e tretë KLSH, objekti i padisë anullimi i akteve administrative të nxjerra nga ZVRPP dhe KLSH. Padia ka ardhur si shkak i rekomandimeve për vendosje kufizimi nga KLSH gjatë kontrollit të ushtruar në ZVRPP Tiranë. Procesi është në Gjykatë të Lartë.*
- *Procesi me palë paditëse Fatmir Meçaj, palë e paditur Bashkinë Rrogozhinë dhe KLSH, objekti i padisë pavlefshmërinë e akteve administrative të nxjerra nga kryetari i Bashkisë Rrogozhinë dhe KLSH. Padia ka ardhur si shkak i rekomandimeve për vendosje kufizimi nga KLSH gjatë kontrollit të ushtruar në Bashkinë Rrogozhinë. Procesi në zhvillim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- *Procesi me palë paditëse shoqëria "Edmond" shpk, palë e paditur ZVRPP Lezhë, objekti i padisë shpërblim dëmi nga ZVRPP për vendosje kufizimi të padrejtë. KLSH pas kërkesës së ZVRPP si palë e tretë nuk u pranua nga gjykata si palë në proces.*
- *Procesi me palë paditëse Neim Gjikaj, palë e paditur Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, palë e tretë KLSH, objekti i padisë kundërshtimi i marrëdhënies së punës mes palëve. Procesi është në gjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë.*
- *Procesi me palë paditëse Miranda Berdo, palë e paditur Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, palë e tretë KLSH, objekti i padisë kundërshtimi i marrëdhënies së punës mes palëve. Procesi është në gjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë.*
- *Procesi me palë paditëse Yllka Kreshpaj, palë e paditur Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, palë e tretë KLSH, objekti i padisë kundërshtimi i marrëdhënies së punës mes palëve. Procesi është në gjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë.*
- *Procesi me palë paditëse Mimoza Xheladini, palë e paditur Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, palë e tretë KLSH, objekti i padisë kundërshtimi i marrëdhënies së punës mes palëve. Procesi është në gjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë.*

Nisur nga treguesit e sipërpërmendur, theksoj se pavarësisht arritjeve dhe përshkrime specifike për performancës në tërësi, vihet re se edhe në këtë departament ka ende pamjaftueshmëri në terminologji dhe në përshkrimin analizues të zbulimeve, gjë që ka pasjellë riciklime për rivlerësim nga eprorët në mënyrë të panevojshme. Në këto kushte konsideroj se çdo grup domosdoshmërisht duhet të ketë në përmbajtjen e tij një auditues të profilit jurist. Gjithashtu në kuadër të konsolidimit të produktit në kuptimin cilësor e të gjithanshëm të tij duhet të rritet vëmendja dhe përqendrimi vlerësues, ballafaques e evidentues nga ana e Drejtorisë Juridike.

Megjithatë vlen të përmendet se Departamenti i Auditimit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Shtetërore, në këtë 6 muaj dhe konkretisht në tre muajt e fundit pas një dinamizmi shkresor indikues dhe përçues, ka bërë përpjekje për të rritur cilësinë në drejtim të përpunimit të akteve që shprehin vullnet

institucional; është përpjekur të rrisë numrin e rekomandimeve të dhëna subjekteve në drejtim të përmirësimit të punës për të ardhmen; të rrisë vëmendjen ndaj kuadrit ligjor që orienton llojet dhe kategorizimin e masave dhe të integrojë në aktet e tyre referencat e duhura ligjore; si dhe të përmirësojë administrimin shkresor.

Si konkluzion, Departamenti Auditimit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Shtetërore i del detyrë të:

- Njohë më mirë legjislacionit specifik dhe organik me qëllim zbatimin me korrektësi të standarteve të reja të raportimit të auditimit dhe të gjithë procesit të auditimit në përgjithësi;
- Njohë e të përditësohet gjerësisht me aktet ligjore e nënligjore në drejtim të fushës së pronësisë dhe procedurave në lidhje me të;
- Thellohet përpara llogaritjes së riskut me qëllim përcaktimin e veprimeve konkrete për zbulimin dhe evidentimin e tij duke matur aftësitë zbuluese në realitetin faktik;
- Rrisë ndërgjegjësimin në përmbushje të misionit si agjent i pavarur dhe profesionist në zbulime e rakordime të përputhura masash, duke respektuar gjerësisht tolerancën zero ndaj korrupsionit;
- Rritja e sensibilitetit ndaj cdo normimi ligjor specifik, si, ligji “Për kundravajtjet administrative”, për thellimin dhe zgjerimin e masave të rekomanduara kryesisht atyre disiplinore dhe administrative, pa hequr vëmendjen nga përmiresimet ligjore, organizative dhe masat për shpërblimin e dëmit;
- Përqendrohet në auditimet e performancës, në fusha sensitive për mbarë shoqërinë në lidhje me pronën;
- Rrisë argumentin ligjor në dhënien e cdo mase;
- Thellohet në përdorimin me efikasitet, eficiencë të background-it profesional e teknik;
- Rrisë transparencën dhe përkushtimin në hedhjen e fakteve pa i cënuar ato dhe interpretojë ato paekuivok;
- Ndërgjegjësohet për supremacinë e integritetit institucional, të njohur nga kushtetuta dhe të reflektohet në drejtim të përshtatjes së performancës individuale me këtë nivel, pra duke u prezantuar në statusin e një eksperti të certifikuar nga Kushtetuta dhe ligji dhe jo nën elementët negativ sugjestiv të figurës jointituconale.
- Gjithashtu ky Departament ashtu si edhe Departamenti i Kontrollit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit duhet të ndalen më shumë tek analizimi i faturimit konkret të masave, siç mund të ndodhë në rastet kur dëmi i evidentuar nuk ka adresim për shkak se punonjësit mund të jenë larguar nga detyra. Lind e nevojshme që në vazhdim të vlerësohet aplikimi dhe implementimi si pjesë integrale e materialeve edhe të standartit të ngarkimit të institucionit subjekt auditimi që të njoftojë DAP dhe të nxjerrë shpallje publike për detyrimin individual që mund të ketë personi ish punonjës, si në rastin kur ka ezauruar një shkelje të thjeshtë administrative e që në kushte normale ndaj tij duhet të ishte rekomanduar masë disiplinore ashtu edhe në rastin kur ai/ajo ka konsumuar një kundravajtje administrative e për këtë do të ndëshkohet me gjobë. E gjithë kjo vlen për rritjen e performancës së cdo nëpunësi dhe njëherësh për rritjen e përgjegjshmërisë në përmbushje të detyrës si edhe për filtrimin e administratës nga punonjës me precedencë negative në kryerjen e detyrës.

Dhe si përfundim mund të them me bindje se

Një sfidë e rëndësishme për një institucion auditimi është ruajtja e integritetit të audituesit. Duke qenë në kontakt me subjektet e audituara audituesit duhet të ruajnë

integritetin dhe profesionalizmin kur përballen me përfitime dhe presione nga subjektet. Duke qenë të ekspozuar ndaj orvatjeve për përfitime audituesit mund të influencohen dhe të humbin aftësinë për të dhënë raporte të sakta që pasqyrojnë pamjen e vërtetë të subjektit. Në këtë mënyrë shkatërrohet imazhi dhe besueshmëria e institucionit në një kohë kur rritja e integritetit të institucioneve është një nga kushtet për normalizimin e jetës financiare dhe investimeve.

Parimet kryesore etike që duhet të udhëheqin punën e një audituesi janë:

- Interesi publik
- Integriteti
- Objektiviteti
- Përdorimi i drejtë i informacionit dhe burimeve
9. Në sigurimin e vlefshmërisë së ofertës në **2** raste.
10. Në Sigurimin e vlefshmërisë së ofertës në **2** raste.
11. Në njoftimin e fituesit në **1** rast.
12. Në shqyrtimin administrativ dhe zgjidhjen e ankesave në **1** rast.
13. Në lidhjen e kontratave dhe marrëdhëniet me nën kontraktorët në **12** raste.
14. Në zbatimin e kontratave nga kontraktorët dhe nën kontraktorët, në përputhje me kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratave të lidhura në **17** raste.
15. Në Arkivimin e dosjeve në **6** raste.

III. Mbi zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave të paraqitura nga subjekte të ndryshme.

Gjatë këtij tremujori janë shqyrtuar **46** ankesa dhe kërkesa të ndryshme, kryesisht për administrimin financiar, në fushën e pensioneve dhe për prokurimet publike. Nga shqyrtimi i tyre rezultoi të jenë të drejta **14** ankesa, të padrejta **7** ankesa, jashtë kompetencave **10** ankesa. Për ankesat që janë jashtë kompetencave tona, ato janë adresuar për ti ndjekur dhe për të kthyer përgjigje në institucionet përkatëse. Ankesat që lidheshin me institucionet ku ne ishim për kontroll u janë adresuar grupeve të punës që kryenin kontrollin dhe për disa ankesa problemet që kanë dalë janë pasqyruar në materialet e kontrollit. Për të gjitha ankesat u është kthyer përgjigje personave apo subjekteve të interesuar. Janë në proces verifikimi edhe **15** ankesa të tjera.

ANALIZA 6-MUJORE – DEPARTAMENTI I KONTROLLIT TË TË ARDHURAVE TË BUXHETIT TË SHTETIT

RELACION MBI

GJENDJEN DHE REALIZIMIN E TË ARDHURAVE DOGANORE SI DHE TË BORXHIR DOGANOR

Z. Aleksandër Lipivani.
Drejtor Departamenti

Të ardhurat nga sistemi doganor për vitin 2011 janë realizuar në vlerën 128,489,330 mijë lekë nga 126,500,000 mijë lekë të planifikuar, ose në masën 101,6 %, me një tejkalim në vlerë prej 1,964,330 mijë lekë, krahasuar me vitin 2010, këto të ardhura janë tejkaluar në vlerë 7.263.692 mijë lekë , ose në masën 1.9 %

Realizimi i te ardhurave doganore për vitin 2011 , sipas llojit dhe peshës qe zënë ne totalin e te ardhurave, paraqitet si me poshtë:

-Të ardhurat nga TVSH-ja janë realizuar në masën 103 %, pra me një tejkalim në vlerë prej 3.039.089 mijë lekë .

-Të ardhurat nga akciza janë realizuar 97.6 % ose me një mos realizim në vlerë prej 615.260 mijë lekë .

-Taksat doganore janë realizuar në vlerë 6,849,44 lekë 87.7 %, ose me një tejkalim në vlerë prej 962.556 mijë lekë .

-Të ardhura te tjera rezultojnë në vlerë 477,466 mijë lekë.

Nr	EMËRTIMI	Fakti 2010	Viti 2011			Krahasuar me	
			PLAN	FAKT	%	Faktin 2010	Planin 2011
1.	TAKSË DOGANORE	7.225.406	7,812 ,000	6,849,444	87.7	-375,962	-962.556
2.	TVSH	84.797.948	89,886,000	92,925,089	103.	8,127,141	3039,089
3.	AKCIZE	24.829.334	25,200,000	24,584,740	97.6	-244,594	-615,260
4.	RENTA MINERARE	2.119.300	3,627,000	3,624,537	99.9	1,505,237	-2,463
5.	Të ardhura Tatimore	-	-	28,054		28,054	28,054
	TE TJERA	636350		477,466		-158,884	477,466
		1,617,299				-	
6.	TOTALI	121.225.63	126,525,00	128.489.33	101.6	7.263.69	1.964.330

Realizimi i të ardhurave doganore , sipas strukturës , paraqitet:

Të ardhurat nga TVSH-ja.

Të ardhurat nga TVSH-ja për vitin 2011, në sektorin doganor, janë realizuar në masën 103%, ose nga 89.886.000 mijë lekë të programuara, realizuar në 92,925,089 mijë lekë me një tejkalim 3039,089 mijë lekë. Krahasuar me realizimin faktik të vitit 2010 në vlerë prej 84,797,948 mijë lekë , rezulton një rritje në vlerën prej 8.127.141 mijë lekë ose në masën 9.59 %.

Të ardhurat nga TVSH-ja në sektorin doganor përbejnë burimin kryesor të të ardhurave, të cilat në realizimin faktik të vitit 2011 , zënë 72.33 %, (92,925,089 mijë lekë : 128,489.330 mijë

lekë), ndërkohë që në realizimin faktik të vitit 2010 kjo) nga përqindje ka qenë **70 %** (84.797.948 : 121.225.630 mijë lekë). Pra për vitin 2011 kemi një rritje prej **2.37 %**, ku krahas punës së bërë nga strukturat doganore në realizimin e të ardhurave nga TVSH, ka influencuar rritja e sasisë së mallrave të maskuara në import dhe luhatje çmimoreve të mallrave në bursë si dhe ndryshimi i strukturës së mallrave.

Të ardhurat nga akciza.

Të ardhurat nga akciza në vitin 2011 janë realizuar në masën rreth **97.56 %**, nga **25.200.000** mijë lekë të programuara janë realizuar **24,584,740** mijë lekë, me një mosrealizim prej **615.260** mijë lekë ose rreth **2.44 %** më pak. Krahasuar me realizimin faktik të vitit 2010 në vlerë prej **24,829,334** mijë lekë kemi një ulje në vlerë prej **244,594** mijë lekë më pak, ose **0,98 %**.

Për vitin 2011, referuar të dhënave të siguruara gjatë auditimit të kryer në DPD, konstatohet se janë zhdoganuar **457.250 ton** Karburante, **3250 ton** cigare dhe **6546 ton** kafe. Në krahasim me vitin 2010 janë zhdoganuar : **27.142 ton** ose **5.6 %** më pak karburante, **1250 ton** ose **27.78 %** më pak dhe cigare. **211 ton**, ose **3.33 %** më shumë kafe dhe **2498 ton** ose **7.36 %** më pak birrë. Sikurse shihet në këtë tregues pavarësisht punës së bërë mendojmë se nuk është arritur niveli i kërkuar. Nga auditimet e kryera dhe konstatimet e ndryshme nga KLSH rezulton se organet kompetente kërkohet rritje të efektivitetit të kontrolleve, kryerje të tyre në mënyrë sistematike për të mundësuar moslejimin dhe parandalimin e tregtimit të mallrave të akcizës pa pullën fiskale. E rëndësishme është gjetja e mekanizmave efikas dhe ligjor për sigurimin e vënies nën kontroll të lëndëve të para që shërbejnë për prodhimin e mallrave të akcizës që në momentin e importimit (alkoolit, elbit të maltuar etj), ku rëndësi të veçantë merr informacioni. Po kështu, duhen bërë përpjekje për rregullime të ndryshme në lidhje me nivelin e akcizës për kafën e pjekur dhe atë të papjekur. Deri tani ekzistojnë dy nivele akcize, për kafën e pjekur **140 lekë kg** dhe për kafën e papjekur **30 lekë kg**. Me rëndësi është rritja e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të vetë DPD dhe ndërmjet tyre e strukturave të tjera shtetërore me qëllim të parandalimit dhe konstatimit e ndëshkimit ligjor të veprimtarive të palicencuara në prodhimin dhe tregtimin e mallrave të akcizës, për të mundësuar sado pak shmangien e evazionit fiskal dhe rritjen e të ardhurave nga akciza. Me ndryshimin e organizimit të mbledhjes, ndjekjes së akcizës duke u transferuar totalisht në sektorin doganor e shoqëruar me rritjen e ndjenjës së përgjegjësisë së administratës doganore, krijohen premisa për rritjen e të ardhurave nga akciza për të ardhmen.

Taksa doganore

Të ardhurave nga taksat doganore gjatë vitit 2011 janë në masën **87.7 %**, nga **7.812.000** mijë lekë të programuara janë realizuar **6,849,444** mijë lekë me një mosrealizim në vlerë për **962.556** mijë lekë. Krahasuar me nivelin e të ardhurave të realizuara në vitin 2010, ato rezultojnë me ulje përkatësisht në vlerën **375,962** mijë lekë ose **5.21%** (Realizimi i vitit 2010 ka qenë prej **7,225,406** mijë lekë). Theksojmë se niveli i realizimit të të ardhurave nga ky zë, do të ishte më lartë, në se do të ishte mundësuar minimizimi i ndikimit negativ në realizimin e të ardhurave, të disa faktorëve si : rënia e nivelit mesatar të taksës doganore i cili për vitin 2011, ka rezultuar në masën **1.52 %** nga **1,80 %** i realizuar në vitin 2010; ndryshimi i strukturës së importeve, rritja e vëllimit të importeve të pataksueshme, luhatjet e kursit të këmbimit etj. Faktorët e mësipërm, kanë influencuar negativisht në mos realizimin e të ardhurave në këtë zë, por ato nuk argumentojnë plotësisht mosrealizimin, pasi këto ndikime të faktorëve të mësipërm kanë qenë të pranishme pothuajse për çdo vit e për rrjedhojë në momentin e hartimit të projekt programit të të ardhurave doganore, kërkohet të mbahen parasysh nga organi kompetent doganor.

Që të ardhurat doganore në total dhe sipas zërave të programohen saktë kërkohet që të analizohen me përgjegjësi të gjithë ndikimet e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, që detyrat e parashikuara për çdo zë e degë të jenë të harmonizuara dhe sa më afër realitetit.

Trajtimi i Borxhi Doganor për vitin 2011

Nga auditimet e ushtruara dhe të dhënat e DPD-së, konstatohet se me gjithë punën e bërë gjatë vitit 2011 për arkëtimin e borxhi doganor, përsëri në fund të vitit 2011 borxhi rezultoi me probleme sidomos në drejtim të detyrimeve të papaguara të lindura si rrjedhojë e vendimeve të nxjerra në vitin 2011 por që iu takojnë veprimtarisë së kryer nga subjekte të ndryshme kohë më parë. Sipas të dhënave të DPD-së, gjendja në vlerë e këtij borxhi, nga **12,297,745,185 lekë** më 1.1.2011, ka arritur në **2,959,229,950 lekë** më 31.12.2011, me një ulje prej **9,338,515,235 lekë** ose në masën 75.9% më pak.

Kundrejt të ardhurave doganore të realizuara në vitin 2011, vlera e borxhit doganor zë rreth **2.3%** të tij, nga rreth **10.3%** që zinte një vit më parë.

Referuar gjendjes në total të debitorëve më 31.12.2011 në numër subjektesh rezultoi se në fund të vitit 2011, paraqiten me detyrime doganore të papaguara **1175** subjekte, nga **2 516** subjekte që rezultuonin më 01.01.2011, me një ulje prej **1341** subjekte, ose në masën 53.2% më pak.

Sipas degëve doganore, më keq paraqitet gjendja në 7 prej tyre, ku borxhi doganor në vlerë rezultoi **2,558,465 mijë lekë ose në masën 86,4 %** të totalit të borxhit doganor. Konkretisht, në degët doganore; **Tiranë** me një borxh doganor në vlerë prej 1,004,432 mijë lekë ose në masën 33.9% të totalit të borxhit doganor; **Durrës** me 665,094 mijë lekë ose 22.47% , **Vlorë** me 301,763 mijë lekë ose 10.2% të totalit, **Berat** me 175,356 lekë ose 5.92% **Korçë** me 149,435 mijë lekë ose 5 %; **Shkodër** me 140,885 mijë lekë ose 4.76% dhe **Fier** me 121,606 mijë lekë ose në masën 4.1 % të totalit të borxhit doganor.

Raporti ndërmjet borxhit të pakësuar me atë të shtuar përfshirë ndikimin e zbatimit të ligjit 10418, datë 21.04.2011, është në favor të pakësimeve, por duke abstragur këtë ndikim arrijmë në konkluzionin se paksimet janë 5 herë më pak se sa shtesat e krijuara gjatë vitit 2011.(13,310 milion lekë -12,512 milion = 798 milion lekë paksime pjesëtuar me 3,971milion lekë shtesa).

Në auditimet e ushtruara nga KLSH në DPD, apo Degët Doganore, dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Antikontrabandës dhe të Rikuperimit me Forcë të Borxhit rezultoi se **rënia e nivelit të borxhit doganor** është kryesisht rrjedhojë e **ndikimit të zbatimit të Ligjit nr.10418, dat 21.04.2011** "Për legalizimin e kapitalit dhe legalizimin e një pjesë të borxhit tatimor dhe doganor". Në fund të vitit 2011, pavarësisht faktorëve që kanë ndikuar në gjendjen aktuale të borxhit doganor, ky tregues rezultoi me ulje (paksim) si në numër rasatesh dhe në vlerë. Këtë ndikim e konstatohet pothuajse në të gjithë degët, ku veçojmë 6(gjashtë) degë doganore, ku pakësimi i borxhit doganor është në vlerën 9.910.674.396 lekë ,ose 84.7 % e pakësimit total të borxhit, konkretisht: Dega e Doganës Vlorë me një ulje në vlerë 2,219,370,823 lekë (borxh i krijuar 170,484,178 lekë – borxhi pakësuar 2,389855,001) ose 23.77 % të uljes totale të borxhit, D.D Durrës me ulje në vlerë 2,029,265,128 lekë (borxh i shtuar 1,161,561,378 lekë – borxhi i pakësuar 3,190,826,506 lekë) soe 21.73% të uljes totale të shumës së borxhit, D.D.Kakavi, me një ulje të borxhit në vlerën 965,000,030 lekë ,(borxhi i shtuar 106,199,047 lekë – borxhi pakësuar 1,071,199,077) ose 10.34 % të uljes totale të shumës së borxhit, D.D Tiranë me një ulje të borxhit në vlerën 956,092,231 lekë ,(borxhi i shtuar 1,900,960,033 lekë – borxhi pakësuar 2,857,052,264) ose 10.2 4 % të uljes totale të shumës së borxhit, D.Doganore Pogradec me një ulje të borxhit në vlerën 722,231,456 lekë ,(borxhi i shtuar 40,816,910 lekë – borxhi pakësuar 763,117,355) ose 8.27 % të uljes totale të shumës së borxhit.

Parë në këndvështrimin e shtesave dhe paksimeve të numrit të subjekteve dhe vlerës së borxhit për gjatë vitit, konstatojmë se në vitin 2011, borxhi doganor është shtuar për 2,289 debitorë me 2,784 raste në vlerë 3,971,854 mijë lekë, ndërkohë që është paksuar për 3,630 debitorë me 4,534 raste, në vlerën 13,310,369 mijë lekë pra me një diferencë pak në vlerën prej 9,338,515 mijë lekë. Raporti ndërmjet borxhit të pakësuar me atë të shtuar, rezulton në masën 2.35 herë tepër (9338/3971 milionë lekë). Në pamje të parë duket sikur është punuar mirë por, nga analiza e mëtejshme e faktorëve që kanë ndikuar në gjendjen e borxhit doganor si më sipër, duke e xhveshur nga influenca e zbatimit të ligjit nr.10418, datë 21.04.2011, konkludojmë se ende mbetet shumë për t'u bërë në drejtim të mbledhjes, dhe rikuperimit me force të borxhit nga strukturat përkatëse e të DPD-së dhe degë doganore . Parë në këndvështrim, e shtesës së vlerës së debitorëve, (pa e lidhur me paksimet), në DPD për vitin 2011, konstatohet se janë shtuar 277 debitorë me krahasuar me gjedjen në fillim të vitit dhe në vlerë 1,901 milion lekë ose 96.7%. Në këtë situatë rezultojnë edhe Degët Doganore Fier me 64,7%. Berat 64.7%, Durrës 43.1% etj. Pra, referuar të dhënave në lidhje me shtesën dhe paksimin e debitorëve në numër subjektsh dhe vlerë konkludojmë se krijimi i borxheve të reja dhe shtesa e numrit të subjekteve me detyrime doganore të papaguara gjatë vitit 2011, është prezent pothuajse në të gjitha degët doganore.

Në strukturë, gjendja e borxhit doganor më datë 31.12.2011 përbëhet nga detyrimet doganore të papaguara në vlerën 1,706 milionë lekë, ose në masën 57.7% gjordat për shkeljet e konstatuara 1,082 milionë lekë ose 36,6% dhe 171.4 milion lekë kamatëvonesat e llogaritura për pagesa të vonuara ose 5,77% . Bazuar në këto të dhëna konkludojmë se në vitin 2011, gjordat dhe kamatëvonesat e aplikuara nga autoriteti doganor zënë rreth 42.3% të totalit të borxhit doganor, nga 68.2% që zinin një vit më parë .

Duke e analizuar gjendjen e borxhit doganor sipas periudhës së kontabilizimit të vendimeve administrative konstatojmë se 5.08% e tij i takon periudhës deri më 31.12.1999, nga e cila është miratuar nga komisionet e monitorimit për t'u falur në tremujorin e parë të vitit 2012. Gjithashtu vlera prej 62.864 mijë lekë që lidhet me detyrimin e papaguar të një subjekti në juridiksion të D:D.Tiranë është shuar në tremujorin e parë të vitit 2012. Nga debitorët e trashëguar ndër vite deri më 31.12.2006, mbeten pa u likuiduar rreth 284 milion lekë për të cilët nga DPD kërkohet të ndiqen procedurat përkatëse ligjore. Është me rëndësi të **vëmë** në dukje këtu se gjendja më e madhe që trashëgohet deri më 31.12.2011 u takon viteve 2008 me vlerën 554.2 milion lekë, vitit 2009 me një borxh doganor në vlerën 457 milion lekë ose në masën 15.44% të totalit të borxhit doganor, viti 2010 me një borxh doganor prej 788, 4 milion lekë ose në masën 26.7% të totalit të borxhit doganor dhe viti 2011 me një borxh doganor në vlerë 652.8 milion lekë të totalit të borxhit doganor ose në masën 22.05% . Vetëm me vendime administrative të nxjerra në vitin 2011 për shkelje të ndryshme që iu përkasin periudhës të mëparshme (2005-2008) rezultojnë 516 milion lekë, rrjedhojë e përgjigjeve të marra nga autoritete doganore të shteteve me të cilat operohet nga DPD për shkresat verifikuese të dërguara nga kjo e fundit, gjë e cila kërkon nga autoritetet përkatëse marrjen e të gjithë masave ligjore për rikuperimin e detyrimeve të lindura.

Në auditimet e kryera nga KLSH si dhe të dhënat e DPD-së konstatojmë se deri më 31.12.2011 nga totali i borxhit prej 2.959 milion lekë, 32.44% e tij ose 960.1 milion lekë e zë borxhi i krijuar nga mospagesa e detyrimeve doganore të papaguara për TVSH –në e shtyrë. Ndryshe nga vitet e mëparshme për vitin 2011, borxhi i krijuar nga moslikuidimi i TVSH-së së shtyrë rezulton në 572.6 milion lekë ose në masën 59.6% të borxhit të lindur nga mospagesa e tvsh-së së shtyrë gjithsej. Më keq në lidhje me gjendjen e borxhit doganor të lindur nga mospagesa e TVSH-së së shtyrë gjendje më 31.12.2011 paraqiten Degët Doganore Tiranë për vlerën 457 milion lekë ose në masën 47.6% të totalit të borxhit për TVSH-ne shtyre dhe 45.6% të totalit të borxhit gjithsej të vetë degës; Berat për vlerën 177.6 milion lekë ose pothuajse 100 të borxhit total të sajë, Durrës për vlerën 138.5 milion lekë ose 20.82% të totalit të borxhit të sajë, Fier me vlerën prej 98.2 milion lekë ose në masën 80.8% të totalit të borxhit .

Ndër shkaqet kryesore që kanë ndikuar në lindjen dhe shtimin e borxhit doganor paraqesim:

-Shkeljet nga ana e administratës doganore të kërkesave të legjislacionit doganor dhe të dispozitave zbatuese të tij, gjatë zbatimit të procedurave të zhdoganimit të mallrave të importit e të eksportit, gjatë mbikëqyrjes së regjimeve ekonomike, si dhe gjatë zbatimit të procedurave të lehtësive doganore (skemat e shtyrjes së pagesa zënë një efekt e shprehur në vlerë për 960 milion lekë).

2. Mosmarrjen e masave të plota ligjore lidhur me rikuperimin e borxhit doganor

-Mossigurimin e rezultateve të duhura nga bashkëpunimi me strukturat e tjera të shtetit, sidomos me DPT, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit rrugor. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme lidhur me ekzekutimin e detyrueshëm të titujve, përfshirë veprimet e sekuestrimit apo të kalimit të pronësisë, të cilat duhet të zbatohen nga Zyrat Përmbartimore në rrethe;

-Mungesa e zbatimit me rigorozitet të masave të përcaktuara për arkëtimin e detyrimeve debitore, në veçanti të borxhit të mbështetur edhe nga Autoritetet

Gjyqësore me urdhra ekzekutiv për zbatim të menjëhershëm nga Zyrat e Përmbartimit Gjyqësorë në rrethe etj.

Marrja e masave për zbatimin e saktë dhe në kohë të legjislacionit doganor për të mundësuar rritjen e eficiencës së punës në aspektin e mbledhjes dhe rikuperimit të borxhit doganor. Ndjeka e të gjitha rrugëve të mundshme ligjore, që kur lind një borxh doganor, përgatitja, nxjerrja dhe kontabilizimi i vendimit, njoftimi i debitorit, nxjerrja e urdhrave të ekzekutimit përbëjnë ndër detyrat prioritare të organeve doganore për të patur rezultatin e kërkuar dhe të duhur në lidhje me arkëtimin dhe rikuprimin e borxhit doganor .

Aneksë :

Të dhënat

Gjendja e borxhit doganor viti 2011, shtesat, paksimet krahasuar më 2010

Vitet	Gjendja në fillim		Shtuar gjatë vitit		Pakësuar gjatë vitit		Gjendja në fund	
	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
2010	2304	10,404,790,579	2012	4,606,281,435	1800	2,713,326,829	2516	12,97,745,185
2011	2516	12,297,745,185	2289	3,971,853,554	3630	3,310,368,789	1,175	12,59,229,950
Ndryshimi		1,892,954,606	277	-634,427,604	1830	0,597,041,960	-1341	38,515,235

Struktura e gjendjes së borxhit doganor

Nr	Periudha	Numri	Detyrimet	Gjobat	Kamat Vonesat	Totali
1	31.12.2010	2516	3,907,779,022	6,297,941,008	2,092,025,155	12,297,745,185
2	31.12.2011	1175	1,706,059,413	1,081,759,694	171,410,843	2,959,229,950
3	Diferenca	-1,341	-2,201,719,609	-5,216,181,314	-1,920,614,312	-9,338,515,235
4	Në % / 2010	46.7	43.66	17.18	8.19	24.06
	2010	Struktura	31.8	51.20	17.00	100
	2011		57.64	36.56	5.80	100

Vendime administrative të mbështetur me Urdhra ekzekutimi (progresiv)

Nr	Dega Doganore	Vendime Admini	Detyrimi	Penalitet	Interes	Shuma	Paguar	Shuma e mbetur
----	---------------	----------------	----------	-----------	---------	-------	--------	----------------

Performanca e KLSH janar-qershor 2012

		strtive						
1	Tiranë	40	329,920,207	24,081,654	16,609,032	370,610,893	0	370,610,893
2	Rinas	0	0	0	0	0	0	0
3	Durrës	51	112,532,903	203,209,465	25,780,204	341,522,572	3,701,238	337,821,334
4	Shkodër	2	19,832,505	0	0	19,832,505	1,323,665	18,508,840
5	Kakavi	3	70,816	592,191	171,923	834,930	0	834,930
6	Korçë	4	12,495,942	3,069,538	5,469,257	21,034,732	0	21,037,737
7	Q.Thanë	2	2,231,105	267,404	63,6725	3,135,234	0	3,135,234
8	Vlorë	17	20,016,476	6,594,842	372,228	26,983,546	1,582,135	25,401,411
9	Fier	0	0	0	0	0	0	0
10	Sarandë	1	1,089,600	3,268,800	664,900	5,023,300	0	5,023,300
11	Elbasan	0	0	0	0	0	0	0
12	Lezhë	0	0	0	0	0	0	0
13	Berat	15	77,830,716	0	20,019,832	97,850,548	5,570,793	92,279,755
14	Kukës	3	5,439,489	2,746,744	1,164,148	9,404,381	0	9,404,381
15	Blatë	1	830,015	249,045	56,932	388,992	0	388,992
16	Tri Urat	1	23,823,477	11,911,739	4,977,916	40,713,132	0	40,713,132
17	TOTALI	140	605,420,251	255,991,422	75,923,097	937,334,770	12,177,831	925,156,939

Viti 2011, numri i rasteve të subjekteve debitorë të mbështetura me Urdhra Ekzekutimi nga Autoritetet Gjyqësore, paraqitet :

DEGA	Numër Rastesh	Detyrime Doganore	Penalitetet	Kamate Vonesa	Total Borxhi	Shuma e Paguar	Shuma për t'u paguar
TIRANË	2	146,905,788	413,674	0	147,319,462	0	147,319,462
DURRËS	40	69,391,691	66,843,586	5,847,928	142,083,205	3,701,238	138,381,967
SHKODËR	1	11,770,899	0	0	11,770,899	1,323,665	10,447,234
POGRADEC	1	267,404	267,404	30,131	564,939	0	564,939
VLORË	11	16,429,987	4,706,590	113,037	21,249,614	1,582,135	19,667,479
KUKËS	3	5,493,489	2,746,744	1,164,148	9,404,381	0	9,404,381
TRE URAT	1	23,823,477	11,911,739	4,977,916	40,713,132	0	40,713,132
TOTALI	59	274,082,735	86,889,737	12,133,160	373,105,632	6,607,038	366,498,594

Gjendja e borxhit doganor i trashëguar deri më 31.12.2011 paraqitet :

në lekë

Nr.	Vitet	Vendime	Detyrim doganor	Penalitetet	Kamate Vonesa	Totali
1	1995 1988	104	102.838.272	-	47.708.358	150.546.630
2	2000	3	44.950.345	1.304.325	16.609.032	62.863.702
3	2001	1	21.423.888	-	-	21.423.888
4	2002	5	14.460.821	10.880.312	12.194.255	37.535.388
5	2003	5	3.752.685	2.745.590	3.157.558	9.655.833
6	2004	5	8.345.877	36.641.276	9.190.552	54.177.705
7	2005	3	494.538	417.900	86.192	998.630

Performanca e KLSH janar-qershor 2012

8	2006	14	24.337.171	75.126.005	1.673.309	101.136.485
9	2007	27	21.596.972	45.353.151	1.665.818	68.615.941
10	2008	103	304.485.725	243.992.077	5.683.706	554.161.508
11	2009	215	330.559.549	97.981.350	28.440.756	456.981.655
12	2010	332	434.945.501	316.722.600	36.702.785	788.370.886
13	2011	477	393.868.069	250.595.108	8.298.524	652.761.700
	Totali	1.294	1.706.059.413	1.081.759.694	171.410.843	2.959.229.950

Borxhi doganor për mospagesën e TVSH -së shtyrë.

DEGA	Nr. Rastesh	Detyrime Doganore	Penalite	Kamat vonesa	Total Borxhi	Shuma e Paguar	Borxhi trashëguar deri me 31.12.2011	% ndaj borxhit	
								TVSH	Totalit Borxhit
TR	45	458,688,071	3,700,000	0	462,388,071	5,377,675	457,010,396	47.6	45.56
DR	15	138,170,940	0	3,315,966	141,486,906	3,000,000	138,486,906	14.42	20.82
SH	14	31,105,025	0	0	31,105,025	1,323,665	29,781,360	3.10	21.13
PG	1	267,404	267,404	30,131	564,939	0	564,939	0.06	1.02
GJ	4	10,473,238	-	1,891,601	12,364,839	-	12,364,839	1.29	15.65
KO	2	11,043,331	50,000	3,025,428	14,118,759	0	14,118,759	1.47	9.45
VL	10	19,912,302	500,000	555,893	20,968,195	2,433,681	18,534,514	1.93	6.14
FR	6	97,667,569	550,000	0	98,217,569	0	98,217,569	10.23	80.77
EL	4	8,505,026	50,000	264,784	8,819,810	0	8,819,810	0.92	44.04
LE	7	3,948,866	0	664,138	4,613,004	0	4,613,004	0.48	17.32
BR	27	160,453,644	0	23,742,764	184,196,408	6,607,569	177,588,839	18.5	100
T.OT	135	940,235,416	5,117,404	33,490,705	978,843,525	18,742,590	960,100,935	100	32.44

Nga auditimi i afatit kohor të lindjes së borxhit nga moslikuidimi i TVSH-së së shtyrë rezulton kjo gjendje:

Viti	Raste	Detyrimi Doganor	Penalitet	Kamat vonesë	Total Borxh	Paguar	Shuma për t/u paguar	Statusi		Urdh. Ekzek.
								Pez	Aktiv	
2009	18	100.643.029	1.550.000	14.847.644	117.040.673	8.585.559	108.455.114	17	1	4
2010	58	270.569.620	1.467.404	12.895.405	284.932.429	5.844.458	279.087.971	50	8	32
1011	59	569.022.767	2.100.000	5.747.656	576.870.423	4.312.573	572.557.850	33	26	15
	135	940.235.416	5.117.404	33.490.705	978.843.525	18.742.590	960.100.935	100	35	51

Detyrimet e papaguara për shtyrje TVSH-je vetëm me vendime të vitit 2011.

Performanca e KLSH janar-qershor 2012

DEGA	Numër Rastesh	Detyrime Doganore	Penalitete	Kamat Vonesa	Total Borxhi	Shuma e Paguar	Shuma për tu Paguar
TIRANË	24	335,921,447	1,700,000	0	337,621,447	1,815,416	335,806,031
DURRËS	9	121,065,256	0	1,746,919	122,812,175	0	122,812,175
SHKODËR	4	9,760,102	0	0	9,760,102	0	9,760,102
KAKAVIJË	1	2,043,374	-	229,880	2,273,254	-	2,273,254
VLORË	5	10,532,845	250,000	21,134	10,803,979	1,460,381	9,343,598
FIER	1	3,894,338	100,000	0	3,994,338	0	3,994,338
ELBASAN	2	3,073,314	50,000	0	3,123,314	0	3,123,314
LEZHË	1	109,163	0	26,791	135,954	0	135,954
BERAT	12	82,622,928	0	3,722,932	86,345,860	1,036,776	85,309,084
TOTALI	59	569,022,767	2,100,000	5,747,656	576,870,423	4,312,573	572,557,850

TË DHËNA PËR RAPORTIN E BUXHETIT TË VITIT 2011
(nga sistemi tatimorë)

1. Realizimi i të ardhurave tatimore për vitin 2011.

Plani i të ardhurave tatimore neto (pa vl.e rimbursuar) për vitin 2011, është realizuar në masën 93% e nivelit të parashikuar, me një mos realizim në vlerën prej 7,053 milionë lekë. Ky impakt është shkaktuar si pasojë e mosrealizimit të kuotave të planifikuara në të ardhurat nga tatimet.


Nivelin e të ardhurave tatimore neto prej 108,499 milionë lekë, ndahet:

- *Të ardhura nga sektori shtetërorë në vlerën prej 14,282 milionë lekë, ose 13% e të ardhurave, kjo për 2375 subjekte.*
- *Të ardhura nga sektori privat në vlerën prej 94,217 milionë lekë, ose 87% e të ardhurave, kjo për 68587 subjekte.*


Duke analizuar periudhat e viteve 2010 dhe 2011, konstatohet se të ardhurat e realizuara në 2011 paraqiten në rritje, përkatësisht nga 105,509 milionë lekë të realizuara në vitin 2010, në 108,450 milionë lekë të realizuara në vitin 2011, ose në masën 3 % më tepër dhe në vlerë 2,990 milionë lekë më shumë.

Në mënyrë grafike ecuria e realizimit të ardhurave tatimore për periudhën 7 vjeçare, paraqitet:

Performanca e KLSH janar-qershor 2012



Në totalin e të ardhurave, përqindja e çdo zëri tatimor për vitin 2011, paraqitet në pasqyrën poshtë:



Nga të dhënat grafike konstatohet se të ardhurat nga tatimet indirekte zënë 39 % e të ardhurave (TVSH dhe Akciza), kurse tatimet direktet 61 % e të ardhurave (të tjerat).

Në analizën e zërave tatimore për vitin 2011, rezulton se vetëm Taksat Nacionale paraqiten me realizim të ardhurash, kurse zërat e tjerë me mos realizim, konkretisht:

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, paraqitet me realizim në masën 87%, ose minus 2,817 milionë lekë.

Tatimi mbi Fitimin, paraqitet me realizim në masën 98%, ose minus 252 milionë lekë.

Akciza, paraqitet me realizim në masën 93%, ose minus 1,408 milionë lekë.

Ardhurat Personale, paraqiten me realizim në masën 94%, ose minus 1,600 milionë lekë.

Taksat Nacionale, paraqiten me realizim në masën 110%, ose plus 946 milionë lekë.

➤ *Analizuar sipas llojit të tatimeve*, rezulton:

1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto)

Për vitin 2011, të ardhurat neto nga TVSH^{ja} (tatimet), janë realizuar në masën 87%, ose nga vlera 30,170 milionë lekë e programuara, janë arkëtuar vlera prej 26,280 milionë lekë, *me një mosrealizim në vlerën prej 3,890 milionë lekë.*

Nga 14 DRT^{re}, rezultojnë me realizime 3 (tre), konkretisht DRT Elbasani në masën 106%, DRT Fier në masën 101% dhe DRT Shkodër në masën 116%, me një tejkalim në vlerë kundrejt planit në vlerën 95 milionë lekë. Ndërsa nga 11 drejtori të tjera që paraqiten me mosrealizime, 7 prej tyre rezultojnë me një nivel mosrealizimi nga 11% - 37%.

Nga DRT^{re} me detyra të parealizuara, veçojmë DRT Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, e cila rezulton me mosrealizim në vlerën prej 3,490 milionë lekë, vlerë kjo e barabartë me rreth 87% e totalit të mosrealizimit të TVSH-së.

Të ardhurat neto nga TVSH^{ja}, në vitin analizues rezultojnë 2,962 milionë lekë më të ultë se ato të realizuara në vitin 2010, ose në masën 10% më pak. Nga 14 DRT^{re}, vetëm 6 prej tyre kanë realizuar më shumë të ardhura në vitin 2011, krahasuar me ato të realizuara në vitin 2010, ndonëse numri i tatimpaguesve të TVSH^{së} në vitin 2010 ka pësuar rritje kundrejt atyre të regjistruar në vitin 2011.

Megjithëse numri i tatimpaguesve për vitin 2011 kundrejt vitit 2010 është rritur me 2847 tatimpagues, ose në masën 15.4% (nga 16436 në vitin 2010, në 19283 në vitin 2011), po kështu shitja e tatueshme total ka pasuar rritje në vlerën 135,422,930 mijë lekë, ose në masën 14% (nga vlera 1,044,347,898 mijë lekë në vitin 2010, në vlerën 1,139,770,828 mijë lekë në vitin 2011), TVSH^{ja} e arkëtuar ka pasuar *rënie* me një vlerë prej 9,515,310 mijë lekë, ose në masën rreth 27% (nga 35,974,950 mijë lekë në vitin 2011, në 26,279,640 mijë lekë në vitin 2011).

Ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga TVSH^{ja} kanë pasur dhe faktorë të tillë si; *rritja e numrit të subjekteve tatimpagues kreditorë, atyre që nuk deklarojnë dhe ata që deklarojnë me zero.*

Duke shkuar më tej në analizë, rezulton se ndërsa realizimi i TVSH^{së} neto nga 01.01.2011 (viti 2010) më 31.12.2011 ka rënë nga vlera 29,242 milionë lekë në vlerën 26,280 milionë lekë, në nivelin rreth 90 % (26,280/29,242), kredia është rritur për të njëjtën periudhë me rreth 13 % (41,471/36,657), pra kemi ritëm më të lartë të rritjes së kredisë se sa arkëtimin të TVSH^{së} neto brenda të njëjtës periudhë ushtrimore. Po kështu dhe numri i subjekteve ka pësuar rritje nga njëra periudhë në tjetrën, kështu në fillim të vitit 2011, ky numër deklarohet 12455 subjekte, dhe në fund të vitit 2011 ky numër deklarohet 18742 subjekte, pra shtuar me 6017 subjekte, ose mbi 50 %. Sipas DRT-re paraqitet kjo situatë ; DRT Berat për 487 subjekte ose në masën 16 % më shumë se një vit më parë, DRT Dibër për 233 subjekte ose në masën 39 % më shumë se një vit më parë, DRT Durrës për 652 subjekte ose në masën 36 % më shumë se një vit më parë, DRT Elbasan për 117 subjekte ose në masën 18 % më shumë se një vit më parë, DRT Fier për 492 subjekte ose në masën 43 % më shumë se një vit më parë, DRT Gjirokastër për 68 subjekte ose në masën 21 % më shumë se një vit më parë, DRT Korçë për 87 subjekte ose në masën 12 % më shumë se një vit më parë, DRT Lezhë për 89 subjekte ose në masën 22 % më shumë se një vit më parë, DRT Sarandë për 67 subjekte ose në masën 25 % më shumë se një vit më parë, DRT Shkodër për 398 subjekte ose në masën 56 % më shumë se një vit më parë, DRT Vlorë për 894 subjekte ose në masën 112 % më shumë se një vit më parë, DRT Tiranë për 3256 subjekte ose në masën 73 % më shumë se një vit më parë dhe DRT Kukës për 67 subjekte më shumë se një vit më parë.

Performanca e KLSH janar-qershor 2012

Ndërsa gjendja e subjekteve tatimpagues me mos deklarim dhe deklarim me zero në TVSH, paraqitet në pasqyrën mëposhtme:

EMËRTIMI	Dek. Gjithsej tatimpagues nr.	Viti 2010		EMËRTIMI	Dek. Gjithsej tatimpagues nr.	Viti 2011	
		Dek pa aktivitet gjithë vitit	Mos dek gjithë vitit			Dek pa aktivitet gjithë vitit	Mos dek gjithë vitit
DRT BERAT	477	34	1	DRT BERAT	592	20	8
NJTPM	823	3	8	NJTPM	823	13	11
DRT DURRËS	2,161	426	181	DRT DURRËS	2,714	453	414
DRT DIBER	252	36	11	DRT DIBER	319	44	31
DRT ELBASAN	901	113	97	DRT ELBASAN	1,193	122	143
DRT FIER	1,279	168	62	DRT FIER	1,635	199	129
DRT GJIROKASTËR	411	29	27	DRT GJIROKASTËR	456	23	73
DRT KORÇË	910	131	39	DRT KORÇË	1,067	117	77
DRT KUKËS	46	4	36	DRT KUKËS	64	6	62
DRT LEZHË	510	50	7	DRT LEZHË	606	53	27
DRT SARAND	405	54	0	DRT SARAND	513	80	0
DRT SHKODËR	870	122	14	DRT SHKODËR	884	64	44
DRT TIRANË	6,394	1,590	1,118	DRT TIRANË	7,166	1,551	1,815
DRT VLOREË	997	157	92	DRT VLOREË	1,251	166	161
TOTALI	16,436	2,917	1,693	TOTALI	19,283	2,911	2,995

Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se numri i subjekteve mos deklarues zë 15.5% të numrit gjithsej të subjekteve tatimpagues të regjistruar në TVSH, dhe në krahasim me vitin 2010 subjekte pa aktivite dhe deklarim me zero është rritur për 1296 subjekte, kurse numri i subjekteve të regjistruar në TVSH ka pësuar rritje prej 2847 subjekte rritja e numrit të subjekteve mos deklarues dhe deklarim me zero kanë ndikuar influencuar negativisht në nivelin e arkëtimit të TVSH-së.

Përkeqësimi i treguesve në vitin 2011 kundrejt vitit 2010, tregon se masat organizative dhe teknike të marra nga administrata tatimore në arkëtimin e TVSH-së nuk kanë qenë efektive, sidomos në bashkëpunim dhe bashkërendimin e punëve ndërmjet strukturave të administratës tatimore lidhur me kryerjen e kontrolleve dhe verifikimeve në subjektet që kanë kryer pagesa të ulta TVSH-je, nuk deklarojnë apo paraqiten me deklarim me zero.

- Gjatë vitit 2011 janë bërë 705 kërkesa për rimbursim me vlerën prej 18,251,542 mijë lekë dhe janë miratuar 471 kërkesa ose 66,8 %, me vlerën prej 13,723,479 mijë lekë ose 75,1 % e vlerës së kërkuar. Rimbursimi faktik në total, pasqyrohet se është në vlerën prej 6,758,180 mijë lekë ose mbi 49,2 % e vlerës së miratuar. Brenda vlerës së rimbursuar, me xhirim (kthim

drejtpërsëdrejti subjektit) janë 6,374,183 mijë lekë ndërsa me kompensim (për shtyrje detyrimesh të tjera tatimore ligjërisht për t'u paguar) janë dhënë 383,997 mijë lekë.

Pra e thënë ndryshe vetëm 5,6 % e rimbursimeve të dhëna kanë shkuar drejtpërsëdrejti në favor të shlyerjes së detyrimeve të ndryshme tatimore me dobi në rritjen e të ardhurave tatimore në buxhetit të shtetit, pjesa tjetër prej 94,4 % kanë shkuar drejtpërsëdrejti tek subjektet.

2. Tatimi mbi fitimin

Për vitin 2011, Tatim mbi Fitimin nuk është realizuar për vlerën prej 1,408, milionë lekë ose 7%, ku nga 14 DRT^{re} e kanë realizuar 3 DRT^{re}, për një vlerë prej 399 milionë lekë dhe nuk e kanë realizuar 11 DRT^{re} për një vlerë prej 2,450 milionë lekë, ose 20% e DRT^{re}.

Bazuar në të dhënat e DPT-së, paraqiten me realizime 3 DRT-re për vlerën 339 milionë lekë, konkretisht DRT Berat për vlerën 8 milionë lekë, DRT Kukës për vlerën 14 milionë lekë dhe DRT Tiranë për vlerën 376 milionë lekë, kurse me mosrealizim paraqiten 11 DRT e tjera për vlerën 1,042 milionë lekë, konkretisht; DRT Dibër për minus vlerën 39 milionë lekë, DRT Durrës për minus vlerën 117 milionë lekë, DRT Elbasan për minus vlerën 55 milionë lekë, DRT Fier për minus vlerën 106 milionë lekë, DRT Gjirokastër për minus vlerën 52 milionë lekë, DRT Korçë për minus vlerën 99 milionë lekë, DRT Lezhë për minus vlerën 74 milionë lekë, DRT Sarandë për minus vlerën 35 milionë lekë, DRT Shkodër për minus vlerën 1 milionë lekë, DRT NjTPM për minus vlerën 245 milionë lekë dhe DRT Vlorë për minus vlerën 217 milionë lekë

Duke krahasuar arkëtimet e vitit 2010 me 2011, konstatohet se kemi një rritje për vlerën 2 milionë lekë ose plus 12%, nga të cilat me tejkalime janë 6 DRT^{re} me vlerë 756 milionë lekë dhe me ulje janë 8 DRT^{re} me vlerë prej 9,214 milionë lekë.

Ulje më të madhe se fakti i vitit 2010, e ka DRT/NjTPM ku megjithëse është planifikuar me ulje për vlerën prej 8,775 milionë lekë, ka arkëtuar më pak për vlerën prej 9,019 milionë lekë, gjithmonë në krahasim me faktin e vitit 2010.

Efekt negativ në mosrealizimin e Tatim mbi Fitimin, ka të bëjë me mos evidentimin dhe kontrollin e subjekteve me risk të lartë sipas treguesve negativ që paraqiten si:

- Rritja e gjendjes kreditore për të njëjtën periudhë për 2142 subjekte ose mbi 23% (në fund të vitit 2010 numri i subjekteve kreditor është 9203 subjekte dhe në fund të vitit 2011 ky numër deklarohet se është 11345 subjekte), dhe më tepër për një vlerë prej 613 milionë lekë, ose 8.6 %.
- Rritja e nivelit të subjekteve debitorë, ku për të njëjtën periudhë ajo paraqitet në vlerën 847, milionë lekë.
- Rritja e nivelit të subjekteve me humbje për 3200 subjekte me vlerë prej -42,990 milionë lekë.

3. Akciza

Plani i të ardhurave nga Akciza për vitin 2011, paraqitet me realizim në masën 98%, ose më pak për vlerën 252 milionë lekë se parashikimi.

Sipas të dhënave të administratës tatimore qendrore, paraqiten me mos realizim 6 DRT-re për një vlerë prej 460 milionë lekë, më e theksuar në NjTPM për vlerën 362 milionë lekë ose 78% e mosrealizimit 14% e mosrealizimit.

Kurse me realizim paraqiten 8 DRT-re për një vlerë prej 208 milionë lekë, ku me realizim më të lartë paraqitet DRT Tiranë me vlerë 135 milionë lekë, ose 14% e vlerës së realizuar.

Në krahasim me arkëtimet e vitit 2010, konstatohet se në vitin 2011 janë realizuar të ardhura me shumë për vlerën 1,859 milionë lekë, ose 13% më i lartë. Po të krahasojmë sipas DRT-ve, konstatohet se realizimet kanë një disproporcion të theksuar ku disa DRT-re paraqiten me

Performanca e KLSH janar-qershor 2012

realizim të larta si DRT Fier prej 461%, DRT Gjirokastrë prej 89%, DRT Lezhë prej 148%, DRT Sarandë prej 143%, DRT Tiranë prej 72%, kurse disa të tjera me mos realizime të theksuara si DRT Shkodër prej 94%, DRT Kukës prej 51% dhe DRT Korçë prej 32%, element ky e cili tregon se planifikimi sipas DRT-ve nuk është mbi baza reale të numrit të subjekteve dhe kapaciteteve prodhuese e tregues të mallrave të akcizës.

Gjithashtu sipas të dhënave të DPT-së, konstatohet se në disa DRT^{re}, megjithëse numri i subjekteve paraqitet në rritje prej +27 subjekte, arkëtimet paraqiten me ulje me vlerë -534,616 mijë lekë nga viti 2010 në vitin 2011, konkretisht pasqyra:

Në 000/lekë

Nr.	EMERTIMI	PERIUDHA 12 - MUJORE					
		FAKTET		Diferenca	Nr.Sub tatimpagues		Diferenca
		2010	2011	+ ose -	2010	2011	+ ose -
A-3	AKCIZA	728,881	194,265	(534,616)	76	103	27
	Nga të cilat:						
1.	DRT DURRËSI	132,594	116,288	(16,306)	36	44	8
2.	DRT FIERI	535,821	61,728	(474,093)	14	26	12
3.	DRT SHKODRA	45,767	4,096	(41,671)	14	14	0
4.	DRT VLORA	14,699	12,153	(2,546)	12	19	7

Treguesit e mësipërm tregojnë që puna e administratës tatimore në menaxhimin e Akcizës nuk ka qenë në nivele të mira, veprime të cilat kanë ndikuar dhe në mos realizimin e të ardhurave nga Akciza.

4. Të ardhurat personale

Për vitin 2011, plani i të ardhurat për tatimin mbi të ardhurat është realizuar në masën 95%, ose më pak për vlerën prej 1,600, milionë lekë, në raport me treguesit e planit. Me realizim paraqitet vetëm NjTPM për vlerën 228 milionë lekë, kurse drejtoritë e tjera paraqiten me mosrealizime, më e theksuar kjo në DRT Durrës me 26% ose më pak prej -540, milionë lekë, DRT Fier me 25%, ose më pak prej -301, milionë lekë.

Bazuar në të dhënat e DPT-së, krahasuar me vitin 2010, arkëtimet kanë pësuar rritje për vlerën prej 847, milionë lekë. Nga krahasimi sipas DRT^{re}, konstatohet se në 10 prej tyre nuk është bërë e mundur të arkëtohen të ardhura sa fakti i vitit 2010, me një diferencë prej 471 milionë lekë, kur numri i subjekteve vjen në rritje. Më e theksuar kjo konstatohet në DRT Durrës me një diferencë prej 204 milionë lekë.

Me rritje niveli të ardhurash me faktin e vitit 2010, paraqiten 4 DRT^{re}, ku me vlerë më të lartë paraqitet NjTPM prej 1,086 milionë lekë, e cila luan rolin kryesorë në realizimin e këtij zëri, pasi zë 40% të totalit.

Nga administrata tatimore kërkohet një punë e mirë dhe serioze në realizimin real të të ardhurave nga tatimi mbi pagesat e sektorit privat, tatimi mbi qiranë, mbi shitjet e pasurive të paluajtshme e tje. Të gjitha këto me synimin konstatimin dhe përcaktimin e masave për mënjanimin e informalitetit në numrin e punonjësve të angazhuar në punë realisht dhe në nivelin real të pagave të punonjësve me ato të deklaruara nga vetë subjektet, sidomos në aktivitetet e prodhimit dhe të ndërtimit.

5. Taksat nacionale dhe të tjera

Performanca e KLSH janar-qershor 2012

Nga pasqyra konstatohet se të ardhurat nga Taksat Nacionale janë realizuar në masën 110 %, ose më shumë se parashikimi për vlerën 945 milionë lekë.

Nga të dhënat e disponueshme nga DPT-ja, konstatohet se vetëm 3 DRT janë me realizim të ardhurash për një vlerë prej 3,050 milionë lekë (nga e cila DRT Elbasan me vlerë 71 milionë lekë, DRT Tiranë me vlerë 440 milionë lekë dhe NjTPM me vlerë 2,539 milionë lekë), kurse 11 DRT e tjera paraqiten me mosrealizim për një vlerë prej 2,105 milionë lekë, ku vetëm DRT Durrës paraqitet me një mosrealizim për vlerën 1,183 milionë lekë, ose 57% e mosrealizimit.

Në krahasim me faktin e vitit 2010, të ardhurat në vitin 2011 kanë pësuar rritje për një vlerë prej 1,785 milionë lekë, ose me rritje prej 22%, kurse sipas DRT-ve të ardhura më shumë se viti 2010, paraqiten NjTPM me vlerë 2,404 milionë lekë e cila zë rreth 99% dhe DRT Elbasan me vlerë 33 milionë lekë.

Sipas strukturës, realizimi i Taksave Nacionale për vitin 2011, paraqitet:

- Renta minerale me vlerë 1,320 milionë lekë.
- Taksa e mjeteve të përdorura me vlerë 2,820 milionë lekë.
- Taksa e karbonit me vlerë 2,114 milionë lekë.
- Taksa portuale me vlerë 0,7 milionë lekë.
- Taksa e akteve dhe pullës me vlerë 717 milionë lekë
- Taksa veprimtari peshkimi me vlerë 9, milionë lekë.
- Taksa regjistrimi lojra fati me vlerë 12 milionë lekë
- Tarifa shërbimi dhe të tjera taksa me vlerë 2,996 milionë lekë

Nga sa sipër, përqindjen më të lartë në Taksat Nacionale e zënë taksa e mjeteve të përdorura me 28%, taksa e karbonit me 21% dhe renta minerale me 13%.

7. Kontributet e Sigurimeve Shoqërore:

Realizimi i të ardhurave nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore sipas DRT^{re};

Në 000/lekë

Nr.	E M E R T i M I	PERIUDHA 12 - MUJORE						
		FAKTET		PLANI 2011	Diferenca PLAN - FAKT		Diferenca	
		2010	2011		+ ose -	%	Fakt 2011 - Fakt 2010	%
A-7	Kontribute Gjithsej	48,169,240	51,527,273	53,560,000	-2,032,727	96%	3,358,033	107%
	<i>Nga të cilat:</i>							
1	D.R. Tatimore BERAT	1,504,764	1,597,693	1,696,000	-98,307	94%	92,928	106%
2	D.R. Tatimore DIBRA	1,137,015	1,208,656	1,257,000	-48,344	96%	71,641	106%
3	D.R. Tatimore DURRËSI	3,994,737	4,296,705	4,634,000	-337,295	93%	301,968	108%
4	D.R. Tatimore ELBASANI	2,592,679	2,702,595	2,935,000	-232,405	92%	109,916	104%
5	D.R. Tatimore FIERI	2,667,320	2,770,931	3,024,000	-253,069	92%	103,611	104%
6	D.R. Tatimore GJIROKASTRA	1,136,249	1,175,434	1,296,000	-120,566	91%	39,185	103%
7	D.R. Tatimore KORÇA	2,321,826	2,397,039	2,652,000	-254,961	90%	75,213	103%
8	D.R. Tatimore KUKËSI	818,700	843,331	906,000	-62,669	93%	24,631	103%

Performanca e KLSH janar-qershor 2012

9	D.R. Tatimore LEZHA	1,354,479	1,440,354	1,507,000	-66,646	96%	85,875	106%
10	D.R. Tatimore SARANDA	656,217	671,643	738,000	-66,357	91%	15,425	102%
11	D.R. Tatimore SHKODRA	2,420,300	2,523,529	2,706,000	-182,471	93%	103,229	104%
12	D.R. Tatimore TIRANA	14,978,235	16,689,416	16,405,000	284,416	102%	1,711,181	111%
13	D.R.T. NjTPM	10,738,178	11,263,226	11,710,000	-446,774	96%	525,048	105%
14	D.R. Tatimore VLORA	1,848,541	1,946,722	2,094,000	-147,278	93%	98,181	105%

Shënim: Të dhënat e tabelës janë marë nga Sektori i Statistikave me datë 27/04/2012

Nga të dhënat e disponueshme të DPT^{-së}, rezulton se të ardhurat e realizuara nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore janë në masën 96 % e planit të parashikuar ose më pak se parashikimi për vlerën 2,033 milionë lekë. Sipas DRT^{-ve} me realizim paraqitet vetëm DRT Tiranë në masën 7%, ose plus 284 milionë lekë se parashikimi, kurse DRT e tjera me paraqiten me mosrealizime nga 4% - 9%.

Në totalin e të ardhurave gjithsej të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore zënë 31.6% të totalit.

Në krahasim me faktin e vitit 2010, ka një rritje prej 3,358 milionë lekë ose +7 %.

Të ardhura nga Kontributi i Sigurimeve paraqitet me vlerë prej **51,527 milionë** lekë, nga të cilat:

-Sektori shtetëror në vlerën prej 25,342 milionë lekë, ose 49% e të ardhurave, kjo për numrin mesatar kontribuesish (160324), me një nivel mesatar pagese për kontribues prej 158.2 mijë lekë/vit.

-Nga sektori privat në vlerën 26,188 milionë lekë, ose 51% e të ardhurave, kjo për numrin mesatar kontribuesish (260900), me një nivel pagese për kontribut prej 97.4 mijë lekë/vit.

Nga të dhënat rezulton se numri mesatar i kontribuesve me deklaram dhe pagesë për vitin 2011 paraqitet prej 421218 kontribues, ose 33012 kontribues më shumë se në vitin 2010, me një numër mesatar kontribuesish për subjekt prej rreth **5 kontribues/subjekt** (421218 kontribues mesatar me pagesë/78636 subjekte me pagesë), kurse numri i subjekteve mos deklarues në fund të vitit 2011 paraqitet prej **37887 subjekte**, nga e cila deri në një vit 29356 subjekte, nga një deri në dy vjet 19419 subjekte dhe nga dy deri në 5 vjet janë 25508 subjekt, dhe në krahasim me vitin 2010, ky tregues paraqitet me rritje prej **10359 subjekte** mos deklaruese.

Nisur sa më sipërm, si dhe nga mundësitë që ekzistojnë në tregun e punës, konstatohet se; angazhimi i strukturave përkatëse në DPT^{-së} dhe varësitë e saj, për mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve ka pasur mangësi të theksuara, të cilat kanë penguar realizimin e detyrave të planit fillestar të miratuar nga Ministri i Financave.

Si përfundim, megjithëse Administrata Tatimore ka punuar për realizimin e të ardhurave tatimore për vitin 2011, dhe se nga treguesit konstatohet se ka rritje të tyre nga njëra periudhë në tjetër, përsëri ato nuk janë realizuar në proporcion me planin.

Nga analiza e treguesve që analizuam më sipër, konstatohet se ka rezerva të cilat ndikojnë si në realizimin e të ardhurave gjithsej (tatimore + kontribute), po ashtu dhe në rritjen e tyre.

Treguesit negativ të cilat kanë ndikuar në nivelin e të ardhurave tatimore gjithsej për vitin 2011, gjerësisht trajtuar me departamente të veçanta të DPT^{-së} janë:

- Mos rritja e të ardhurave në propocion me rritjen e numrit të subjekteve.
- Niveli i ulët i pagesës së TVSH^{së}.
- Rritja e subjekteve kreditore për TVSH^{në} dhe Tatim mbi Fitimin.
- Rritja e subjekteve me aktivitet me humbje.
- Ulja e nivelit të arkëtimeve nga njëra periudhë në tjetër, për TVSH^{në}, Lojrat e Fatit dhe Taksën e Qarkullimit dhe Karburantit.
- Rritja e numrit të subjekteve debitore nga njëra periudhë në tjetër.
- Mos evidentimi dhe kontrollin e subjekteve me risk të lartë, kjo referuar treguesve negativ që ato kanë.
- Mungesa e luftës kundër informalitetit dhe konkurrencës së pandershme, në evidentimin dhe regjistrimin e subjekteve të paregjistruara.
- Mos kryerja e kontrolleve nga struktura të DPT^{së} në DRT, mbi ekzistencën e numrit të subjekteve mos deklarues.
- Mos vlerësimi dhe mos ndjekja nga strukturat përkatëse të DPT^{së}, mbi deklarimin e numrit të kontrubuesve nga subjekte të ndryshëm, ku realisht ekzistojnë mundësi dhe rezerva për rritjen e numrit të tyre dhe uljen e evazionit.

Shënim: Sqarojmë se një analizë e plotë e treguesve të realizimit ose mos realizimit të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve nuk është bërë e mundur, kjo për faktin se si nga administrata tatimore qendrore po ashtu dhe njësitë e sajë vartëse nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për auditim. Të dhënat e mësipërme janë të dhëna të përgjithshme që janë ofruar nga DPT-ja, të cilat janë të dhëna në total dhe jo me subjekte të veçanta ose me lloj aktivitetesh.

Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit

ANALIZA 6-MUJORE

Z. Athanas Karaja
Drejtore Departamenti

Sipas programit vjetor të kontrollit, në 6-mujorin e parë të këtij viti, për Departamentin e Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit kanë qenë planifikuar gjithsej 16 auditime, janë evaduar 14 auditime, 7 prej të cilave të trashëguar nga viti kaluar 2011, janë në proces evadimi 4 auditime si dhe vazhdon auditimin në 5 subjekte.

Sipas fushave të auditimit të departamentit, janë përfunduar shtatë projekte, pesë shoqëri dhe ente publike dhe 4 entet mjedisore, ndërsa sipas llojeve të auditimit janë përfunduar katër auditime të kombinuara (përputhshmërie dhe vlerësues) dhjetë auditime të përputhshmërisë (ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare) një auditim performance si dhe një certifikim llogarish.

Parë në tërësi, rezulton se pavarësisht se është realizuar numri gjithsej i planifikuar i auditimeve për këtë periudhë, është realizuar më pak një auditim përputhshmërie (pasi nuk kemi pasur të programuar certifikim llogarish, por është trashëguar nga viti i kaluar), si dhe në auditimet sipas subjekteve është ndjekur përparësia sipas orientimeve të zotit Kryetar.

Sipas auditimeve të evaduara dhe gjetjeve të rezultuara, janë rekomanduar përmirësime ligjore, masa organizative, administrative, disiplinore, si dhe masa për shpërbllimin e dëmit. Në mënyrë të përmbledhur, lidhur me rekomandimet e dhëna ka rezultuar se:

1. Përmirësime Ligjore: Në kontrollet e evaduara janë rekomanduar gjashtë masa për përmirësim ligjor: në dy ente mjedisore (përkatësisht në subjektet Drejtoria e Shërbimit Pyjor Durrës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave) si dhe në dy shoqëri dhe ente publike: Korporata Elektroenergjetike Shqiptare dhe Autoriteti i aviacionit Civil. Nisur nga gjetjet në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për një sërë mangësish në lidhje me mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal si në rastet e ndotjes së ajrit, të ujërave, të transportimit të mbeturinave toksike, të peshkimit të ndaluar, në prerjen e drurëve dekorativë dhe frutorë, shkatërrimin me zjarr nga pakujdesia apo me dashje të pyjeve dhe të mjedisit pyjor, shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve etj., për shmangien dhe parandalimin e tyre ne **kemi propozuar dhe rekomanduar ndryshimet përkatëse në “Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”, në drejtim të thellimit të masave ndëshkimore ndaj dëmtuesve dhe shkatërruesve të mjedisit.**

Gjithashtu, në zbatim të VKM nr. 396, datë 21.06.2006, pika 9, **kemi rekomanduar për t’i propozuar Këshillit të Ministrave për shfuqizimin e të drejtës së përdorimit të pyjeve komunale për Komunitet e rretheve Fier, Delvinë, Sarandë, Tepelenë, Vlorë të cilat nuk kanë marrë masa për parandalimin e zjarreve në periudhën e verës duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në ekonominë pyjore përkatëse.**

Në subjektin Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Durrës, **i rekomandohet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të bëjë rivlerësimin mjedisor të Parkut Natyror, në vendin e quajtur Rrushkull, rrethi Durrës, për ta shpallur “Zonë të Mbrojtur” dhe**

kategorinë përkatëse të mbrojtjes si dhe **t'i propozojë Këshillit të Ministrave, ngarkimin apo ngritjen e një organizmi (strukture), ku të jenë të përcaktuara detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë në lidhje me zbatimin e planeve të mbarështimit të Pyjeve.**

Në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare është **propozuar që procedurat e importit të energjisë elektrike të kryhen nga një agjenci e specializuar jashtë Korporatës e cila të ndjekë dhe realizojë importin e energjisë elektrike.** Kjo agjenci të specializohet në marketingun apo tregtimin e energjisë elektrike me tepër se Divizioni i Furnizimit Publik me Shumicë. Në këtë kuadër krijimi i një agjencie me objekt të veçantë, specifik, për importin dhe eksportin e energjisë elektrike, jo vetëm që do të ndikonte pozitivisht në performancën e KESH, por do të bëjë që vendi të jetë më mirë i integruar dhe konkurrues jo vetëm në tregun rajonal të energjisë elektrike por edhe më gjerë. Agjencia do të ketë aftësitë e duhura profesionale për të marrë pjesë në tregun spot që zhvillohet në vende të ndryshme të Evropës, për rrjedhojë kemi propozuar: Agjencia të ketë objekt të veprimtarisë, sigurimin e kapaciteteve të interkoneksionit, nëpërmjet ankandeve të organizuara nga OST.

Në lidhje me Autoritetin e Aviacionit Civil, si një ent publik me pavarësi financiare, kemi propozuar që: **në vitet në vazhdim, fondet e papërdorura të derdhen tërësisht në Buxhetin e Shtetit**, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga qeveria në sektorin e aviacionit civil.

2. Masa Organizative. Rezultojnë se janë rekomanduar 247 masa organizative, ku mund të përmendim subjektet: Autoritetin e Aviacionit Civil 33 masa, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare 31 masa, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë 30 masa, Drejtoria e Shërbimit Pyjor Durrës me 18 masa organizative, MMPAU me 14 masa, Certifikimi i Llogarive i kryer në projektin “Menaxhimi integruar i ujërave” 4 masa organizative, Ujësjetllës Kanalizime Fier 17 masa, Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave 20 masa etj.

Masat e rekomanduara kanë pasur karakter sa organizativ, po aq edhe administrativ, financiar në funksion të përmirësimit të menaxhimit të subjektit të audituar.

3. Masa Disiplinore dhe Administrative. Në lidhje me masat disiplinore dhe administrative për auditimet e evaduara nga ana jonë, janë rekomanduar 172 masa, nga të cilat 60 propozime janë bërë për Agjencinë e Prokurimit Publik, përkatësisht 14 në subjektin Ujësjetllës Kanalizime Fier dhe 10 në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave, 23 në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare, 13 në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Masat e tjera janë të karakterit disiplinor si “Largim nga puna” 8 raste, “Largim nga detyra” kemi propozuar tetë raste, “Kalim në një nivel më të ulët” tre raste, “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”, janë propozuar 33 raste, “Vërejtje me shkrim” 50 raste si dhe dënimin me gjobë 50 mijë lekë është dhënë ndaj gjashtë firmave të ndërtimit të cilat operojnë në investime publike si në ndërtim të banesave sociale për komunitetin në nevojë, pa përkrahje dhe të ardhura të pakta, si dhe ndaj katër personave specialist në ndërtimin e projektit “Ndërtimi i banesave sociale” .

Për gjashtëmujorin, në zbatim të rekomandimit të zotit Kryetar, të dhënë në analizën vjetore “Mbi realizimin e treguesve të vitit 2011”, janë pasqyruar në tregues dhe masat e dhëna për personat e larguar nga puna, në rastet kur gjykimi dhe vlerësimi ynë ka qenë i njëjtë me subjektin, në këto raste masa është konsideruar e ezauruar. Si të tilla për gjashtëmujorin janë evidentuar 41 raste, 3 në projektin Spitali Universitar “Nënë Tereza” Tiranë, 3 në subjektin Ujësjetllës Kanalizime Fier, 3 në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave, 3 në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve, 3 në Operatorin e Sistemit të Transmetimit, 6 në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare, 1 në subjektin Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, 16 në Autoritetin e Aviacionit civil dhe dy në Ujësjetllës Kanalizime, SHA Tiranë.

4. Është zbuluar dëmi ekonomik në vlerë 2,695,042 mijë lekë, i cili është rekomanduar për t'u zhdëmtuar totalisht në gjashtë subjekte, në sektorin e tatim taksave është konstatuar dëmi ekonomik në vlerë 13,597 mijë/lekë, në fushën e pagave vlera 3,573 mijë/lekë, në fushën e shpërblimeve vlera 5,002 mijë/lekë, në shpenzimet operative vlera 58,786 mijë/lekë, në fushën e prokurimeve publike vlera 1,547 mijë/lekë si dhe në zërin të tjera vlera 2,612,537 mijë lekë, Dëmi ekonomik i konstatuar dhe rekomanduar për zhdëmtim në 12 subjekte nga 16 gjithsej të audituar është si më poshtë:

- Korporata Elektroenergjetike shqiptare, dëm ekonomik në vlerën 2,505,853 mijë/lekë
- Autoriteti i Aviacionit Civil, dëm ekonomik në vlerën 65,378 mijë/lekë;
- Projekti rruga Shkodër Hani i Hotit, dëm ekonomik në vlerën 30,041 mijë/lekë;
- Në proj.Spitali Universitar “Nënë Tereza”, dëm ekonomik në vlerën 9,921 mijë/lekë;
- Në proj. “Ndërtimi i Banesave sociale”, dëm ekonomik në vlerën 8,554 mijë/lekë
- Operatori i Sistemit të Transmetimit, dëm ekonomik në vlerën 7,687 mijë/lekë
- Ujësjetllës kanalizime Sh.a. Tiranë, dëm ekonomik në vlerën 4,865 mijë/lekë.
- Agjencia e Mjedisit dhe pyjeve, dëm ekonomik në vlerën 2.063 mijë/lekë;
- Ujësjetllës Kanalizime Fier, dëm ekonomik në vlerën 2,018 mijë/lekë;
- DPH, dëm ekonomik në vlerën 1,547 mijë/lekë
- Certifikimi i Llogarive, dëm ekonomik në vlerën 1,331 mijë/lekë;
- Drejtoria e Shërbimit Pyjor Durrës, dëm ekonomik në vlerën 1,068 mijë/lekë;

Duhet theksuar se në veprimtarinë audituese, zbulimi dhe nxjerrja e përgjegjësisë për dëmet materiale dhe financiare të shkaktuara subjekteve, nuk kanë qene dhe nuk kanë përbërë një qëllim a synim në vetvete, por si pjesë e rëndësishme e mirëmenaxhimit të aseteve publike.

5. Kallzime Penale. Për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2012, departamenti ynë ka konstatuar **katër raste për konsumimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, me efekte financiare, dëm ekonomik në vlerën 296,106 mijë lekë, për të cilat është bërë kallzim për ndjekje penale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor përkatës.**

Konkretisht: - Porti Detar Vlore, kallzim penal për 1 person, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, për dëmin e shkaktuar në shumën 187,931 mijë lekë;

- Operatori i Sistemit të Transmetimit, kallzim penal për 1 person, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, për dëmin e shkaktuar 45,490 mijë lekë

- Autoriteti i aviacionit Civil dy kallzime penale: - 1 person, për shpërdorim detyre dhe shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera, apo ankande publike, neni 248 dhe 258 i kodit penal, për dëmin e shkaktuar 62,685 mijë lekë dhe - 1 person, për shpërdorim detyre dhe ndërhyrje në transmetimet kompjuterike, neni 248 dhe 192/b të kodit penal, për të cilët vazhdon procedimi penal.

- Realizimi i rekomandimeve. Për këtë 6-mujor kanë kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor, të përcaktuar në dokumentet standarte të KLSH, mbi realizimin e rekomandimeve të dhëna nëntë subjekte. Nga subjektet e evaduar në tremujorin e parë nuk kanë kthyer përgjigje subjektet Ujësjetllës-kanalizime Fier si dhe Projekti “Ndërtimi i banesave sociale”. Tre subjekte të cilat janë evaduar në muajin Qershor 2012, nuk është plotësuar afati kohor i përcaktuar në dokumentet standarte të KLSH. Mbështetur në kthimet e përgjigjeve të tetë subjekteve rezultojnë si më poshtë: - Masa organizative nga 135, janë në proces për realizim 122, ose 90% e tyre; - Masa disiplinore nga 113, janë realizuar 71, ose 63%; - Dëmi ekonomik me vlerë 2,695,042 mijë/lekë, për të cilin sipas përgjigjeve të ardhura, subjektet kanë filluar procedurat për ndalimin e 2,668,092 mijë lekë, ose 99%.

Krahasuar me treguesit e të njëjtës periudhë të vitit të kaluar departamenti ynë ka rritje pothuajse në të gjithë treguesit, konkretisht:

- Në këtë periudhë janë konstatuar katër raste për konsumimin e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, me efekte financiare kur në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi konstatuar një rast, pra 3 raste më shumë;
- Kemi rekomanduar marrjen e 172 masa disiplinore nga të cilat 60, në kompetencë të Agjencisë së Prokurimit Publik, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi rekomanduar 72 masa disiplinore, pra +100 masa;
- Kemi rekomanduar gjashtë raste për përmirësime ligjore, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2011, kemi rekomanduar 5 raste (1 më shumë);
- Kemi rekomanduar 247 masa me karakter organizativ, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi rekomanduar 215, pra 32 masa më shumë;
- Lidhur me dëmin ekonomik të zbuluar, pavarësisht se në 6-mujorin e parë të vitit 2011 ishte në vlerën 6,060,773 mijë lekë, ndërsa për të njëjtën periudhë këtë vit është 2,695,042 lekë, pra 3,365,731 mijë lekë më pak, nuk duhet parë si ulje e forcës zbuluese të veprimtarisë audituese, për tre arsye kryesore: së pari, vetë thellimi dhe zgjerimi i masave të mësipërme të rekomanduara (përfshirë dhe kallëzimet penale) tregon për rritje të përgjegjshmërisë së punës së secilit auditues; së dyti, në praktikë raportuese të viteve të kaluara ka pasur raportime të zbulimeve progresive në vite për të njëjtin subjekt, dhe së fundi, në 6-mujorin e parë të vitit 2011 kanë qenë përfshirë në zbulime dy subjekte të rëndësishme dhe me aktivitet të gjerë ekonomik-financiar (Albpetroli dhe OST), nga të cilët njëri është në fazë projektraporti, dhe premiset janë se dëmi ekonomik i zbuluar dhe i rekomanduar për zhdëmtim, do të jetë sigurisht në nivele më të larta, duke mos qenë një qëllim në vetvete, por një masë efikase në luftën kundër korrupsionit.

Nisur nga niveli i gjetjeve dhe rekomandimeve cilësohen auditime të spikatura në subjektet: Operatori i Sistemit të Transmetimit, për projektin “Ndërtimi i linjës 400 kv Tiranë –Podgoricë”; Autoriteti Rrugor Shqiptar, për projektin “Ndërtimi i rrugës Shkodër Hani i Hotit”; Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, Tiranë; Autoriteti i Aviacionit Civil, Tiranë; Ujësjellës kanalizime Sh.a. Tiranë; Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, Tiranë etj. Duhet vënë në dukje se, gjerësia e thellësia e zbulimeve varen, krahas të tjerave dhe nga madhësia e aktivitetit ekonomik-financiar të subjektit të audituar.

Në mënyrë të përmbledhur, problematika e evidentuar sipas fushave të auditimit të subjekteve rezulton si më poshtë:

a) - Në projektet me financime të huaja:

-Njësia e Menaxhimit të Projektit “Menaxhimi i integruar i ujerave dhe ekosistemit” nuk ka marrë masat e nevojshme, që me përfundimin zyrtar të projektit të bëjë kalimin në pronësi të bashkive respektive të aseteve, për të siguruar administrimin dhe mirëmbajtjen e tyre;

- Ministria e Shëndetësisë gjatë zbatimit të projektit Spitali Universitar “Nënë Tereza” Tiranë, nuk ka analizuar efektivitetin e dërgimeve me shërbim jashtë vendit, për seminare apo vizita studimore; ka marrë vendime në kundërshtim me marrëveshjen e kredisë të ratifikuar, duke shkaktuar një efekt negativ financiar dhe rënduar koston e projektit

- Në projektin “Ndërtimi i Banesave sociale”, edhe pse objektet për strehim janë përfunduar dhe marrë në ruajtje nga bashkitë përfituese të projektit, Njësia e Koordinimit të Projektit, Njësitë e Zbatimit të Projektit (PIU) dhe Bashkitë nuk kanë miratuar në Këshillat Bashkiak procedurën për miratimin dhe zbatimin e fazës së dytë të projektit, sigurimin e strehimit për personat në nevojë me të ardhura të ulëta, të varfrit, viktimat e dhunës, personat me aftësi të kufizuar dhe jetimët që nuk kanë akses në tregun formal të strehimit, sipas objektivave të parashikuar në Marrëveshjen e Financimit;

- Në projektin “Ndërtimi i linjës 400 kv Tiranë-Podgoricë” u konstatua tejzgjatje të paparashikuara të afateve të implementimit të projektit, shoqëruar me penalitete për mos disbursim në kohë të huasë në shumën 348,935 Euro; Tejzgjatje të fazave të tenderimit deri në lidhjen e kontratave për punimet civile, probleme me shpronësimet, studimi jo i saktë i projektimit dhe devijime të linjës gjatë zbatimit kanë çuar në ndryshime të kontratës bazë të ndërtimit shoqëruar me kosto shtesë në vlerën 602,279 Euro, financuar me vetë fondet e OST; Pasaktësi në dokumentet e tenderimit si për procedurë, për “shërbimin e konsulencës” dhe për “Ndërtimin e linjës 400 kv Tiranë-Podgoricë”; nga auditimi i praktikave të disbursimeve për mallrat, procedurat doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar është konstatuar se midis shumave të likuiduara nëpërmjet kërkesave për disbursim dhe vlerës reale të mallrave, referuar deklaratave doganore ka diferenca në shumën 185,000 Euro; OST ka vazhduar deklarin e saj në bazë të deklarimit doganor dhe jo sipas faturës së disbursimit, ku shuma e papaguar për këto mallra në vlerë është më e madhe se vlera reale e mallit të zhdoganuar dhe Tvsh-së së paguar për pasojë është shkaktuar evazion fiskal në vlerën 4,772,784 lekë; u konstatuan shkelje të punimeve civile të shoqëruara me dëm ekonomik në vlerën 41,520 euro, shkelje në procedurat e blerjes së dy makinave, njëra prej të cilave e konstatuar si blerje fiktive në vlerën 35,760 euro.

b) Shoqëritë publike:

- Në Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare: Mangësi në Rregulloren e Brendshme; mungesa të analizave dhe vlerësime të hollësishme tekniko-ekonomiko-financiare; nuk janë regjistruar në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme objektet që janë regjistruar në zërin kadastral “toka” dhe “ndërtesa”; gjendje e lartë të inventarëve në vlerën 2,857,509 mijë lekë; nivel i lartë i shpenzimeve për gjoba dhe penalitete; mangësi në ndjekjen dhe zvogëlimin e debitorëve; mungesa e analizave për detyrimet e KESH SHA ndaj bankave të nivelit të dytë në lidhje me kreditë, të cilat për vitin 2010, janë në vlerën 52,060,300 mijë lekë, dhe për vitin 2011 në vlerën 68,962,952 mijë lekë; mungesë e analizave e studimeve shkencore, në lidhje me programimin e kërkesës për energji elektrike për vitet në vazhdim; ka emëruar në detyrën e Administratorit të Shoqërisë të TEC-Vlorë, një person të kallëzuar penalisht nga KLSH, pasi gjatë veprimtarisë së tij drejtuese janë konstatuar një sërë shkeljesh të administrimit të shoqëruara me dëme ekonomike, duke konsumuar elementë të veprës penale “shpërdorim i detyrës” etj.

- Në Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhave: mangësi në dokumente kryesore të veprimtarisë (statut, rregullore të brendshme, urdhra të brendshëm); mangësi në programimin treguesve; vonesa në përpunimin e vagonëve të huaj; mangësi në alokimin e ndihmës shtetërore; nivel i lartë i gjobave dhe mungesë analize nga organet drejtuese; mungesë arkëtimi të detyrimeve për sigurimet sociale; detyrim në organet tatimore për arkëtimet nga qiraja etj.

- Në Ujësjellës Kanalizime Sh.a. Fier: Mos funksionim i asamblesë së aksionarëve në drejtimin e shoqërisë sipas përcaktimeve në statusin e shoqërisë, mangësi të theksuara nga këshilli mbikëqyrës në drejtimin, organizimin e shoqërisë, mosfunksionim i strukturës së auditit të brëndshëm e programit të masave për uljen e humbjeve në rrjet (aktualisht janë mbi 68 %), duke e shoqëruar, krahas alternatives së rritjes së çmimit të ujit në nivele dhe ritme më të ulta se rritja e koston dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, me rritjen e efektivitetit të shpenzimeve të fuqisë punëtore dhe atyre administrative;

c) Në fushën e mjedisit:

- Në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Durrës: U Konstatua spontanitet në realizimin faktik të buxhetit; mos hartim i planit të menaxhimit të parkut natyror “Rrushkull”; mangësi të theksuara në hartimin e planeve për shtimin e sipërfaqeve pyjore; mangësi në procedurën e organizimit të ankandit shitës si dhe procedurën e prokurimit; mos ndjekje e të gjitha shkallëve të gjykimit për

vjeljen e gjobave të vendosura subjekteve dhe individëve të cilët kanë shkaktuar dëme në fondin pyjor dhe kundravajtje administrative etj.

- Në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave: -Mungesë rregullore e re e funksionimit të “Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për lejet mjedisore dhe lejet e peshkimit”; nuk janë marrë masa për programimin dhe implementimin e rezultateve dhe rekomandimeve të monitorimeve të dërguara nga institucionet përkatëse; mungesë bashkëpunimi me strukturat e Pushtetit Vendor dhe me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore etj.

- Në Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve: Mangësi në hartimin e rregullores e brendshme; programi kombëtar vjetor i monitorimit të mjedisit është miratuar me vonesë; nuk është ngritur rrjeti kombëtar i monitorimit; mungesë e standardeve mbi përdorimin e teknologjive të pastra si dhe futjen e sistemeve të administrimit mjedisor; parregullsi në pagesat për kontratat e lidhura; shpërdorime të fondeve të buxhetit, në pagesat për telefoninë celulare, për shpenzimet e kryera për blerjet me vlera të vogla, tejkalim i kompetencave dhe shpërdorim i detyrës në urdhërim për pagesave të kundraligjshme.

- Në bashkinë Lezhë (Auditim Performance): shërbimit i pastrimit të qytetit nuk monitorohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi; nuk ka hartuar dhe miratuar Rregulloren për administrimin mjedisor të mbetjeve urbane si dhe të mbetjeve të tjera të ngurta; nuk ka gjetur zbatim Strategjia e miratuar për ngritjen e një sistemi për grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave spitalore; nuk ka përcaktuar vend-depozitimin përfundimtar të mbetjeve speciale dhe atyre të rrezikshme; nuk ka kryer studime afatshkurtër apo afatgjatë për shtimin dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbërta urbane etj.

Një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë audituese është dhe **respektimi i afateve kohore të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të KLSH**, faktor që është mbajtur në konsideratë nga secili auditues, në të gjitha hapat e procedurës së auditimit.

Që nga fillimi i këtij viti, **një vëmendje e veçantë i është kushtuar cilësisë, si pjesë integrale e procesit të auditimit**. Megjithëse jemi përpjekur për monitorimin e cilësisë së raporteve përpara finalizimit të tyre, jemi të ndërgjegjshëm, se mbetet ende shumë për të bërë në drejtim të rritjes së cilësisë audituese.

Është e rëndësishme të vë në dukje, se aktivitetit auditues të këtij 6-mujori, i ka paraprirë angazhimi i audituesve me përvojë në ndihmesën dhe kontributin e tyre për ndryshimin dhe përmirësimin e Rregullores së Brendshme, e cila u kurorëzua me miratimin e saj, me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 53, datë 16.04.2012.

Gjithashtu, për këtë gjashtëmujor që po analizojmë, **Departamenti ynë ka marrë pjesë në gjashtë procese gjyqësore, nga të cilat tre kanë përfunduar, dy janë në proces dhe një është mbyllur**, dhe konkretisht:

I. Çështje të përfunduara:

- Shoqëria italiane “Ingenieria&Servizi” S.r.l. Në kontrollin e ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë, në projektin “Ndërtimi dhe rehabilitimi i pesë poliklinikave”, viti 2009, Ministria e Shëndetësisë ka hapur çështje civile në ngarkim të palëve përfituese, shoqëria italiane “Ingenieria&Servizi” S.r.l., në të cilën kërkohet shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë 4,531 euro e përfituar padrejtësisht për mos derdhjen e tatimit mbi të ardhurat e përfituara në Shqipëri. Në seancën gjyqësore u komunikua pushimin e çështjes, pasi pala paditëse Ministria e Shëndetësisë nuk mori pjesë.

- Shfuqizim Vendimi. Në lidhje me çështjen civile me paditës, Skender Shkoza dhe me palë të paditur KLSH, me objekt padie “Shfuqizim Vendimi” informojmë se: Në bazë të nenit 154 të

“Kodit i Procedurës Civile” u mor vendimi për “Kthim Aktesh” për faktin se, avokati mbrojtës i palës paditëse nuk paraqiti prova shkresore për të provuar kërkesë padinë. Nga ana jonë u paraqiten provat shkresore: Shkresa nr. 732/23, datë 16.06.2008 me lëndë: “Dërgohet Rekomandime” për AKKP Tiranë” si dhe shkresa nr. 732/25, datë 04.07.2008 me lëndë: “Dërgohet Raporti përfundimtarë i Kontrollit dhe Rekomandimet” për ZVRPP Tiranë, të cilat vërtetuan se, KLSH-ja në mbështetje të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997, ”Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i ndryshuar, është një institucion rekomandues dhe jo organ vendimmarrës.

- Korporata Elektroenergjetike Shqiptare: Objekti: Detyrim për pagimin e shumës 2,000,000 lekë, të përcaktuar si dëm ekonomik në rekomandimet e lënë nga KLSH, në kontrollin e ushtruar në KESH, SHA .

Palë e paditur Shoqata “Olimpiku Special, Shqiptar”. Pas zhvillimit të gjashtë seancave gjyqësore, trupi gjykues vendosi: Në mbështetje të nenit 6, të kontratës së lidhur midis palëve, i padituri të paguajë shumën 2,000,000 lekë në favor të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, nga të cilat 1,000,000 lekë, të sponsorizuara nga KESH, SHA dhe 1,000,000 lekë kamat vonesa.

II. Janë në vazhdim proceset gjyqësore për çështjet civile:

- “ESI Energia & Servizi Italia”. Ministria e Shëndetësisë ka hapur çështje civile në ngarkim të palës përfituese firma “ESI Energia & Servizi Italia” s.p.a, për dëmin ekonomik me vlerë 14,094 euro, të përfituar padrejtësisht nga pala e paditur. Është zhvilluar seanca e parë më datë 14.05.2012, ku u dhanë shpjegimet e lidhur me kontrollin e bërë nga ana jonë. Seanca gjyqësore u shty për datën 19.06.2012, pasi pala paditëse nuk pati plotësuar kërkesën e mëparshme të gjyqtarës për të dorëzuar aktin e kolaudimit të objektit.

- Helvetika Profarma. Në kontrollin e ushtruar në Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, në vitin 2008, është rekomanduar t’i kërkohe në rrugë ligjore operatorit ekonomik “Helvetika Profarma” Tiranë, arkëtimin e demit në vlerën 8.831.822 lekë, pasi furnizuesi nuk ka zbatuar detyrimet kontraktuale dhe për të cilën duhet të paguaj dëmet për lëvrim të vonuar të mallrave të llogaritura me tarifën 4/1000 e çmimit total të kontratës të përcaktuar në nenin 3 pika 8 e kontratës, dhe për mosrealizim të kontratës, sigurimin e saj në masën 10% të vlerës, sipas Kushteve të përgjithshme të Kontratës (Mallra), nenet 24 “Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar” dhe 32 “Sigurimi i Kontratës”, pika 32.2. Gjyqi është në fazën e caktimit të ekspertëve, të cilët do të merren me saktësimin e vlerës së demit.

III. Çështje e mbyllur: Paditës: Ministria e Shëndetësisë, të paditur: Shoqëria DEC s.p.a”

kthim shume të përfituar në mënyrë të padrejtë 25,280 euro. KLSH në këtë gjyq nuk ka marrë njoftim për tu përfaqësuar si palë e tretë. Në apel nuk mund ta hapim ne çështjen, pasi nuk jemi palë e paditur dhe as paditës.

Gjatë kësaj periudhe, **pjesë e veprimtarisë së këtij departamenti kanë qenë dhe shqyrtimi me seriozitet dhe në afatin e caktuar të kërkesë-ankesave të qytetarëve të ndryshëm.** Për këtë gjashtëmujor, në Departamentin tonë kanë ardhur për kthim përgjigje 13 ankesa, kryesisht për auditim në subjekte shoqëri publike si SHA ujësjellës, Albpetrol SHA, SHA Qendra e trajtimit të studentëve nr. 1, dhe nr. 2 etj.

- 6 kërkesë-ankesa për administrim financiar dhe prokurime, nga të cilat, pas verifikimit ka rezultuar një e drejtë dhe në pesë subjekte të tjera vazhdon verifikimi;

- 1 në privatizim dhe administrim prone, e cila është konstatuar si jashtë kompetencave të KLSH;

- Të tjera 6 nga të cilat ka rezultuar një e drejtë, për një vazhdon verifikimi, 4 kanë rezultuar jashtë kompetencave, nga të cilat dy ankesa anonime.

Falë iniciativës dhe përkushtimit të zotit Kryetar, audituesit e Departamentit janë trajnuar dhe po trajnohen brenda dhe jashtë vendit, nga organizata, institucione dhe ekspertë të fushës së auditimit. Në këtë mënyrë po realizohet gradualisht një nga synimet zotit kryetar për ndërtimin i kapaciteteve, si nje nga 4 prioritetet e planit strategjik 2011-2017 të Eurosait.

Kemi marrë pjesë në trajnimet e kryera nga: *- Instituti Trajnimit të Administratës Publike*, në temat: Menaxhimi i sistemit të Planifikimit të Integruar, Etika dhe antikorrupsioni, Menaxhimi i financave publike cikli i PBA dhe prokurimi, Menaxhimi i Kontratave”, Hartimi i shkresave dhe komunikimi, Monitorimi i projekteve të financuara nga BE, Prokurimi dhe kontraktimi sipas procedurave të BE-së, Masat disiplinore dhe procedurat e ankesave, Përgatitja e termave të referencës për projektet të BE-së, mbi investimet e huaja, organizuar nga Banka Botërore

- Trajnime të kryera nga specialistë të KLSH, Programi IDEA, Standardet e Auditimit dhe Planifikimi, Auditimi i Brendshëm, Materialitetit dhe risku, Auditimi i performancës, Auditimi financiar, Përmbushja e kritereve të cilësisë në procedurat audituese, Investimet dhe projektet me financime të huaja.

- Njëkohësisht, një pjesë e adituesve ka marrë pjesë në trajnime të zhvilluara mbi performancën në Slloveni dhe Poloni.

Të nderuar pjesëmarrës,

Ne vijmë në këtë analizë, pas shqyrtimit të problematikave javore të veprimtarisë audituese në nivel grupi dhe subjekti, me synim rritjen e cilësisë, duke thëlluar masat e rekomanduara dhe në të njëjtën kohë për të kërkuar rritjen e nivelit të zbatimit të tyre nga entet e audituara.

Krahas kësaj, gjykojmë se nuk kemi arritur akoma në nivelin e kërkuar për auditimet e performancës. Ne mendojmë se trajnimet në këtë drejtim, pa larguar vëmendjen në vazhden e punës për përmirësimin e cilësisë në llojet e tjera të auditimit, do të jenë një bazë e shëndoshë për ta realizuar me cilësi gjatë gjashtëmuajorit të dytë të këtij viti.

Do të dëshiroja të shtoja dhe një gjë: vetë risia e kësaj forme të analizës do të shërbejë për ne të gjithë, pasi siç është vendosur postulati në flamurin e INTOSAI- Nga shkëmbimi i përvojave përfitojnë të gjithë.

Së fundi, duke analizuar me përgjegjësi arritjet e kësaj periudhe, për Departamentin e Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit, **mbeten sfida për të ardhmen e veprimtarisë tonë:**

- 1. Njohja dhe zbatimi me korrektesë i standardeve të reja të raportimit të auditimit dhe të gjithë procesit të auditimit në përgjithësi.**
- 2. Thëllimi i misionit në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet thëllimit dhe zgjerimit të masave të rekomanduara kryesisht atyre disiplinore dhe administrative, pa larguar vëmendjen nga përmirësimet ligjore, organizative dhe masat për shpërblimin e dëmit.**
- 3. Kthimi i vëmendjes në auditimet e performancës, si një nga prioritetet e vizionit të ri të zotit kryetar, duke i shërbyer paraprakisht me kualifikimet dhe trajnimet e audituesve brenda dhe jashtë vendit.**
- 4. Krijimi i mekanizmave efektivë në zbatimin e rekomandimeve subjekteve të audituara, nisur që nga rezultatet e auditimeve dhe deri në argumentimin ligjor të të dhënies tyre.**
- 5. Thëllimi akoma më tej në analizën e rrishtit gjatë auditimeve, me qëllim arritjen e rezultateve me përdorimin efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare të KLSH.**

6. Motoja e veprimtarisë sonë në të ardhmen do të jetë: “Një filozofi pune që konsideron se kontrolli nuk është një qëllim në vetevete, por në radhë të parë një instrument parandalimi ndaj korrupsionit dhe abuzimit me pronën shtetërore, një instrument korigjimi dhe këshillimi të institucionit që kontrollohet” (Nga fjala e z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH, paraqitur pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit më 14 dhjetor 2011).

Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Shtetërore

Analiza e veprimtarisë së 6-mujorit të parë 2012

Z. Pëllumb Beqiraj
Drejtor Departamenti

I. Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Shtetërore për 6-mujorin e parë 2012, ka realizuar 48 auditime nga 28 auditime të planifikuara.

Nuk kemi realizuar auditimin e Bashkisë Tiranë dhe Durrës, por kemi realizuar 3 auditime të pa planifikuara Komuna Karinë (Peqin), ALUIZNI Rajonal Vlorë dhe Komuna Qukës Librazhd dhe kemi në proces auditimi AKKP Tiranë.

Në proces evadimi 12 subjekte: ZVRPP Lushnjë (evadim RP dhe Projektvendim), ZVRPP Fier, Bashkia Librazhd, Burrel, Pukë, Krujë, Klos, Gramsh, Orikum, Korçë, Himarë.

II. Nga auditimet e evaduara kanë rezultuar **278,543 mijë lekë** shkelje të ligjshmërisë me efekte financiare.

III. Analizë:

1. Mbi metodën e punës.

Qëllimi i gjithë drejtimeve të Projektideve të Kryetarit të KLSH-së, po të ishin kuptuar dhe zbatuar me rigorozitet, do të shërbenin më shumë për planin e strategjisë sonë si Departament me plane veprimi ditore, mujore, vjetore e disa vjeçare.

Porositë e vazhdueshme të Kryetarit për ndryshimin e metodës së punës kanë patur si qëllim që këto Projektide të na shoqërojnë për çdo moment, në mënyrë që Departamenti jonë të ketë një zhvillim të qëndrueshëm e në rritje, i cili **të kthehet në një realitet të prekshëm, në preokupim të vazhdueshëm, në një proces organik.**

Shtroj pyetjen: Që nga unë si drejtor a i kam të gjitha aftësitë e duhura drejtuese, teknike, organizative, për të drejtuar këtë departament. Me vërejtjet dhe kritikën e bëra nga Drejtore e Përgjithshme dhe Kryetari i KLSH-së në adresën time dhe reflektimi ka qenë i dobët, jo korent, jo i prekshëm, jo shumë i ndjeshëm dhe rezultativ në kapjen e problemeve kryesore.

Përgjigja 1: Mendoj se i kam të gjitha aftësitë profesionale e tekniko organizative për faktin se kam dalë nga gjiri i kontrollorëve. Me shumë kontrollorë nga ju kam punuar edhe në grupe pune dhe i dimë aftësitë profesionale të njëri tjetrit.

Në drejtim të organizimit të punës, komunikimit dhe bashkëpunimit me përgjegjësit e grupeve angazhohem se do të gjej të gjitha solucionet për koordinimin, bashkëpunimin ndarjen e detyrave dhe raportimit reciprok të detyrave që shtrohen për zgjidhje, do të mobilizohem dhe do të rrisë ndjenjën e përgjegjësisë më shumë për të gjetur metodën e duhur dhe forcën zgjedhëse në mënyrë që ti përgjigjem kërkesave që shtrojnë për zgjidhje me cilësi dhe kohën e duhur si nga Drejtori i Përgjithshëm dhe nga Kryetari i KLSH-së, duke mos u bërë pengesë në ecurinë dhe mbarëvajtjen e punës së Institucionit.

Të njëjtën pyetje e shtroj edhe për secilin kontrollor. A është i aftë me këtë nivel dijesh dhe më këtë mobilizim dhe përkushtim të përballojë detyrat e kohës ? **Përgjigjen e kërkoj nga çdo diskutues ?**

Përgjigja 2: Mendoj se kolektivi jonë është i aftë për rezultate, për veprime të motivuara, por duhet të vendosim objektiva konkrete dhe të përpiqemi me të gjitha energjitë për ti realizuar. Fakti që porositë e Kryetarit që nga unë si drejtor e deri tek kontrollorët po i zbatojmë me vështirësi tregon se modeli ynë i drejtimit, organizimit që kërkohet për kalimin nga modeli i vjetër zhvillimi që nuk funksionon më në modelin e zhvillimit të qëndrueshëm, po ecën me ritme të ulëta. Fakti është se kemi bërë disa përmirësime modeste të cilat në asnjë mënyrë nuk mjaftojnë dhe nuk justifikojnë qëndrimin tonë në këtë institucion. Nuk na mungon njohja e problemeve, përkundrazi i njohim shumë mirë ato.

Kemi hartuar disa programe në formë paketash dhe panelesh por duhet të ndërtojmë një mobilizim real mbi gjendjen konkrete dhe jo mbi një **mashttrim**. Duhet të përballemi me të vërtetën prej momentit kur çështjet shtrohen për tu zgjidhur dhe kjo gjendje me këtë metodë drejtimi dhe organizimi **nuk** mund të funksionojë më.

2. Duhet të përballemi në mënyrë kritike dhe autokritike me gjendjen reale me të vërtetën, po nuk bëjmë këtë kemi gënjyer veten, e kjo do të jetë e pafalshme si për mua dhe për çdo auditues.

3. Zbatimi i Dokumenteve Standarde të KLSH-së.

Të metat e vërejtura gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti në zbatim të Dokumenteve Standarde të KLSH-së, tregon për punë të pakujdesshme dhe të papërgjegjshme nga ana e jonë.

Akoma nuk janë studiuar dhe kuptuar për një zbatim sa më të drejtë të tyre, fakt ky që tregon nivel të ulët në disa auditues, mungesë bashkëpunimi në grup, ka patur mungesë kontrolli ndaj njëri tjetrit dhe për pasojë jemi ndodhur shpesh në momente të vështira në përballjen e dokumentacionit evadues me Drejtoreshën e Përgjithshme dhe Kryetarin.

Fakti i evadimit të **10** auditimeve në javën e fundit të muajit qershor na gjeti të papërgatitur në drejtim të zbatimit me rigorozitet të Standardeve të Reja të Auditimit.

Kjo erdhi edhe nga shkaku se nga grupet e auditimit gjatë procesit auditues nuk punohet njëkohësisht edhe për përgatitjen e Projektraport Auditimit dhe njëkohësisht mbas dërgimit të tij në subjekt nuk punohet për përgatitjen e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Vlen të theksohet se kemi krijuar një barrë të rëndë pune ndaj Drejtoreshës së Përgjithshme e cila rast pas rasti është kthyer e diktuar nga dobësitë tona në një korrektuese, korrigjuese dhe për më tepër nuk i kemi lenë kohë për të realizuar detyrat e saja të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme.

Në këtë drejtim ka munguar hartimi i plan zbatimit të masave konkrete për korrigjimin e punës tonë nga ana drejtuese, organizuese, kontrolluese dhe ndëshkuese.

Pyetje për diskutim? Për çfarë arsye nuk zbatohen Dokumentet Standarde të KLSH-së nga ana e jonë. Nuk kuptohen, neglizhohet, ka punë të papërgjegjshme apo ka **paaftësi** nga ana e audituesve në zbatimin e tyre. Në këtë drejtim unë mendoj se ka **paaftësi** dhe **papërgjegjshmëri**, e cila po na shoqëron nga muaji në muaj, nga njëri auditim tek tjetri.

4. Zbatimi i afateve të kryerjes së auditimeve, pasi mosrespektimi i tyre gjatë kryerjes së auditimeve sipas programeve të miratuara dhe çdo ndryshim i tyre duhet të bëhet me miratim të Kryetarit, pasi është detyrim ligjor dhe institucional i përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të KLSH-së.

Në periudhën që analizojmë për 23 dosjet e evaduara të vitit të kaluar ka patur shkelje të rënda të afateve, por kjo ka një domethënie dhe gjithë koha e humbur gjatë muajit janar dhe shkurt në drejtim të evadimit të materialeve të vitit të kaluar, detyrimisht duhet të kursehej në periudhën pasardhëse.

A e shpjegojmë dot pamjen e kontabilitetit të kohës së punës, shpenzimeve dhe produktin e punës tonë këtë 6-mujor. Kërkimi i një barasvlere të investimeve të kohës së punës dhe mjeteve monetare që shpenzon shteti ynë për të na mbajtur me produktin dhe vlerën e shtuar që ne japim. Nga analiza e punës dhe ballafaqimi me rezultatet në raport me kohën e punës këtë 6-mujor **ne rezultojnë me humbje** në drejtim të kohës së punës me produktivitetin e dhënë, kohë e cila domosdoshmërisht duhet zëvendësuar për periudhën pasardhëse duke gjetur rrugët e shkurtimit të afateve të kontrolleve dhe rritjen e intensitetit, cilësinë etj. Rrugët dihen: shkurtimi i kohës së punës gjatë procesit të kontrollit. Dorëzimi i aktverifikimeve dhe procesverbaleve jo ditët e fundit, fenomen ky i vërejtur dhe gjatë kontrolleve të këtij tremujori.

Pse ndodh kjo? Ka akoma dembelizëm dhe paaftësi nga kontrollorët.

Përgjegjësia më e madhe në këtë drejtim është e Drejtorit të Departamentit.

Fakt tjetër dhe bindës është se në materialet e evaduara ka patur shumë observacione nga subjektet e audituara, logjikisht dhe praktikisht tregon se gjatë procesit kontrollues nga grupet e auditimit nuk janë kryer ballafaqime.

Më të theksuara këto probleme kanë rezultuar në ZVRPP Durrës, Sarandë etj.

Parlamenti dhe Këshilli i Ministrave ka nxjerrë shumë ligje dhe akte nënligjore për menaxhimin financiar, riskun, performancën e studimit të tij, amplitudat, llojet e risqeve por risku më i madh është **paaftësia e kontrollorëve.**

Menaxhimi racional kërkon që burimet njerëzore të vlerësohen në mënyrë të atillë që në auditim krahas numrit të përshtatshëm të caktohet dhe stafi më aftësitë e duhura.

5. Kuptimi i rëndësisë së drejtuesit dhe vartësit.

Të jem i sinqertë me ju, përditë mendoj dhe po më mendojnë në vetvete shumë pyetje, të cilave jam munduar tu jap përgjigje por që edhe kërkoj mendimin dhe propozimet tuaja që gabimet dhe fajet që janë shfaqur këto 6-muj të mos përsëriten më dhe në mënyrë të sinqertë po ju shprehen edhe njëherë që kritika dhe autokritika e sinqertë dhe pa tendencë do të jetë një nga drejtimet kryesore të punës time.

6. Zgjidhja e problemeve gjatë procesit auditues në subjekte apo institucione të tjera.

Kjo bëhet me dhënin e informacioneve javore, të cilat me gjithë porosinë e vazhdueshme nuk janë kryer nga përgjegjësit e grupeve. Nuk e kuptoj për çfarë arsye përgjegjësit e grupeve nuk japin informacionet javore.

Shtroj pyetjen ? A ka kundërvënie ? ka dembelizëm ? ka neglizhencë ? Apo përgjegjësit e grupeve nuk duhet të pasqyrojnë çdo javë punën e dobët audituese të grupit për arsye se letrat i përpunojnë vetëm dy javët e fundit?

Është e domosdoshme që gjatë procesit auditues të jepen informacione javore me problemet e dala dhe kërkesat n.q.s. ka për zgjidhje.

Gjatë këtij 6-mujori ne kemi organizuar mirë punën për zgjidhjen e ankesave të dërguara nga individët me grupet e auditimit nëpër subjekte. **Por a mjafton kjo ?** Në asnjë mënyrë. Duhet të përmirësojmë drejtimin dhe organizimin e punës që nga unë si **drejtor** e deri tek çdo grup auditimi. Në disa raste grupet e punës nuk e parashikojnë në kohë nevojën për ing. Kryerja e 11

auditimeve nga Xhemal Luka dhe në 3 auditimeve nga ing. Mina Blushi tregon se në këtë Departament ka patur mjaft nevojë për këtë profesion.

Zgjidhja që u bë muajin e fundit me fillimin e punës nga 2 ing. tregon se u mbështet ky Departamenti me audit në këtë profesion.

2. Një shkak frenues është edhe kategoria e pagave, që ka influencuar negativisht në rritjen e ambicies dhe nivelit të kualifikimit.

3. Një shkak frenues është e pandëshkushmëria.

Tani që jam vetë në funksion drejtuesi sinqerisht të më kuptoni se sa të vështirë e kam kur vendos të ndëshkojë dikë, duke qenë i bindur se ai e meriton, dhe masa disiplinore që duhet të jap e kuptoj me ndërgjegje që duhet dhënë për të korrigjuar të metat e tija.

4. Analizë dhe përgjegjësi për të ardhmen

a. Rritja e vizionit të gjerë në zgjidhjen e problemeve

Ai që dëshiron të bëhet dhe të marrë përsipër detyrën e rëndësishme të audituesit, në stadin e tanishëm të zhvillimit të KLSH me kërkesat tepër të larta të Kryetarit të ri, është e domosdoshme të ketë njohuri dhe vizion të gjerë dhe bashkëkohor nga ana audituese dhe juridike, të funksionimit dhe mbarëvajtjes së punës të Institucionit tonë.

Është detyrë e jona, me të gjitha mundësitë që kemi, ta transformojmë e ta ndryshojmë këtë realitet, i cili me të drejtë, në nivelin që është me rritje të vogël e modeste nuk na kënaq.

Duke e parë realitetin në sy dhe me të gjithë kompleksitetin e tij, me gjithë porositë e vazhdueshme të Kryetarit, është e natyrshme të kuptojmë që kërkohet të vëmë në lëvizje të gjitha aftësitë mendore për leximin, studimin, kuptimin, zbërthimin e gjithë rregulloreve, urdhrave të miratuara nga Kryetari për të vënë në lëvizje të gjitha aftësitë mendore për konceptimin e realiteteve të reja, për të kërkuar më me ambicie ndaj vetes dhe të tjerëve, zbatimin e standardeve të reja të nivelit të lartë dhe me perspektivë më të gjatë, mobilizimin e të gjitha energjive mendore e fizike, që kapacitetet tona mendore e fizike ti vëmë në lëvizje me efektivitetin maksimal dhe më të mundshëm.

b. Identifikimi i audituesit me përkatësinë e tij në marrëdhëniet e bashkëpunimit.

Duhet të kemi besim tek njëri tjetri dhe puna në grup. Mungesa e besimit është infeksioni që sëmur bashkëpunimin dhe të ardhmen e punës në grup. Identifikimi i personit në marrëdhëniet e bashkëpunimit, ka të bëjë me bashkimin e ndërgjegjshëm në marrëveshje, mbi bazën e qëllimeve të caktuara të mëparshme, të normuara dhe të diktuar nga rregullorja e brendshme. Marrëveshja e shkruar dhe e miratuar në rregulloren e brendshme, është si një kushtetutë e palëve në grup, e cila normon dhe u jep fuqi ligjore, të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta të secilit.

c. Përgatitja psikologjike e audituesve për vetëpërgjegjësinë në kryerjen e detyrës.

Mobilizimi i potencialit mendor dhe fizik të audituesve është i njohur si faktori determinant i suksesit të çdo departamenti.

Ne do të kemi rezultate pozitive dhe tepër të dëshiruara në punë tonë, në rast se bëjmë të mundur që secili të reflektojë në bindjet e tij të brendshme dhe në rast se secili me ndjenjë përgjegjësie e

vlerëson në mënyrë kritike rezultatin e tij të punës për të gjetur mundësitë për më shumë energji, rezultate dhe perspektivë në të ardhmen. Në këtë mënyrë do të arrijmë të bashkojmë në një qëllim të vetëm të realizimit të detyrave dhe të zbatimit me përpikmëri të direktivave të Kryetarit tre kërkesat e vetëpërgjegjësive: zgjedhjen (pavarësi dhe autonomi), dëshirën (iniciativën) dhe përgjegjësi (kreativitet).

ç. Kontrolli dhe besimi, si elementë të rëndësishëm të drejtimit.

Besimi në veprimtarinë time si drejtor ka predominuar më shumë nga kontrolli, fakt që **unë kam gabuar shumë.**

Punën 5 mujore që kemi bashkë mendoj se mjafton për të krijuar besimin jo ndaj të gjithëve për punën e tyre me ndershmëri dhe korrektësi.

Për këtë periudhë unë kam dalë dhe i zhgënjyer duke patur besim të njëjtë. Kontrolli e besimi kanë vendin e tyre të veçantë të pazëvendësueshëm nga njëri tjetri, “Besimi është i mirë, ndërsa **kontrolli është më i mirë**”.

d. Vetëpërgjegjësia, pasqyrim dhe kërkesë e bindjes së brendshme tek secili.

e. Parimet e ndërgjegjësive në punë.

ë. Të shfrytëzojmë gjithë rekomandimet e dhëna nga Drejtore e Përgjithshme dhe Kryetari.

Shumë urdhra dhe udhëzime janë lëshuar nga Drejtore e Përgjithshme dhe Kryetari, për të cilat nga ana e jonë nuk janë bërë të gjitha përpjekjet për zbatimin me rigorozitet të tyre. Kohët e fundit doli dhe “doracaku” i cili përcakton drejtimit kryesore ku duhet të përqendrohemi për të përcaktuar mangësitë e institucioneve shtetërore në lidhje me dhënien e titujve të pronësisë për pronat.

Por deri tani vërehet një apati dhe konfuzion në drejtim të zbatimit të tij në praktikë.

IV. Menaxhimi i marrëdhënieve

Ne kemi në gjirin tonë kontrollorë që kanë një depozitë të lartë dijeshe në fushën e ligjshmërisë, organizimit, drejtimit. Kemi hyrë në një situatë kritike ku kërkohet më shumë nga Departamenti ynë, situatë e cila është e vështirë me sa duket për të kuptuar në diçka në shkëmbimin e metodës së punës që duhet me atë të vjetrën.

Ndryshimet janë edhe korrente dhe afatgjata dhe nuk varen vetëm nga zgjedhjet personale por edhe nga zgjedhjet e investimeve kolektive. Një vizion i përbashkët është i domosdoshëm për kolektivin tonë për të mobilizuar energjitë dhe kjo kërkon:

Së pari: Dalja nga kontradikta e detyrave që kërkohen për ti realizuar me mungesën e mobilizimit tonë.

Së dyti: Përcaktimi sa më drejtë i detyrave për çdo grup dhe atyre që vendos Kryetari.

Së treti: Duhet të shqyrtohen mundësitë institucionale, dhe juridike si Departament.

Së katërti: A nuk shohim çdo ditë një rezistencë ti kundërvihet çdo ndryshimi modest që do të vinte në diskutim realizimin e objektivave.

- Procesi i debatit kolektiv mbi organizimin dhe drejtimin në Departamentin tonë duhet të përfshijë të gjithë grupet e punës në një dialog të përbashkët ku të dëgjohen alternativa e tjetrit dhe të sillen zgjidhje të mundshme.

- Duhet të fillojmë të ndërtojmë këtë bashkëpunim në ndërtimin e modeleve që ti përshtaten situatës atë çka kërkohet.

- Në gjirin tonë kemi mjaft shembuj të mirë ku me këta shembuj mund të ndërtojmë një panel që ti përgjigjemi detyrave që shtron Kryetari i KLSH.

- Kontrollorët kam bindjen se janë gati të angazhohen n.q.s. shohin një rrugëzgjdhje në drejtim të përmirësimit të organizimit, drejtimit, shembullit personal etj.

- Në këtë periudhë ne po kalojmë një tranzicion në institucion. Ky tranzicion është problemi kryesor i ndryshimeve në drejtim. Dimë si ti ndërtojmë dy gjendjet e këtij institucioni, por më **duket se e kemi shumë problem kalimin nga njëri tek tjetri.**

- Kemi nevojë ta shohim realitetin ballë për ballë. Ky është padyshim ligji i llojit. E rëndësishme është që në institucionin tonë koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet Departamenteve dhe Drejtorive është kodifikuar nga rregulla, standarde dhe manuale, që është shumë më thjeshtë realizimi i tyre, por ato duhet të studiohen, zbërthehen, kuptuar dhe zbatuar. Përballë risqeve, duhet pasur vazhdimisht parasysh objektivat që duhet të ndjekim. Për të punuar në mënyrë kolektive duhet të dimë seç presim nga të tjerët.

V. Debatimi në grup.

Kemi trajtuar edhe në analizat e mëparshëm efektet pozitive të debatit dhe frymën e bashkëpunimit në grup.

- Debatimi çon në rritjen e shkallës së motivimit të punonjësve;

- Nxiti daljen në sipërfaqe të problemeve të "Padukshme".

- Nxiti kreativitetin dhe gjenerimin e ideve të reja;

- Morali dhe kohezioni i grupit ka tendencë që të rritet kur njerëzit trajtojnë e debatojnë bashkërisht problemet e auditimit.

- Kur madhësia e debatit është e pranueshme, performanca ka tendencë të rritet, luftohet më mirë risku.....etj.

VI. Konceptimi i proceseve

- Institucioni ynë ka një qëllim në vetvete. Çdo auditues është i pajisur me kompetencat e tij brenda institucionit i cili ndjek një qëllim të vetëm. Sjellja e individit brenda institucionit imponohet nga rregullorja e brendshme. Ky tip drejtimi përkon me një model të qëndrueshëm ku rregullarizimet kanë bërë që gjithçka të jetë e kodifikuar.

- Ne kemi punuar me trekëndëshin e vjetër dhe përse Kryetari i ri kërkon përditë zëvendësimin e trekëndëshit të vjetër me një të ri: objektivat, etika, procesi apo dispozitivi i punës. Për të punuar në mënyrë kolektive, duhet të dimë se çfarë presim nga të tjerët. **Të pasurit e një vizioni të përbashkët e lidh më shumë grupin.**

VII. Bashkëpunimi me Drejtorinë Juridike dhe Kontrollin e Cilësisë.

1. Në emër të departamentit vlen të theksohet ndihma mjaft cilësore dhe e vazhdueshme e punonjësve të Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Cilësisë, që për mendimin tim ka qenë vendimtare, në kohë dhe me mjaft cilësi në gjykimin juridik të fenomeneve në të gjitha auditimet e evaduarat për këtë tremujor. Vlen domosdoshmërisht të theksohet ndihma mjaft profesionale dhe shumë efektive e Z. Koço Sokoli i cili me aftësitë e tij ka mbuluar paaftësinë profesionale juridike të Departamentit tonë. Sinqerisht e falënderoj shumë këtë person dhe për mendimin tim për mua është luks të bashkëpunoj me këtë jurist, nga i cili kam mësuar dhe po mësoj përditë e më shumë.

Bashkëpunimi me këtë drejtori duhet dhe do të jetë në nivelin më të lartë jo duke e rënduar me probleme juridike të cilat detyrimisht duhet të zgjidhen nga departamenti jonë, por në radhë të parë duke i dërguar materialet mjaft të koncentruar dhe të qarta.

VIII. Porositë e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duhet ti kemi si udhërrëfyes të përditshëm në mbarëvajtjen e punës tonë.

1. Disiplina në punë. Të kërkojmë gjithçka në drejtim të forcimit të disiplinës. Vërehet se akoma ka probleme me zbatimin e Kujtesës Qarkulluese të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 8, datë 5.01.2012, e cila ju është dhënë gjithë kontrollorëve. Nuk e kuptoj se me çfarë kurajo administrative përgjegjësit e grupeve nuk raportojnë për zbatimin e saj. Kjo kujtesë është urdhër dhe jo dëshirë, pse nuk zbatohet në vazhdimësi nga të gjithë. Ne duhet të jemi shembull në zbatimin e urdhrave të brendshëm për vetë faktin se ne jemi në funksion kontrolli dhe si mund të kontrollojmë të tjerët kur në fakt ne nuk zbatojmë urdhrat e brendshëm. **Kjo ka një domethënie të madhe.**

2. Të rrisim nivelin profesional dhe ligjor në drejtim të rritjes së praktikave për kallëzime penale.

3. Përmirësimi i paraqitjes së Projektraport Auditimit dhe Raportit Përfundimtar të Auditimit. **Të heqim dorë nga raportimet e gjata.** Medoemos në këtë drejtim duhet të **ndryshojmë**, në këtë drejtim të bëjmë të pamundurën. Materialet e gjata tregojnë se nga grupet e auditimit nuk përpunohen materialet por aktverifikimet dhe procesverbalet futen agregat në Projektraport Auditimit dhe në Raportet Përfundimtare të Auditimit. Kjo tregon dembelizëm të shfaqur mjaft dukshëm dhe konkret (si individual edhe kolektiv sipas grupit) dhe deri diku edhe mungesë profesionalizmi.

4. Të programojmë për zgjidhje disa probleme në çdo muaj.

a. Kemi hartuar disa programe zbatimi si departament si Programin e Trajnimeve (duke ju dhënë temat e trajnimeve) por kjo është vetëm fillimi.

Këto tema trajnimi duhet të studiohen me kujdes dhe të ballafaqohen me aktet ligjore dhe nënligjore, në mënyrë që të jemi të përgatitur me ditën e organizimit të trajnimeve. Jam shumë i sigurtë dhe mjaft i bindur se temat e trajnimeve të dhënë nuk janë lexuar fare nga shumë auditues. Pse e them këtë? Fakti që në disa auditime, vetëm nga trajtimi i problemeve dhe shprehjet e përdorura kam nxjerrë këtë konkluzion dhe jam shumë i saktë. Po të lexosh me kujdes dy auditimet e ZVRPP Lushnjë dhe Fier e nxjerr shumë lehtë këtë konkluzion. Njëkohësisht jam shumë i sigurtë se edhe temat e trajnimit në fushat e tjera nuk janë studiuar.

b. Ju kemi dhënë gjitha kontrollorëve një manual të vogël por praktik “Parimet që duhet të mbahen parasysh gjatë hartimit të një shprehje administrative ose shprehje interpretimi ligjor”, por shohim se ecuria është e ngadaltë. **Nuk po kuptoj pse ?** Nuk është studiuar, nuk është kuptuar apo neglizhohet. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm se në materialet e kohëve të fundit ka përmirësime por **nuk** mjafton me kaq. Duhet të përmirësojmë gjithçka në mënyrë që të mos tu bëhemi barrë e rëndë si Drejtorit të Përgjithshëm ashtu dhe Kryetarit.

Një fjali mund të ndërtohet dhe strukturohet mirë, si dhe mund të jetë e saktë gramatikisht, por, edhe pse përmbush këto kushte, fjalia në shumë raste nga kontrollorët ndërtohet pa shumë ngarkesë, jo elegante, shume komplekse, shumë e gjatë dhe e vështirë për tu lexuar dhe kuptuar.

Ja çka thënë një gjuhëtar dhe sa bukur e ka cilësuar të shprehurit me shkrim:

“Nëse unë hartoj një fjali defektozë është sepse, për një arsye ose një tjetër, kam dështuar që t’i mbaj mirë parasysh këto dy gjëra; me qëllim që t’i vendos drejt duhet t’i bëj vetes pyetjet më të thjeshta: Çfarë po shkruaj ? Çfarë duhet të them ? ose me fjalë të tjera: Kush është kryefjala ime ? Cili është kallëzuesi në fjalinë time dhe ç’parashikoj për të ?”.

S. Petter.

c. Të shfrytëzojmë listimin e akteve ligjore dhe nënligjore të hartuar nga grupi i punës, për arsye se akoma kemi raste kur përmenden në dokumentet e kontrollit akte ligjore që janë shfuqizuar dhe kjo është e pafalshme. **Pse vjen kjo ?** Nga mendjemadhësia dhe pakujdesia e kontrollorit. Ka patur dhe raste në materiale si ZVRPP Sarandë që mund të them se është turp për përgjegjësien e grupit të dorëzohë në subjekt një Projektraport Kontrolli i cili rrëzohet në të gjitha problemet e trajtuara. Në këtë subjekt ka munguar debati në grup. **Duhet të luftojmë kultin e individit** dhe sidomos **kultin e përgjegjësit të grupit**. Duhet të forcojmë debatin në grup dhe n.q.s. ka mospërputhje interpretimesh ligjore ti rrahim mendimet për ti unifikuar ato. Interpretimet ndryshe ti transferojmë qoftë në departament apo në Drejtorinë Juridike dhe Sigurimin e Cilësisë.

ç. Të shfrytëzojmë bazën ligjore

Me një fjalë dhe thjesht që nga unë e deri tek kontrollori më i ri duhet të vendosim veten në **“peshoren juridike”**, për të kontrolluar veten sa peshojmë juridikisht. Që të shtojmë depozitën ligjore duhet të studiojmë në mënyrë individuale. Po nuk e realizuam këtë do të kemi probleme me vlerësimin individual dhe ballafaqimin me Statusin e Nëpunësit Civil.

d. kemi hartuar dhe miratuar programin e punës së luftës kundër riskut, e cila kërkon shumë njohje të bazës ligjore etj.

e. kemi krijuar një piramidë në intranet për departamentin tonë me të gjithë bazën ligjore, temat e trajnimit e gjithë programet e zbatimit.

Por ky është vetëm fillimi. Duhet shumë mund dhe sakrificë për tu kualifikuar në mënyrë që të përballojmë detyrat e vendosura nga Kryetari i KLSH-së, për të patur një performancë të lartë në punë.

Rruga më e mirë është kualifikimi individual. Ky kualifikim realizohet nga punonjësit që e ndiejnë përgjegjësinë në kryerjen e detyrave, janë të ndërgjegjshëm në punë, kryejnë mirë organizimin individual për zbatimin e detyrave të programit, nxjerrin probleme dhe domodoshmërisht problemet shoqërohen edhe me interpretimin e zbatimit të akteve ligjore, nënligjore dhe akteve administrative të lëshuara nga drejtuesit e institucioneve përkatëse.

Temat e trajnimeve për të gjitha fushat jua kemi dhënë qysh në muajin mars. Njëkohësisht kemi trajnuar edhe në praktikë në fushën e urbanistikës dhe ZVRPP. Konkretisht në urbanistikë Albert Thoma, Artan Mirashi dhe Qemal Meta.

Në gjirin tonë kemi mjaft shembuj të mirë që e meritojnë për tu respektuar dhe konkretisht: Albert Thoma, Bexhet Zeqiri, Niko Nako, Muhamet Kavaja, Xhemal Luka, Ramadan Zenuni, Fatmir Zilja, Artan Mirashi, Vaso Peci, Qemal Shehu, Selfo Zeneli etj.

5. Aftësitë tona për përzgjedhjen e auditimeve të prioritetit më të lartë.

Duke patur parasysh kërkesat për auditim dhe mundësitë që ka institucioni i ynë për sa i përket burimeve njerëzore dhe materiale, duhet të ishte treguar një kujdes më i madh në përzgjedhjen e auditimeve të prioritetit sa më të lartë, duke përdorur për këtë qëllim argumente sa më të plota, kërkesa këto të parashikuara në Rregulloren e Brendshme.

Për vetë kalibrimin e madh të problemeve që aktualisht vërehen ne detyrimisht duhet të zgjerojmë diapazonin e fushës së kontrollit në organet e qeverisjes vendore, duke u përqendruar në bashkitë, komunat, fushat që kanë riskun më të lartë dhe të vazhdueshëm, kjo për faktin e punës tonë mjaft të dobët ekzaminuese, diagnostikuese dhe ndëshkuese dhe konkretisht:

a. Në fushën e urbanistikës.

Duhet të jemi të ndërgjegjshëm që në këtë drejtim ne si Institucion jemi **bashkëfajtorë** me disa bashki dhe komuna në drejtim të shkatërrimit në vazhdimësi nga ana urbane dhe konkretisht:

Bashkitë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Sarandë, Himarë, Orikum, Pogradec, etj;

Komunat: Golem, Velipojë, Ksamil, e shumë të tjera në zona bregdetare.

Fakti i mësipërm tregon se nga ana e jonë nuk janë bërë të gjitha përpjekjet institucionale dhe ligjore për parandalimin e këtij fenomeni shkatërrimtar por kemi treguar neglizhencë, ta paafte, indiferentë dhe deri në një farë mase dhe të **korruptuar**. Fakti i vetëm dhe shumë bindës është që nuk ka një përputhje midis gjendjes mjaft të rënduar urbane, fenomeneve negative të konstatuara nga ana e jonë me numrin e kallëzimeve penale.

Nga puna jonë mjaftë e dobët dhe dhënia e rekomandimeve mjaft të buta, liberale, në disa raste të influencuara nga forca manjetike të jashtme dhe në disa raste e korruptive ka bërë që të mos të parandalohej shkatërrimi i këtyre qyteteve, shkatërrim i cili ka ardhur nga moszbatimi i ligjeve dhe rregulloreve në fushën e urbanistikës, i deklaraten evropiane urbane etj, shkatërrim i cili është i pandreqshëm dhe me pasoja në jetën e banorëve në këto qytete por edhe për brezat e tjerë.

Kontrollet e evaduarra për tremujorin e parë për bashkitë dhe komunat e mësipërme tregon se akoma nga departamenti jonë nuk është arritur të ushtrohet kontroll në këtë fushë në drejtim të zbatimit të plotë të ligjit dhe Rregullores së Urbanistikës. Në të gjitha kontrollet nuk është ushtruar kontroll për të vënë para përgjegjësisë KRRT-të e këtyre bashkive **në këto drejtime:**

Në drejtim të koeficientit të shfrytëzimit të territorit, intensitetit të ndërtimit, distanca nga kufiri i pronës, distancat ndërmjet objekteve, distancat nga bordurat e rrugëve, aksi i rrugës, numri i vend parkimeve, sipërfaqet e gjelbëruara, vendet e pushimit, etj. Në këtë drejtim kemi shumë nevojë për kualifikim. Kemi organizuar ditën e shtuna trajnime në praktikë me disa auditues.

Duke u kualifikuar në fushën e urbanistikës na del detyrë e menjëhershme që me një grup punë të kompletuar nga ana e kontrollit në këtë fushë të bëjmë goditje në bashkitë dhe komunat e mësipërme.

b. Në fushën e realizimit të performancës fiskale.

Organet e qeverisjes vendore po ngarkohen për ditë e më shumë me një sërë detyrash të një kalibrimi të madh.

Po të analizojmë të ardhurat e bashkive dhe komunave do të nxjerrim konkluzionin se ato gjenden para një depresioni të madh fiskal, për rrjedhojë në të gjitha bashkitë dhe komunat niveli i të ardhurave është në diapazonin 70- 90 %.

Aktualisht depresioni në sistemin fiskal ka ardhur nga mosdhënia e lejeve të ndërtimit për arsye se bashkitë dhe komunat u ndodhën të papërgatitur nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar.

IX. Një nga të metat e vërejtura në hartimin e programeve dhe realizimin e auditimeve është dhe mungesa e auditimeve, për të vlerësuar rëndësinë që ka miradministrimi financiar publik,

menaxhimi i burimeve njerëzore sipas ligjit e me efektivitet, si dhe përfaqësimi me profesionalizëm i administratës publike në gjykata për efekte pasurore. **Në këtë drejtim ka munguar:**

-Plotësimi i vendeve të lira me kontrata të përkohshme të punës, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

- zbatimi i vendimeve të KSHC dhe të gjykatave, me qëllim evidentimin e rasteve kur nga entet publike paguhen për një pozicion pune njëkohësisht dy persona, duke shkaktuar në këtë mënyrë dëm financiar;

- ndjekja dhe përfaqësimi me korrektësi dhe profesionalizëm nga subjektet e audituara në të gjitha shkallët e gjyqësorit, i padive civile të ngritura në funksion të rekomandimeve të KLSH nga subjektet e audituara, apo nga të tretët ndaj tyre;

- në drejtim të ndarjes së pozicioneve të punës që përfshihen në shërbimin civil, nga ato të karakterit ndihmës administrativ, çka lë vend për subjektivizëm në mënyrën e trajtimit të nëpunësve që zënë pozicione të ndryshme pune që janë pjesë e strukturës.

- në drejtim të përcaktimit në raport të rregullt, midis pozicioneve të punës me karakter menaxherial, drejtues dhe atyre të nivelit ekzekutiv;

- administrimi i shërbimit civil dhe pranimet e nëpunësve civil në institucion;

- konkurrimet për periudhën objekt kontrolli;

- ngritja në detyrë dhe lëvizja paralele;

- Masat disiplinore, lirimi nga shërbimi civil, vlerësimet trajnimet;

- dosjet dhe regjistri i personalit;

X. Problem kemi me auditimin e ZRRPP si dhe ZQRPP-të. Auditimi i në këtë fushë është një përmbledhje e gjithë dijeve të dhënies së titujve të pronësisë në kuptim të nenit 193 dhe 195 të Kodit Civil. Pra shkurtimisht po të jemi të përgatitur në të gjitha fushat e tjera nuk ka vështirësi në auditivin e fushës së regjistrimit të pasurive.

XI. Në drejtim të Kodit Etik të KLSH-së të miratuar me vendimin nr. 80, datë 11.7.2005 të Kryetarit të KLSH-së.

Në këtë drejtim në opinion deri në fund të vitit 2011 ne kishim si institucion një njollë të zehtë, e cila duhet me shumë punë e mund që në radhë të parë të vetëpastrohemi.

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se në institucionin tonë ka patur korrupsion. Disa aktorë të këtyre fenomeneve shumë negative kanë dhënë dorëheqjen, por gjurmët dhe dokumentet me të cilat ata janë përlyer me korrupsion kanë lidhje edhe me disa të tjerë, që koha nuk do ti vonojë për tu ballafaquar me to.

XII. Mbi zbatimin e rekomandimeve.

A. Veçoria më themelore e këtij institucioni është sidomos efektiviteti dhe forca e rekomandimeve të tij. Janë pikërisht rekomandimet e dhëna të cilat janë të argumentuara nga pikëpamja ligjore dhe që janë pranuar e zbatuar nga subjektet.

KLSH është **“Agjenti”** i Parlamentit mbi Administratën Publike, me qëllim që gjatë zbatimit të ligjit, të punojë që të arrihet qëllimi i ligjvënësit.

Çdo grup pune është i detyruar ti ndjekë në vazhdimësi detyrat e rekomanduara. Mos kujtoni se do ta kalojmë lehtë këtë problem. Nga çdo grup pune do të mbahet përgjegjësi për realizimin e tyre dhe **do të jetë dhe tregues edhe për vlerësimin e kategorisë që mban çdo auditues.**

XIII. Gjatë muajit gusht do të hartoj me grup pune një program të detajuar për të gjitha të metat e mësipërme, si dhe do të përfundojë metodikën e auditimit financiar, të performancës si dhe të ligjshmërisë rregullshmërisë dhe vlerësues për fushat që mbulon Departamenti jonë duke e shoqëruar edhe me mbështetje ligjore sipas legjislacionit në fuqi.

AKTIVITETI I PUNËS NË GRUPE

Duke u bazuar tek modeli:

1. Të ndërgjegjshëm për misionin dhe vizionin tonë;
2. Të ndërgjegjshëm që jetojmë në epokën e llogari dhënies, KLSH po thellon **Transparencën** e veprimtarisë si detyrim kushtetues, ligjor moral dhe profesional;
3. Çdo auditues është pjesëmarrës proaktiv dhe kontribues;
4. Fusha e dhënies së mendimeve e gjere dhe gjithëpërfshirëse.

Dy shtyllat (kolanat) e fokusimit

1. Çfarë kemi bërë mirë?
 - Përcaktimi i tre fushave ku kemi performuar mirë.
2. Çfarë mund të bëjmë më mirë?
 - Përcaktimi i tre fushave që ne mund të bëjmë më mirë dhe që kanë nevojë për përmirësim.

Organizimi

- Staf i audituesve u **nda në 13 grupe**.
- **Kriteri i grupimit** ishte përvoja, eksperiencia dhe fusha në të cilën audituesit janë specializuar dhe sipas departamenteve. Përmendim: Grupi i auditimit te Ministrive dhe institucioneve, të Prokurimeve, të Organeve Tatimore, Doganore, të njëjve të qeverisjes vendore bashki Komuna, i mbrojtjes së mjedisit , Financimeve të huaja shoqërive publike etj.

Fushat orientuese:

- 1. Planifikimi i Auditimit
- 2. Puna ne terren
- 3. Raportimi i auditimit
- 4. Dokumentimi /Mbledhja e evidencave
- 5. Dokumentet standarte
- 6. Shpërndarja e ngarkesës ne grupin e auditimit
- 7. Auditimi i çështjeve materiale nga natyra apo përmbajtja
- 8. Vlerësimi dhe ngritja e kapaciteteve audituese.
- 9. Trajnimi, dhe orientimi për trajnime te avancuara
- 10. Kontrolli dhe sigurimi i cilësisë
- 12. Afatet e Auditimit dhe evadimi.
- 13. Kuadri rregullator i KLSH-se .
- Standartet e auditimit, rregullorja, urdhra udhëzime etj .
- 14. Planifikimi i subjekteve te auditimit
- 15. Cilësia e menaxhimit punës etj.

Grupi nr. 1.

Subjekti: *Vlerësimi i funksionimit të Auditimit të Brendshëm dhe Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit*

1. **Pjetër Beleshi**
2. Qeram Cibaku
3. Andrea kristo
4. Evis Cela
5. Dritan Kore
6. Anila Halili
7. Oljana Ifti
8. Monika Dushku

Grupi nr. 2

Subjekti: *Auditimi i Buxhetit të Ministrive dhe Institucioneve Qendrore*

1. **Aleksandër Tereziu**
2. Nikoleta Piranjani
3. Nerenxa LLapashtica
4. Ludmilla Sulaj
5. Valentina Sula
6. Alketa Pernaska
7. Rajmond Koci
8. Kujtim Rama
9. Vladimir Vangjeli

Grupi nr. 3

Subjekti: *Auditimi i Prokurimeve Publike*

1. **Bajram Lamaj**
2. Bashkim Harizaj
3. Fadil dekovi
4. Yllka Dede
5. Pranvera Doci
6. Vasil Vane
7. Mina Blushi
8. Miranda Haxhia
9. Selime Bicaj

Grupi nr. 4

Subjekti: *Auditimi Bashkive*

1. **Bexhet Zeqiri**
2. Vasillaq Peci
3. Fatos Gjyrezi
4. Ramadan Zenuni

5. Kristaq Gjurgaj
6. Sotir kozdine
7. Milo Pano
8. Jonel Nasto

Grupi nr. 5

Subjekti: *Auditimi Komunave*

1. **Muhamet Kavaja**
2. Niko Nano
3. Margarit Stefa
4. Selman Hysaj
5. Jorsif Lile
6. Pal Daci
7. Hysen Metko
8. Besim Bileri
9. Selfo Zeneli
10. Irma Shkupi

Grupi nr. 6

Subjekti: *Auditimi i Urbanistikës*

1. **Xhemal Luka**
2. Artan Mirashi
3. Qemal Meta
4. Ymer Stafa
5. Pirro Imeraj
6. Edvin Morava
7. Pal Gjoni
8. Ruisim Xhaja

Grupi nr. 7

Subjekti: *Auditimi Administrimit të Pronës*

1. **Albert Thoma**
2. Fatmir Zilja
4. Juljan Adili
5. Aleksander Papadimitri
6. Perparim Gjuzi
7. Dorino Meçe

Grupi nr. 8

Subjekti: *Auditimi i Organeve Tatimore*

1. **Edvin Stefani**
2. Odhise Veshi
3. Xhovan Domi
4. Hodo Hasani
5. Agim Mandri
6. Din Zenelaj
7. Vladimir Rizvani

Grupi nr. 9

Subjekti: *Auditimi i Organeve Doganore*

1. **Livan Hoxha**
2. Elfrida Tarku
3. Alfred Zylfi
4. Bashkim Shehu
5. Saimir Mucmata
6. Sali Agai
7. Agron Opari
8. Hekuran Avdylaj

Grupi nr. 10

Subjekti: *Auditimi të Mbrojtjes së Mjedisit*

1. **Moza LLoji**
2. Gjovalin Preci
3. Agron Maksutaj
4. Nefail Xhepexhiu
5. Abdulla Duka
6. Keida Muça
7. Ermira Vojka

Grupi nr. 11

Subjekti: *Auditimi Shoqërive Anonime*

1. **Shefki Jaupi**
2. Mimoza Bedini
3. Rustem Tare
4. Lavdie Fshazi
5. Andi Buzo
6. Fatmir Iljazi

Grupi nr. 12

Subjekti: *Auditimi Projekteve me Financim i Huaj*

1. **Marjola Lleshi**
2. Artan Topjana
3. Yllka Pulashi
4. Nikolin Gjonaj
5. Luljeta Shtylla
6. Albana Pengili
7. Elfrida Agolli

Grupi nr .13

Subjekti: *Problemet Juridike, Kontrollit dhe Sigurimit te Cilesise*

1. **Koço Sokoli**
2. Bashkim Spahiu
3. Dalina Demi
4. Adrian Kondi

Grupi nr. 1.

Subjekti: *Vlerësimi i funksionimit të Auditimit të Brendshëm dhe Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit*

Në analizën e 6 mujorit të I-re të vitit 2012 të zhvilluar në Vlorë nga data 30.07.2012 deri më 01.08.2012 në zhvillimin e mendimit të lirë në temën: “Vlerësimi i funksionimit të Auditimit të Brendshëm dhe sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” u krye nga grupi Nr. 1, i përbërë nga kontrollorët

Për pyetjen; **Çfarë kemi bërë mirë?**

Grupi përcaktoi tre fushat ku kemi performuar më mirë, e përkatësisht;

a. Planifikimi i auditimit është fusha ku mendojmë se është performuar më mirë, pasi në programet e auditimeve të hartuara këtë vit, për herë të parë u programua auditimi i MFK në të 5 komponentët e tij si:

- Mjedisi i kontrollit.
- Menaxhimi i riskut.
- Aktiviteti i kontrollit.
- Informimi dhe komunikimi.
- Monitorimi.

b. Puna në terren, është fokusuar me mbikëqyrjen e veprimtarisë audituese të DAB dhe NJQH të AB në Ministrinë e Financës dhe të ministrive e audituara, si dhe të disa njësive të tjera qendrore dhe që administrojnë fonde buxhetore të konsiderueshme. Puna është fokusuar në vlerësimin e veprimtarisë për:

- Organizimin dhe funksionimin e strukturave AB.
- Hartimin dhe zbatimin e planeve vjetore dhe strategjike.
- Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit
- Hartimi i raportit final të auditimit dhe sigurimi i cilësisë.
- Respektimi i standardeve të AB.
- Evadimi i materialeve të auditimit dhe arkivimi.
- Etj.

c. Raportimi i auditimit, që ka të bëjë me dhënia nga KLSH të disa rekomandimeve të vlefshme për përmirësimin e strukturave të AB, për kuadrin rregullator dhe organizativ si dhe për përmirësimin e MFK në subjektet e audituara.

Për pyetjen; **Çfarë mund të bëjmë më mirë?**

Grupi përcaktoi tre fushat që ne mund të bëjmë më mirë dhe qukanë nevojë për përmirësim, e përkatësisht;

- a. Auditimi i çështjeve materiale duke u përqendruar në vlerësimin e komponentëve të MKF, duke u fokusuar në të 5 komponentët, veçanërisht mjedisin e kontrollit në identifikimin e riskut etj,
- b. Planifikimi i subjekteve për tu audituar, duke e shtrirë në thellësi procesin e vlerësimit të veprimtarisë së AB, për të gjitha subjektet që auditon KLSH.
- c. Dokumentimi i sakët dhe i mbështetur në dispozita ligjore i konstatimeve tona që pasqyrohen në letrat e punës të auditimit. Rëndësi e veçantë duhet ti kushtojmë shqyrtimit të observacioneve të paraqitura nga subjekti i audituar.
- d. Trajnimi, dhe orientimi për trajnime të avancuara, i audituesve të KLSH, duke u fokusuar njohjen më mirë të kërkesat të ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe të ligjit për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik.

Grupi nr. 2

Subjekti: *Auditimi i Buxhetit te Ministrive dhe Institucioneve Qendrore*

Ç’kemi bërë mirë

1. Kuadri rregullator i KLSH
 - a. Unifikimi i raporteve
 - b. Aplikimi i teknikave të reja dhe bashkëkohore
 - c. Përmirësimi i standardeve cilësisë bazuar ne standardet e INTOSAI-t
2. Auditimi I subjekteve mbi bazën e riskut e materialitetit
3. Analize paraprake e sistemit duke u bazuar në rezultatet e auditimeve të mëparshme
4. Trajnimet dhe orientimet për trajnime të avancuara
5. Është bërë rifreskim i njohurive
6. Trajnim për auditimin financiar e performancës

Përmirësime

1. Përmirësimi i manualit financiar për të shprehur opinionin e grupit te auditimit
2. Ndërthurja e auditimit financiar me atë të performancës dhe në auditimin e përputhshmërisë të aplikohet vlerësimi i materialitetit e riskut
3. Hartimi i programit të kontrollit
4. Afatet shkëmbimi i eksperiencave në grup

Grupi nr. 3

Subjekti: *Auditimi i Prokurimeve Publike*

Ç’kemi bërë mirë

1. Kemi ndikuar në bërjen e akteve ligjore(DST dhe Kushteve të kontratës...
2. Rritur % e auditimit te prokurimeve te kryera me e madhe së 50% në numër dhe 80% në vlerë
3. ndryshime e kushtet specifike me APP në DST
4. rekomanduar ndryshime në kryerjen e proc me negocim në sist elektronik
5. kemi rekomanduar përmirësime të llog të fondeve limite

Përmirësime

1. Përmirësimi I rregullores KLSH tek afati i projekt raportit të auditimit duke shtuar afatin dhe pakësimin e afatit te raporti përfundimtar
2. Puna ne teren te kërkohet përjashtimi edhe për KLSH për ndryshime e distancës kjo do të risë rendimentin eficensen dhe pa dyshim do të ulë koston e auditimit të risim cilësinë e menaxhimit të punës në grupet e auditimit duke krijuar grupe ne harmonizim me veçanti dhe specifikat që ka objekti(ing mjek specialist it etj)
3. Të behet harmonizimi i auditimeve në lidhje me programimin dhe planifikimin midis departamenteve Brenda KLSH për të shmangur paraqitjen e disa grupeve në institucione që auditohen

Grupi nr. 5

Subjekti: *Auditimi Komunave*

Fokusimi: Çfarë kemi bërë mirë? Përcaktimi i tre fushave ku kemi performuar mirë.
Çfarë mund te bëjmë me mire ? Përcaktimi i tre fushave që mund të bëjmë më mirë.

Puna e Grupit u prezantua nga Muhamed Kavaja .që në mënyrë të përmbledhur është si më poshtë:

Nga ana e Grupit 5 të caktuar për temën e Auditimit të Komunave pati mjaft vështirësi për të konkluduar në drejtimit që janë bërë mirë për këtë gjashtë mujor për arsye se është punuar mire në të gjitha drejtimit dhe për faktin se ska me cilën periudhë të krahasohet pasi para gjashtë muajve dhe jo vetëm por për rreth katër vjet KLSH ka qenë pushim.

Megjithatë në përfundim vendosem që të evidentojmë tre fusha ku është punuar mirë, si më poshtë:

1. Puna ne Terren.
2. Raportimi i auditimit
3. Dokumentimi / Mbledhja e evidenca

Puna në terren është përmirësuar shumë aq shumë sa po habitet subjekti me prezencën tonë atje. Dhe kjo është mjaft domethënëse.

Raportimi i auditimit. Në këtë drejtim mendon grupi se është punuar me mire për arsye se dhe vete materjalet po përdorin një gjuhe me europiane në trajtimet në materjale nga ana e audituesve. KLSH ka vuajtur gjithë kohën që nga themelimi për këtë sepse është gjë tjetër të kapeshe problemin dhe është gjë tjetër menura e trajtimit në raportim organet homologe ndërkombëtare e shfrytëzojnë shumë këtë mundësi. Dhe nga ana jonë ka filluar puna për një model të tillë raportimi dhe rregullorja ka kontribuar për një gjë të tillë. Sigurisht ka vend për përmirësim por është punuar mirë dhe është një fillim mjaft inkurajues.

Dokumentimi / Mbledhja e evidencave. Edhe në këtë drejtim është punuar mjaft mirë për këtë gjashtëmujor pasi për një raportim te mire duhet dhe dokumentimi me evidenca te mjaftueshme gjë pra që ka lidhje me Raportimin. Konstatojmë se KLSH nga një organ që deri dje e shihte subjektin me syrin e prokurorit. Që do të thotë se kur kapej , zbulohej problemi dërgohej shpejt në drejtim të organeve për ndëshkim ndërsa sot KLSH e vështron problemin me syrin e avokatit të subjektit ku problemi, shkelja, e konstatuar trajtohet mjaft gjatë e dokumentohet e fiksohet duke bërë kujdes qe personi, subjekti që ka kryer shkeljen të ketë të gjitha mundësitë e mbrojtjes e kundërshtimit. Pra me pak fjale siç thotë populli po i dilet borxhit. Këto tre drejtime mendojmë si grup se është punuar me mire.

Përsa i përket tre fushave ku është punuar por ka dhe vend për përmirësim , gupi mendon se janë:

1. Programimi i Auditimit.
2. Auditim Performance
3. Zbatimi i rekomandimeve

Programimi i Auditimit. Ne mendojmë se programi i auditimit në komuna duhet të jetë më i konsultuar . për arsye se Komunat kanë disa fusha auditimi me rrisht më të vogël dhe ndryshojnë nga Bashkitë.

Auditim Performance. Ne mendojmë se sot në janë rreth 309 Komuna në gjithë territorin. Ato kanë specifika shumë të ndryshme. Kështu konstatojmë se Komunat sot janë përgjithësisht konsumuese të fondeve të buxhetit të shtetit dhe ato duhet të kthehen në gjeneruese të të ardhurave nëpërmjet menaxhimit të aseteve që ato në mjaft raste disponojnë. Për këtë arsye mendojmë se duhet të bëhet kalimi në drejtim të Auditimit të performancës në komuna.

Në lidhje me këtë ne kemi një sugjerim që nga ana e Kryetarit të KLSH të kërkohet Rindarjen administrative me qëllim përmirësimi.

Zbatimi i Rekomandimeve. Ne mendojmë se në këtë drejtim duhet pyunuar më shumë po të kemi parasysh se po flasim për komuna me stafet e tyre. Kështu duhet që të përcaktohet mirë kush do të quhet rekomandime të kryera apo jo nga këto Komuna apo në rastet e padive gjyqësore duhet të presim që të ngrihen për të quajtur të përmbushur. Rekomandimet e dhëna për Komuna nuk ndryshojnë në varësi të specifikave të tyre ato janë si Bashkitë apo kudo tjetër megjithëse stafi i tyre nuk mund ti zbatoj apo ti raportoj në disa raste.

Grupi nr. 6

Tema: *Auditimi i Urbanistikës*

Fokusimi: Çfarë kemi bërë mirë? Përcaktimi i tre fushave ku kemi performuar mirë.

Çfarë mund të bëjmë me mire ? Përcaktimi i tre fushave që mund të bëjmë më mirë.

Puna e Grupit u prezantua nga Xhemal Luka qe ne mënyre te përmbledhur është si më poshtë:
Nga ana e Grupit 6 të caktuar për temën e Auditimit të Urbanistikës pati vështirësi për të konkluduar në drejtimet që janë bërë mirë për këtë gjashtë mujor për arsye se është punuar mire edhe për faktin se ka ndryshuar mënyra e konceptimit të auditimit.

Megjithatë në përfundim vendosem qe te evidentojmë tre fusha ku është punuar mirë, si me poshtë:

1. Auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të dosjes për aplikim për leje e shesh ndërtimi.
2. Auditimi i Studimeve Urbanistike Pjesorë në zbatim të Planeve të Përgjithshëm Rregullues
3. Auditimi i llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të dosjes për aplikim për leje e shesh ndërtimi.

Në këtë drejtim grupi mendon se është përmirësuar ndjeshëm auditimi i dosjeve me dokumentacionin tekniko-ligjor sa ka edhe shprehje nga subjekti se janë plotësuar dosjet edhe sipas rekomandimeve të auditit të mëparshëm.

Auditimi i Studimeve Urbanistike Pjesorë (SUP) në zbatim të Planeve të Përgjithshëm Rregullues. Sipas mendimit të grupit theksojmë se nuk fillon auditimi në sektorin apo drejtorinë e Urbanistikës të NJQV pa u konkluduar më parë përputhja ose lidhja e SUP me planin e përgjithshëm rregullues, tani këtu nuk ka anashkalime në verifikim e detajeve.

Auditimi i llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë. Sipas mendimit të grupit është punuar më mirë pasi auditimi bazohet edhe në çmimeve të ndërtimit të përcaktuara me VKM .

Këto tre drejtime mendojmë si grup se është punuar me mire.

Përsa i përket tre fushave ku është punuar por ka dhe vend për përmirësim , grupi mendon se janë:

1. Zbatimi i kondicioneve Urbane .
2. Angazhimi i NJQV në hartimin e Planeve Rregulluese
3. Aplikimi në pagesën e projekteve i të ardhura të arkëtuara në zbatim të nenit 51 të ligjit të Urbanistikës

Zbatimi i kondicioneve Urbane. Ne mendojmë se deri tani kjo e trashëguar edhe nga auditimet e mëparshme është anashkaluar auditimi i aplikimit të kondicioneve urbane pasi ka me shume probleme e atakime me subjektin e audituar.

Angazhimi i NJQV në hartimin e Planeve Rregulluese. Sipas mendimit të grupit ka neglizhencë në këtë drejtim pasi ka mendime që janë detyrë e NJQV dhe nuk janë pjesë e auditimit kur në fakt janë thelbi i planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Aplikimi në pagesën e projekteve i të ardhura të arkëtuara në zbatim të nenit 51 të ligjit të Urbanistikës. Mendimi i grupit është se në këtë drejtim ka mos thellim të auditimit edhe për faktin apo konceptin që është krijuar se mqs janë arkëtuar në përputhje me legjislacionin nuk kemi pse merremi edhe me ndarjen e tyre. Kjo është me efekte negative pasi kur vjen puna për hartimin dhe pagesën e projekteve të ndryshme këto të ardhura janë harxhuar për investime pasi aty ka duk edhe puna e titullarëve të institucioneve.

Grupi 7

Subjekti: *Auditimi Administrimit të Pronës*

Ç’kemi bërë mirë

1. Shpërndarja e ngarkesës së grupit sipas profilit eksperiencës dhe ngarkesës së materialeve të shtrirë në vite
2. Audituesit e rinj janë angazhuar me synim shkëmbimin eksperiencave përshtatja dhe kontribut real
3. Cilësia e menaxhimit te punës
4. Menaxhimi i kohës ne dispozicion
5. Diskutimi ne grup dhe njerja e konkluzioneve
6. Konsulta me auditues te departamenteve te tjera
7. Dokumentimi dhe mbledhja e evidencave
8. Zgjedhja e fushës se auditimit dhe mbledhja e te dhënave me faktor te larte risku
9. Aplikimi i programeve kompjuterike

Përmirësime

1. Planifikimi i auditimit
2. Njohja paraprake me efektive
3. Përcaktimi i pritshmërisë (objektivat e auditimit)
4. Raportimi i auditimit
5. Raporti thelb përmbajtje sa më optimal objektiv dhe depërtues te përdoruesi
6. Auditimi i çeshiteve material nga natyra dhe përmbajtja
7. Identifikimi sa me real
8. Vlerësimi sa me real i riskut

Grupi nr.8

Subjekti: *Auditimi i Organeve Tatimore*

Fushat që mendojmë se janë performuar më mirë janë;

a-Puna në terren.

Kjo fazë e performancës mendojmë se është më kryesore për faktin se nëpërmjet saj është audituar i gjithë dokumentacioni që vihet në dispozicion dhe mbi këtë është bërë trajtimi për gjetjet e konstatuara nga vënia në dispozicion e të gjithë dokumentacionit përkatës. Mendojmë se është realizuar më mirë për këtë periudhë pasi përgjegjësit dhe masat kanë qenë më të saktësuar dhe efikase.

b-Planifikimi i Auditimit.

Kjo fazë e performancës mendojmë se është e realizuar më mirë për faktin se, së pari parashikohen risqet për subjektet që do të auditohen, bëhet njohja më e plotë e veprimtarisë së subjektit dhe mbi këtë bazë parashikohen drejtë të gjitha drejtimet kryesore të auditimit.

c-Trajnimi dhe orientimi për trajnime të avancuara.

Edhe kjo fazë e performancës mendojmë se është e realizuar më mirë për këtë periudhë për faktin se për këtë nëpërmjet trajnimeve të kryera për çdo auditues është arritur një shkallë më e lartë përfitimi për treguesit e performancës si dhe apdeitimi me të rejat më të avancuara, si dhe nëpërmjet përfitimit nga përvoja e audituesëve me përvojë.

Fushat që mendojmë se duhet të performohet më mirë;

a-Cilësia e menaxhimit të punës.

Mendojmë se kjo fazë duhet të bëhet më mirë sepse nëpërmjet saj arrihet të shfrytëzohen më mirë konceptet dhe baza ligjore, nëpërmjet ndarjes së detyrave të parashikuara në program sipas çdo audituesi duke shfrytëzuar përvojën dhe njohuritë përkatës të secilit, për të cilën dihet të jetë më prioritare.

b-Kontrolli dhe sigurimi i cilësisë.

Mendojmë se nëpërmjet kontrollit paraprak për harmonizimin e plotësimit të të gjitha letrave të punës në mënyrë rigorozë për çdo fazë të auditimit dhe ballafaqimi konkret me subjektin do të realizohet dhe do të sigurohet me të vërtet një cilësi perfekte e të gjitha hallkave dhe procedurave të auditimit.

c-Planifikimi i subjekteve të audituara.

Kjo fazë e performancës mendojmë se duhet të realizohet më mirë për faktin se nëpërmjet saj në programin vjetor të auditimit duhet të planifikohej dhe të jenë prioritare vetëm ato subjekte të cilat edhe shkallën e riskut e kanë më të lart, ndërsa janë planifikuar me radhë edhe subjekte që nga shkalla e riskut mund të konsiderohen subjekte pa risk për këtë edhe planifikimi i periudhës së auditimit duhet të jetë me e gjatë.

Grupi 9

Subjekti: *Auditimi I Organeve Doganore*

Konkluzione e nxjerra nga Konferenca e Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë analizës së gjashtë mujorit të parë 2012

Në analizën e punës në grupe ne ishim në grupin e 9-të me temë:
“auditimin e Sistemit Doganor”.

Përgjigjet e grupit për pyetjet:

Çfarë kemi bërë mirë?

- Puna në terren.
- Dokumentimi/ Mbledhja e evidencave.
- Kuadri rregullator të K.L.SH

Çfarë mund të bëjmë më mirë?

- Planifikimi i subjekteve të auditimit (mënyra e përcaktimit të subjekteve për auditim).
- Shpërndarja e ngarkesës në grupin e auditimit.
- Ngarkesa sipas aftësisë profesionale.

Grupi 10

Subjekti: *Auditimin e Mbrojtjes së Mjedisit*

Çfarë kemi mirë?

1. Përzgjedhja e subjekteve për auditim ku jemi mbështetur në:

- a. rëndësinë e subjektit në zbatimin e legjislacionit në fushën e mjedisit;
- b. përgjegjësitë e subjektit në kontrollin dhe monitorimin e mjedisit.

2. Auditimi në terren, ku jemi përqendruar në

- a. analizën e subjektit në lidhje me përputhshmërinë në zbatimin legjislacionit përkatës;

3. Raportimet mbi Auditimin e Performancës Mjedisore, në disa bashki të vendit, në të cilat janë konstatuar:

- a. mungesa e strukturave përkatëse për menaxhimin e mjedisit urban
- b. mungesa e planifikimit dhe zbatimit të programeve mbi grumbullimin ndarjen në burim të mbetjeve urbane.

Çfarë mund të bëjmë më mirë?

1. auditime mjedisore për fusha specifike si ndotja e ajrit urban, tokës, ujit, etj.

2. Planifikimi i kohëzgjatjes dhe burimeve njerëzore;

3. trajnime të avancuara në fushën mjedisore.

Grupi 11

Subjekti: *Auditimi Shoqërive Anonime*

Subjekti: Auditimi i Shoqërive Publike

Formati i kësaj analize 6- mujore ndryshonte nga analizat tradicionale ku u përqendruam në përgjigjet konkrete për pyetjet:

“Çfarë është bërë mirë në auditimet e ushtruar në Shoqëritë publike ?, Çfarë është bërë më pak mirë në auditimet e kryera?, Cilat janë sfidat e dala nga auditimet në Shoqëritë publike gjatë kësaj periudhe auditimi dhe si do të ballafaqohemi me to më tutje.”

Çfarë kemi bërë më mirë?

Grupi përcaktoi tre fusha ku kemi performuar më mirë, si më poshtë:

1. Puna në terren (afatet e auditimit, shpërndarja e ngarkesës në grupet e auditimit, auditimi i çështjeve materiale nga natyra apo përmbajtja)
2. Raportimi i auditimit (kuadri nënligjor, dhënia e rekomandimeve në P/Raport ka garantuar nivel të lartë të pranimit të gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve si produkte të punës sonë)
3. Cilësia e menaxhimit të punës (ndarja e fushave të auditimit ndërmjet auditueseve në grupet e auditimit, puna në grup, pasi grupi është një faktor shumë i rëndësishëm dhe përcaktues në auditim).

Çfarë mund të bëjmë më mirë dhe ka nevojë për përmirësim?

1. Planifikimi i auditimit (Auditime të performancës në shoqëritë publike (në tema, Këshillat Mbikëqyrëse, Shoqëritë në Likuidim e Sipër etj)
2. Trajnimi dhe orientimi për trajnime të avancuara (Kryerja e trajnimeve në fushën e shoqërive publike, pasi legjislacioni është kompleks).
3. Planifikimi i subjekteve të auditimit (disa subjekte duhen audituar çdo vit nisur nga impakti në publik, ndërsa disa të tjera nuk kanë nevojë për auditim bazuar në analizën e rrishtit).

Gjatë -6 mujorit të parë 2012, mendoj se ne :

-Kemi zhvilluar një dialog konstruktiv me institucionet e audituara dhe do të vazhdojmë t'i thellojmë këto marrëdhënie.

-Jemi trajnuar më shumë se më parë

Në Deklaratën e Limës (Neni 15) theksohet se shkëmbimi ndërkombëtar i eksperiencës dhe i informacionit shërben si një mjet i mirë ndihmues për institucionet e kontrollit të lartë për të përmbushur detyrën e tyre. Është bërë e mundur të përdoret eksperiencia e fituar nga të tjerët si bazë për rritjen e efektivitetit dhe efijencies së auditimit.

Përvetësimi dhe zbatimi i praktikave më të mira të auditimit në zbatim të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI.

-Jemi motivuar më shumë se më parë dhe jemi të etur për t'u zhvilluar në bazë të suksesit të kohëve të fundit të KLSH-së, pasi grupi është një faktor shumë i rëndësishëm dhe përcaktues në auditim. Kooperimi është parë si domosdoshmëri në punën audituese, të qenit hulumtues, kërkues drejt së vërtetës së profesionit dhe angazhimi tërësor për plotësimin e objektivave të auditimit.

Kemi konsideruar veten tone si agjente të ndryshimit dhe se secili prej nesh është i përgjegjshëm për pritshmërinë dhe kërkesat që ka departamenti e institucioni i KLSH etj

-Zhvillimi i vijueshëm i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në këtë 6- muaj ka garantuar nivelin e lartë të pranimit të zbulimeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të raporteve të auditimit si produkte të punës sonë.

Këtë 6- muaj kemi bërë me shumë për të siguruar që të ndiqen praktikrat dhe metodologjitë e mira të auditimit. Auditimet tona ekzistojnë në kuadër të një kornize rigoroze të standardeve të auditimit, të cilin grupi i ka mësuar se si ti përdorë gjatë programeve të trajnimit dhe në mënyre individuale. Raportet janë publikuar dhe janë të hapura për ekspertize profesionale të çdo kujt.

-Treguesit dhe Rezultatet e punës kanë të bëjnë me: numri i raporteve të hartuara dhe raportuara; respektimi i afateve kohore; cilësia e auditimeve; si dhe ndikimi i raporateve të auditimit dhe rekomandimeve në subjektet objekt auditimi.

Grupi nr. 12

Subjekti: *Auditimi Projekteve me Financim i Huaj*

Çfarë kemi bërë mire?

Një nga arritjet më të spikatura në këto 6 muaj është shkundja nga rutina dhe raportimi pa nerv i problematikës së hasur, zgjimi i grintës së brendshme të çdo audituesi dhe më e rëndësishmja ndryshimi i këndvështrimit të audituesit nga një këndvështrim i ftohtë ligjor në rifutjen e vetë audituesit në rolin e qytetarit, taksapaguesit apo të cilitdo, interesat e të cilit në kemi detyrimin ligjor për të mbrojtur.

Çfarë kemi bërë mirë?

Sigurisht kemi bërë mirë punën në terren duke shfrytëzuar me ekonomikitet kohën e auditimit duke ruajtur raportin midis auditimit nëpërmjet dokumenteve dhe auditimit në terren.

Formati i ri i raportimit na jep mundësi konkrete të ballafaqimit të problematikës me subjektin e audituar si dhe shkurtohen frazat e tepërta ndonjëherë të tejzgjatuar dhe vështirë për t'u kuptuar.

Çfarë duhet të bëjmë më mirë?

Sigurisht që ka shumë aspekte të cilat duhen përditësuar, ndërkohë që ka ardhur momenti që në departamentin e auditimit të projekteve me financime të huaja të përdorim skedarin elektronik që kemi të ndërtuar me të dhënat e projekteve që janë audituar gjatë fazës së zbatimit të tyre, në planifikimin e auditimit duke u fokusuar në përzgjedhjen e projekteve që kanë përfunduar dhe paraqesin impakt social. Interesi publik është më i lartë duke audituar performancën e tyre duke qenë në të njëjtën kohë edhe qëllimi i marrëveshjes financiare.

- Numri i madh i transaksioneve që në auditojmë si dhe sistemi elektronik që vetë subjektet e audituara aplikojnë, na ka vendosur në vështirësi. Kjo gjithashtu edhe para kërkesës së vënies në përdorim të programeve elektronike për përpunimin e të dhënave, programe këto që ekzistojnë edhe tek ne.

Në KLSH është vendosur si një nga prioritet kryesorë trajnimi i stafit auditues.

Grupi nr .13

Subjekti: *Problemet Juridike, Kontrollit dhe Sigurimit të Cilësisë*

Çfarë kemi bërë mirë?

1. Dhënia e mendimit juridik për Raportet Përfundimtare të Auditimit dhe Projektvendimeve, procedura që i përkasin kontrollit të cilësisë “shqyrtime të nxehta”
2. Kontrolli Sigurimit të Cilësisë, poçes që i përket shqyrtimeve të “ftohta”, mbasi dosjet e auditimeve janë evaduar e arkivuar.
3. Bashkëpunimi me Departamentet e Auditimit në përgatitjen e kallëzimeve penale, të cilat janë vlerësuar nga organi i Prokurorisë.

Çfarë mund të bëjmë më mirë ?

1. Rritja e bashkëpunimit me juristët e departamenteve, sidomos për rastet e kallëzimeve penale.
2. Ti kushtojmë më shumë rëndësi cilësisë së rekomandimeve, në mënyrë që ato të jen sa më të sakta dhe të argumentuara, si dhe të zbatueshme nga subjektet e audituara.
3. Duhet të jemi më të kujdesshëm në argumentimin sa më të saktë, në rekomandimet që bëjmë në drejtim ndryshimeve të akteve ligjore. Këto rekomandime të jenë në interes të përmirësimit të legjislacionit në fushën përkatëse, por njëkohësisht të arritshme për tu realizuar.
4. Të shikohet mundësia e paraqitjes së Raporteve Përfundimtare të Auditimit, të cilët të jenë më të përmbledhur dhe më të qartë për tu kuptuar nga subjektet dhe përdoruesit e tjerë.

KONKLuzionet e Analizës 6-Mujore.

Dr. Bujar Leskaj
Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit

AUDITUESIT – AGJENTE NDRYSHIMI

Për këtë nevojitet:

1. Fokus mbi atë çka do të vendosim . Ne jemi partnerë të administratës publike mbi atë çka ata drejtojnë;
2. Të zhvillojmë produktin e auditimit që zhvillojmë në funksion të punës. - Raportet
3. Të krijojmë procese të lehta të brendshme secili prej nesh duhet të jetë shumë i përgjegjshëm me pritshmëritë e reja;
4. Ne zhvillojmë aftësitë për të menaxhuar ndryshimin.

DO TË RALIZOJMË DERI NË FUND TË VITIT 2012

- Aksionin ligjberës për amendimet në ligjin organik
- Do të përgatisim Strategjinë 2013 -2016
- Do të realizojmë një program të gjerë plotësues trajnimi në bashkëpunim me SIGMA-n dhe partnerët e homologët tanë.

I. Çfarë kemi bërë mirë?

-Në rreth **27 % të rasteve** rezulton së **faza e ekzekutimit** të auditimit është performuar mirë. Kjo në drejtim të: Teknikave të auditimit, mbledhjes dhe analizës së të dhënave dhe evidencave, respektimit të afateve etj

-**Ne rreth 17 % e rasteve** janë shprehur që **planifikimi i auditimit** është kryer mire dhe ka të bëjë kryesisht me planifikimin e subjekteve në nivel institucional, përcaktimin e sektorëve që janë audituar, fokusimi në çështje të konsideruara materiale, fondet që janë menaxhuar etj.


-**Rreth 14 % e rasteve** janë shprehur në lidhje me performancën e mire në drejtim të **raportimit të auditimit**. Është vlerësuar pozitivisht aplikimi i formatit të Projekt Raportit të auditimit, strukturimi i tij, konform Standarteve që kanë të bëjnë me raportimin, përmendim: Përfshirjen e gjetjeve dhe rekomandimeve që në fazën e projekt raportit, formulimin e përmbledhjes ekzekutive, etj.

Në të njëjtin nivel vlerësimi pra **14 % e rasteve** rezultojnë me performancë të mirë në drejtim të **dhënies së rekomandimeve** dhe kuadrit rregullator që ka të bëjë me rregulloren e re të funksionimit të institucionit urdhrat dhe udhëzimet.

Grupet kanë vlerësuar (rreth 7 % e rasteve) **komponentin e trajnimeve** por mendojnë që të vazhdoje me tej ky proces me trajnime me të avancuara dhe sipas fushave që auditojnë.

Grafikisht situata paraqitet:

Çfarë kemi bërë mirë



II. Çfarë mund të bëjmë më mirë ?

Konstatohet **një opinion dominant** rreth **36 %** janë shprehur për përmirësimin e **fazës së planifikimit** të auditimit në drejtim të :

-përcaktimit dhe përzgjedhjes së subjekteve që do auditohen duke aplikuar teknikën e **riskut dhe materialitetit** në zbatim të Standardeve ndërkombëtare të Auditimit.


Komponenti i trajnimeve: Rreth **15 % e rasteve** janë shprehur për nevojën e **konsolidimit** të procesit të trajnimeve nëpërmjet përzgjedhjes fushave specifike si Kontabiliteti, financimet e huaja përdorimi i IT në auditim etj.

Në rreth **13 % të rasteve** janë shprehur për nevojën e përmirësimit të **menaxhimit të burimeve** të auditimit në drejtim të organizimit të punës në grupe shpërndarjes proporcionale të ngarkesës së punës, angazhimin e eksperteve për auditime specifike etj.

-36 % e rasteve përfaqësojnë opinione për përmirësim në fushat si: Raportimi i auditimit, Kuadri rregullator rekomandimet, puna në terren.

Grafikisht situata paraqitet:

Çfarë mund të përmirësojmë



Treguesit e konsoliduar

Çfarë kemi bërë mirë? Çfarë mund të bëjmë më mirë?

